

# **Kopshti i të mençurve**

*Ebu Hatim Muhammed Ibn Hiban el-Busti*



# KOPSHTI I TË MENÇURVE.



**AUTOR: IMAM MUHAMED BIN HIBAN EL-BUSTI (RAHIMULLAH)**

**BURIMI: RAUDATUL UKALA UE NUZ´HETUL FUDALA**

**PËRGATITI: (ROBËT E ALL-LLAHUT)**

## **01. NË LIDHJE ME LIBRIN “RAUDATUL-‘UKALA” E IBN HIBANIT.**

Imam Muhamed bin Salih el-Uthejmin (Rahimullah)

Burimi: Sherh Hiljetu Talebil-‘Ilm, fq. 194

Një nga librat më të mirë që unë kam parë në këtë temë, është libri i Ibn Hiban el-Bustit “Raudatul-‘Ukala”.

Edhe pse është një libër i shkurt, ai është një libër i madh.

Në këtë libër ka kuriozitete madhështore dhe transmetime shumë të mira nga dijetarët dhe njerëzit e mençur.

Ky libër ishte pjesë e programit mësimor në shkollat e kohës sime dhe shumë njerëz kanë përfituar prej tij.

## **02. I MENÇURI DHE SINQERITETI.**

01 - Profeti sal-lAllahu alejhi ve selem ka thënë:

حَدَّثَنَا أَبُو يُسُفَافَةَ بْنُ كَثِيرٍ قَالَ سَمِعْتُ رَسُولَ اللَّهِ ﷺ يَقُولُ مَنْ أَصْدَقُ الرَّجُلِ أَنْ يَصِدُقَ الْفَرَسَ ، وَبِمَا يَصِدُقُ الْفَرَسَ يَصِدُقُ اللَّهَ ، وَمَنْ كَذَبَ الْفَرَسَ ، كَذَبَ الْفَرَسَ ، وَمَنْ كَذَبَ اللَّهَ ، كَذَبَ اللَّهَ ، وَمَنْ كَذَبَ اللَّهَ ، كَذَبَ النَّارَ ، وَمَنْ كَذَبَ النَّارَ ، كَذَبَ النَّارَ ، وَمَنْ كَذَبَ النَّارَ ، كَذَبَ النَّارَ .

**“Bëhuni të sinqertë, sepse sinqeriteti të shpie në drejtësi dhe drejtësia shpie në Xhenet. Në vazhdimësi njeriu promovon sinqeritetin derisa të shkruhet si i sinqertë tek Allahu. Ndërsa, largohuni nga gënjeshtira, sepse gënjeshtira të shpie në mëkat dhe mëkati të shpie në Zjarr. Në vazhdimësi njeriu gënjen derisa të shkruhet si gënjeshtar tek Allahu.”**

02 - Allahu Xhela ue ‘Ala ka nderuar gjuhën mbi të gjitha gjymtyrët e tjera të trupit. E ka ngritur atë në shkallën më të lartë, duke e bërë të qartë këtë ndershmëri, ngase i ka dhënë asaj mundësinë që të flasë dhe të shprehë Teuhidin ndryshe nga gjymtyrët e tjera trupore. Prandaj, njeriu nuk duhet që këtë gjymtyrë ta mësojë në gënjeshtër, por gjithmonë ta flasë të vërtetën dhe të thotë atë që i sjell dobi në të dy jetët, sepse gjuha kërkon atë që ajo vepron zakonisht: Në qoftë se është mësuar me të vërtetën, ajo do ta flasë të vërtetën e në qoftë se është mësuar me gënjeshtërën, ajo vetëm do të gënjejë.

03 - Ismail bin Ubejdilah ka thënë: **“Abdul-Melik bin Mervani më tha: “Mësoja bijve të mi sinqeritetin ashtu siç ia mëson atyre Kuranin. Mbaj ata larg nga gënjeshtira, edhe nëse u rrezikohet jeta.”**

04 - Ali el-Behdelij ka thënë: **“Kam qenë me Ibn Umerin radijallahu anhu kur një irakian i tha atij: “Ti bir i mynafikut!” Ibn Umeri i tha atij: “Mjerë për ty! Mynafiku kur flet, gënjen, e thyen premtimin kur premtion dhe nuk e kryen punën që i është besuar.”**

05 - Fudajl bin ‘Ijadh ka thënë: **“Asnjë pjesë mishi nuk është më e dashur tek Allahu sesa gjuha e sinqertë. Dhe nuk ka asnjë pjesë mishi që urrehet më shumë nga Allahu sesa gjuha gënjeshtare.”**

06 - Çdo gjë me të cilën zbukurohet njeriu, është e lehtë ta gjeshe e ta huazosh, përveç gjuhës e cila nuk shpreh diçka përveç asaj me të cilën është mësuar. Sinqeriteti e shpëton njeriun, ndërsa gënjeshtira e shkatërron atë. Ai që kontrollon gjuhën, do të zgjidhet udhëheqës i popullit të tij. Ndërsa, ai që gënjen shumë, nuk të le hapësirë që t’i besosh për asgjë. Nuk ka mundësi të gënjejë njeriu, derisa mos ta konsiderojë gënjeshtërën si diçka të lehtë/normale.

07 - Muhamed bin Ka’b el-Kuradhi ka thënë: **“Gënjeshtari gënjen sepse e sheh veten e tij të pa vlerë.”**

08 - Nëse dëmi i vetëm i gënjeshtres do të ishte që mos të konsiderohesh i sinqertë, të folurit e së vërtetës është e mjaftueshme që të jetë obligim. Ndërsa, nga pasojat e gënjeshtres është se gënjeshtari harron. Dhe kur njeriu është i tillë, kjo i shëmbëllen sikurse atij i cili në vazhdimësi thërret në poshtërim ndaj vetvetes.

09 - Nasr bin Ali el-Xhehdamij ka thënë: **“Allahu na ka ndihmuar neve kundër gënjeshtarëve, duke bërë që ata të harrojnë.”**

10 - Ez-Zuhri ka thënë: **“Po ta kishe parë Tavusin, menjëherë do ta kishe kuptuar se ai nuk gënjen kurrë.”**

11 - **Gjuha është një kafshë grabitqare.** Nëse e frenon atë, shpëton e nëse e lë atë të lirë, ajo e kafshon edhe pronarin e saj. Gënjeshtari zbulohet përmes gjuhës së tij. I mençuri nuk futet në diçka për të cilën nuk ka dije, por akuzohet për dijen që ai e ka, sepse gënjeshtria është prijësi në mëkate. Gënjeshtria tregon anët e këqija dhe fsheh anët e mira të njeriut. Nuk është e lejuar që të përhapësh diçka menjëherë pasi ta dëgjosh atë, ngase ai që përhap gjithçka që dëgjon, nënçmon idetë e veta dhe shkatërron besimin që njerëzit e kanë ndaj tij.

12 - Ibn Mesudi radijallahu anhu ka thënë: **“Është e mjaftueshme që besimtari të bie në gënjeshtër, nëse ai flet gjithçka që dëgjon.”**

13 - Isa bin Merjem alejhis-selam ka thënë: **“E përgëzoj atë që e ruan gjuhën e tij, e zgjeron shtëpinë e tij dhe qan për gabimet e veta.”**

14 - Sinqeriteti, në të dy botët, e ngrit personin, ndërsa gënjeshtria e ulë atë në të dy botët. Nëse sinqeriteti nuk do të ishte tipar i mirë/i lavdërueshëm, përveçse kur njeriu të njihet me këtë cilësi (**sinqeritetin**) do të pranohej edhe gënjeshtria e tij e do të konsiderohej e vërtetë, do të ishte e detyrueshme për të mençurin që ta mësojë gjuhën e tij të flasë vetëm të vërtetën dhe t'i shmanget gënjeshtres. Ndonjëherë heshtja është më e mirë sesa të folurit, sepse çdo herë që gabon kur të flasësh, aty vendin e ka pasur heshtja.

15 - Umer bin Hatabi radijallahu anhu ka thënë: **“Nuk do ta shijojë robi besimin e vërtetë përderisa nuk i braktis grindjet edhe nëse ai ka të drejtë dhe përderisa gënjen kur ai bën shaka edhe nëse është i sigurt se do t'i bëjë njerëzit të qeshin.”**

16 - Abdullah bin ‘Amri radijallahu anhu ka thënë: **“Largohu nga ajo e cila s’është në interesin tënd, mos flit për atë që nuk ka të bëjë me ty dhe ruaje gjuhën tënde ashtusiq i ruan parat tua.”**

17 - I mençuri nuk mund të jetë i tolerueshëm me gjuhën e tij. Ai që flet shumë, bën gabime të shumta. Ndërsa, gabimet tuaja mund të reflektojnë edhe tek të tjerët. Në këtë mënyrë, bën veprime të cilat sjellin rezultate të pariparueshme.

18 - Plagët e gjuhës nuk shërohen kurrë dhe ajo që prehet me anë të gjuhës nuk kthehet asnjëherë në vendin e saj. Kur fjala lëndon zemrën, ajo nuk mund të shërohet për një kohë të gjatë dhe kjo arrihet vetëm pas një trajtimi intensiv.

19 - Ka njerëz të cilët nderohen vetëm për shkak të kujdesit që kanë në të folur dhe ka të tillë që poshtërohen vetëm për shkak të moskujdesit në të folur. Ndërsa, i mençuri nuk mund të jetë me të poshtëruarit.

20 - Ibn Sirin ka thënë: “Fjalët e tepërta peshojnë më rënd sesa gënjeshtria e komikut.”

### **03. FJALË TË ARTA RRETH MENÇURISË DHE TË MENÇURVE.**

Ebu Hatim ka thënë: “Nuk di asnjë hadith autentik nga Profeti salallahu ajehi ue selem në lidhje me mençurin, ngase ata të cilët kanë transmetuar në lidhje me këtë, fjalët e tyre nuk merren (v.p.: dijetari përmend një numër transmetuesish të të cilëve nuk u merret hadithi).”

Është mençuri dashuria e njeriut ndaj moralit të mirë dhe urrejtja ndaj të këqijave.

Me mençuri arrihet lumturia, largohet monotonia e vetmisë dhe ikën varfëria. Nuk ka asnjë pasuri më të vlefshme sesa ajo; nuk plotësohet feja e njeriut pa mençuri.

Habib el-Xhal-lab ka thënë: “Është pyetur Ibnul-Mubarak për gjënë më të mirë që i është dhënë njeriut, ai tha: “Mençuria e thellë.” Pastaj i thanë: “Në qoftë se nuk e ka këtë?” Ai tha: “Sjellja e mirë.” Pastaj i thanë: “Nëse ai nuk ka këtë?” Ai tha: “Vëllai i cili e udhëzon në rrugë të drejtë.” Pastaj i thanë: “E nëse nuk e ka këtë?” Ai tha: “Heshtja e gjatë.” Pastaj i thanë: “Në qoftë se ai nuk e ka as këtë?” Ai tha: “Vdekja e shpejtë.”

Mençuria është dy llojesh: **E natyrshme dhe e fituar**. Mençuria e natyrshme është si toka, e ajo e fituar është si uji. Me mençurinë e natyrshme, njeriu nuk mund të arrijë deri tek zgjedhja dhe veprimi i duhur nëse nuk posedon edhe mençurinë e fituar,

ngase kjo e fundit e drejton dhe e përgatit të natyrshmen nga mos të rënit në mëkate. Mençuria e natyrshme tek njeriu është sikurse degët e një peme, kurse mençuria e fituar është ushqimi i frutave të saj.

I mençuri është i detyruar ta ushqejë mençurinë e tij me urtësi (**dije**) më shumë sesa që e ushqen trupin e tij me ushqim. Ushqimi i trupit është të ngrënit, kurse ushqimi i mençurisë është urtësia. Ashtu siç trupi vdes pa ngrënë e pa pirë, po ashtu edhe mençuria vdes nëse nuk ushqehet me dije.

Të udhëtosh nëpër vende të ndryshme dhe të përfitosh nga njerëzit, kjo bën që njeriu të fitojë dije dhe mençuri, edhe nëse paratë do të harxhohen gjatë udhëtimit.

Mençuria është ilaçi i zemrës, është bartëse e atyre që janë të përkushtuar në arritjen e saj, është gjëja përmes së cilës fitohet ahireti, është kurorë e besimtarit në këtë botë dhe armë në fatkeqësi. Kurse atij që i mungon mençuria, nuk do t'i jepet lavdi, e pasuria nuk do t'ia ngritë statusin shoqërorë. Nuk është i mençur ai i cili jepet pas kënaqësive të kësaj bote përpara ahiretit. Ashtu siç injoranca është sëmundja më e rëndë, ashtu edhe mungesa e mençurisë është varfëria më e rëndë.

Mençuria dhe teket e njeriut janë dy të kundërta. Prandaj, është e obligueshme që ta zgjerosh dijen dhe përmes saj të ruhesh nga teket e epshet. Në qoftë se nuk e dallon njërën nga tjetra, atëherë duhet zgjedhur atë që është më së largëti nga teket dhe epshi juaja, ngase sa më larg që qëndron ndaj kësaj, ti do të përmirësosh brendinë tënde. Mençuria me dije të shëndoshë e përmirëson njeriun.

I mençuri nuk duhet të bie në depresion, ngase kjo nuk i sjell asnjë dobi. Depresioni pakëson mençurin, kurse i mençuri nuk duhet të pikëllohet. Pikëllimi vjen si rezultat i brengave, kurse brengat e vazhdueshme pakësojnë mençurinë.

Me mençuri forcohet zemra, me dituri ëndrrat bëhen realitet. Shtylla e lumturisë është mendja e shëndoshë, kurse mençuria del në pah atëherë kur njeriu duhet të bëjë zgjidhjen.

## **04. FJALË TË ARTA RRETH VLERËS SË MENÇURISË.**

01 - I mençuri, përmes virtyteve të tij të mira, bëhet i bukur në dukje edhe nëse është i shëmtuar. Ndërsa, virtytet e këqija të njeriut jo aq të mençur sa duhet, e shëmtojnë atë në dukje edhe nëse ai është i bukur.

02 - I mençur nuk shqetësohet se do të jetë i varfër, ngase i mençuri në përgjithësi do të bëhet i pasur. Ndërsa, nuk duhet besuar se pasuria e të pasurit injorant do të mbetet për një kohë të gjatë, sepse pasuria e vërtetë është mençuria dhe veprat e mira.

03 - Sëmundjet e mençurisë janë mendjemadhësia dhe arroganca, belatë e rënda dhe luksi i tepruar. Nëse belatë janë të vazhdueshme e të tepërta, atëherë mençuria humbet, e nëse tepruhet në luks dhe kjo gjë është e vazhdueshme, atëherë shkatërrohet pasuria dhe njeriu llastohet së tepërmi.

04 - **Më mirë është që të kesh një armik të mençur, sesa një mik injorant.**

05 - Mu'aujeh bin Kurrah ka thënë: **“Ka njerëz që bëjnë haxhin, umren, marrin pjesë në luftë, falen e agjërojnë. Megjithatë, në Ditën e Gjykimit ata shpërblehen vetëm sipas vlerës së mençurisë së tyre.”**

06 - Hafs bin Humejd el-Ekkaf ka thënë: **“I mençuri nuk bën padrejtësi, ngase devotshmëria e tij nuk e lejon padrejtësinë.”**

07 - Ashtu siç **“qëllimi i pastër”** pa sukses në vepër nuk sjell dobi, siç bukuria nuk sjell dobi pa tërheqje, ashtu siç gëzimi i përkohshëm nuk sjell dobi pa sigurinë për të qenë i vazhdueshëm dhe afërsia familjare pa dashuri ndërmjet të afërmeve, e njëjta gjë është edhe me mençurinë, e cila nuk sjell dobi pa devotshmëri në zemër dhe vepra të duhura. Karakteri i pastër varet nga mençuria e njeriut.

08 - I mençuri nuk flet derisa të pyetet, nuk diskuton shumë nëse fjalët e tij nuk pranohen dhe nuk përgjigjet derisa të jetë i sigurt se atë që po e flet, a është e drejtë.

09 - I mençuri nuk e nënvlerëson askënd. Ai që nënvlerëson pushtetarin, e ka shkatërruar jetën e vet. Ai që nënvlerëson të devotshmit, e ka shkatërruar fenën e tij. Ai që nënvlerëson vëllezërit e tij, ai humbur karakterin dhe ai që nënvlerëson një njeri të rëndomtë, ai e ka rrezikuar veten e tij.

10 - I mençuri është i vetëdijshëm për të metat që i ka, ndërsa ai që nuk i sheh të metat e tij, nuk i sheh të mirat e të tjerëve. Dënimi më i rënd me të cilin mund të goditet njeriu, është që mos t'i sheh të metat e tij dhe ai që nuk i di të metat e tij, ai nuk mund t'i braktisë ato. E njëjta gjë ndodh kur ti nuk mund t'i vlerësosh të tjerët për të mirat që i kanë, nëse nuk di ato.

## **05. KAPITALI I MENÇURISË QËNDRON NË NJOHJEN E PASOJAVE TË MUNDSHME.**

01 - Kapitali i mençurisë qëndron në njohjen paraprake të pasojave të mundshme.

02 - Është e detyrueshme për të mençurin që t'i shmanget tri gjërave, ngase ato e shkatërrojnë mençurinë e tij më shpejt sesa zjarri që djeg barin e thatë: të qeshurit e shumë (të qeshurit me zë të lartë), shpresat e shumta dhe konfirmimi i pasaktë **(kur dëshiron të vërtetosh ndonjë gjë).**

03 - I mençuri për shokun e tij jep jetën dhe pasurinë, atij ia ofron njohuritë, tregohet me të i afërt dhe ia jep çdo gjë që është e vetja; armikut ia jep drejtësinë dhe devotshmërinë, ndërsa personit të rëndomtë i ofron buzëqeshje dhe përshëndetje.

04 - I mençur merr ndihmë vetëm nga ai për të cilin e di se dëshiron ta ndihmojë, flet vetëm me atë nga i cili përfiton, përveç në ndonjë rast urgjent.

05 - I mençuri nuk tregon për dijen që posedon, ngase cilësi e të mençurve nuk është të pretendojnë se dinë, por cilësi e të mençurve është kur të tjerët ia atribuojnë dijen atij **(të mençurit)** dhe mos mërzia për gjërat e dynjallëkut kur ata i humbasin.

06 - I mençuri respektohet edhe nëse nuk ka pasuri, ashtu siç njerëzit frikësohen nga luani edhe nëse ai është i sëmurë.

07 - Fjalimi i të mençurit është i drejtë, sikurse trupi i shëndetshëm, e të folurit e injorantit është i shtrembër, sikurse trupi kur sëmuret.

08 - Fjalimi i të mençurit edhe nëse është i shkurtër, lë përshtypje shumë pozitive, sikurse mëkati i mëkatarit edhe nëse është i vogël, përshtypja që lë është shumë e madhe **(ngase vjen si rezultat i të keqes së madhe që ai ka).**

09 - Prej mençurisë është që të sigurohesh për veprimin që dëshiron ta bësh.

10 - Sëmundja e mençurisë është dashuria ndaj vetvetes. I mençuri e ka për detyrë që të bëjë durim me fqinjin e keq, shoqëruesin e keq dhe me ndenjësin e keq, ngase atyre nuk mund t'i shmanget gjatë tërëjetës së tij.



## 06. CILËSIA MË E MIRË ËSHTË MENÇURIA.

01 - Shu'be ka thënë: “Mençuria e njeriut është e vogël. Nëse ne shoqërohemi me njerëz që janë më pak të mençur, do humbet edhe ajo mençuri e pakët që e kemi. Ndërsa, kur unë shoh dikë që rri me një person që ka më pak mençuri sesa ai, atëherë filloj ta urrej atë.”

02 - Tipari i parë më i mirë, i cili mund t'i jepet një personi në këtë botë, është mençuria. Kjo është një nga më të mirat që Allahu mund t'i japë robit të Tij. Prandaj, nuk është e lejuar për ta njollosur dhuratën e Allahut, duke qëndruar me një person që nuk është i tillë.

03 - Njeriu i urtë është i obliguar të sillet mirë dhe të heshtë shumë. Gjithashtu, kjo i përket karakterit të Profetëve. Sjellja e keqe dhe të folurit e tepërt janë prej cilësive të njerëzve të këqij e të pavlerë.

04 - I mençuri nuk ka shpresa të mëdha (në të cilat mbështet për së tepërmi). Ai që ka shpresa të shumta, do të ketë veprime të pakta. Ai që vdes (ai që nuk vepron), nuk ka asnjë dobi nga shpresat e tij.

05 - I mençuri nuk hyn në “luftë” pa përgatitje. Ai nuk debaton pa prova, nuk bën mundje pa forcë, sepse mençuria ngjall shpirtrat, ndriçon zemrat, i realizon veprimet dhe i jep kuptim jetës.

06 - Ajo që e shton mençurinë e njeriut, është që të jetë afër me njerëzit sikurse vetja e tij dhe të shmanget nga ata që janë ndryshe prej vetes së tij.

07 - Ebu Malik el-Gazzi ka thënë se e ka dëgjuar babanë e tij, duke thënë: “Ulu me ata që janë të shkathët, qofshin miq apo armiq, sepse mençuria kërkon mençurinë.”

08 - Shoqërimi me të mençurit ka dy kuptime. E para: përkujtosh vetes tënde atë për të cilën personi i mençur ka nevojë për të. E dyta: që ta paralajmërosh vetën tënde nga diçka të rrezikshme, për të cilën injoranti ka nevojë ta dijë.

09 - Afërsia me të mençurit është fitore e të mençurve dhe një mësim për kundërshtarët e tij (që nuk janë sikur ai).

Kjo vlen për të gjitha situatat. Ai duhet ta përkëdhelë vetëm me ata të cilët janë në gjendje ta përkëdhelin atë dhe duhet të shkojë vetëm tek ata që duan tu shkojë atyre.

10 - Nëse mençuria do kishte pas prindër, ata do të ishin durimi dhe qëndrueshmëria.

## **07. I MENÇURI DHE FRIKA NDAJ ALLAHUT.**

01 - I mençuri është i obliguar ta dijë se mençuria ka degët e urdhresave dhe ndalesave, për të cilat ai duhet të ketë njohuri, t'i aplikojë ato në kohën kur kërkohet, që të dallohet nga njerëzit e thjeshtë.

02 - Dega e parë e mençurisë është frika e vazhdueshme ndaj Allahut dhe korrigjimi/përmirësimi i anës së brendshme. Ai që korrigjon anën e brendshme të tij, e jashtëmja e tij do t'i korrigjohet nga Allahu. Ai që shkatërron të brendshmen e tij, Allahu do t'ia shkatërrojë anën e jashtëme të tij.

03 - Malik bin Dinar ka thënë: **“Bën tregti me bindjen ndaj Allahut dhe do të fitosh pa ty kthyer malli prapa.”**

04 - Shtylla e adhurimeve në jetën e kësaj bote është që ta përmirësosh anën e brendshme dhe t'i shmangesh asaj që e shkatërron atë.

05 - Njeriu i mençur është i detyruar të kujdeset për anën e brendshme të tij dhe ta ruajë zemrën në çdo rast. Zemra shkatërrohet kur kohët përkeqësohen dhe humbasin kënaqësitë.

06 - Malik bin Dinar ka thënë: **“Zemra pa dhimbje demolohet si shtëpia pa banorë. Zemrat e devotshmëve vlojnë nga veprat e mira. Zemrat e mëkatarëve vlojnë nga mëkatet. Allahu sheh brengat tona, prandaj shikoni se me çfarë preokupoheni - Allahu pastë mëshirë mbi ju.”**

07 - Hasan el-Basriu ka thënë: **“Ju qëndroni këtu dhe prisni që t'ju vijë momenti i vdekjes. Ndërsa, kur të vdisni ju, do ta merrni mesazhin. Prandaj, merrni nga ajo që keni për atë që ju pret!”**

08 - I mençuri është i detyruar që të shfrytëzoj devotshmërinë që ka në përmirësimin e të ardhmes së vet, duke korigjuar anën e brendshme të tij, duke i përmirësuar veprat e tij dhe refuzojë çdo gjë që ia shkatërron bindjen.

09 - Halid er-Rib'ij ka thënë: “Lukmani ka qenë një rob nga Abisinia dhe ka punuar si zdrukthëtar. Një ditë pronari i tij e urdhëroi që ta therë një qengj dhe i tha: **“Mi jep dy pjesët më të mira të trupit të qengjit!”** Lukmani ia solli gjuhën dhe zemrën. Pas disa ditësh pronari i tij e urdhëroi përsëri që ta therë një qengj dhe i tha: **“Mi jep dy pjesët më të këqija të trupit të qengjit!”** Ai ia solli gjuhën dhe zemrën. Pastaj, pronari i tha: **“Kur kërkova nga ti që të mi sjellësh dy pjesët më të mira nga trupi i qengjit, ti ma solle zemrën dhe gjuhën dhe kur kërkova nga ti që të mi sjellësh dy pjesët më të këqija të trupit të qengjit, ti prapë mi solle zemrën dhe gjuhën.”** Në këtë rast, Lukmani iu përgjigj: **“Nëse këto dy pjesë janë të mira, ato janë më të mirat dhe nëse janë të këqija, atëherë ato janë më të këqijat.”**

Salih bin Hasan ka thënë: **“Hyra tek Umer bin Abdil-Azizi dhe e dëgjova duke thënë: “Robi nuk e ka frikë Allahun para se ai ta shijojë poshtërimin.”**

10 - I mençuri kontrollon zemrën e tij me kalimin e kohës, qëndron larg nga çdo ndalesë, kryen lloje të ndryshme të urdhëresave dhe është i gatshëm të përmirësohet kur ai bën gabime. Njeriu nuk do të jetë në gjendje t'i bëjë të gjitha këto, nëse fillimisht nuk sigurohet për atë që është duke vepruar.

01 - Muhamed bin Ali bin Husein ka thënë: **“Kur t'i mbush njeriu dyzet vite, një thirrës thërret në qiell: “Udhëtimi gati po fillon. Përgatite ushqimin tënd!”**

02 - I mençuri është i detyruar të kujdeset që të mos i ngurtësohet zemra. Nëse mbreti është i mirë, edhe ushtarët janë të mirë e në qoftë se ai është i shkatërruar, edhe ata janë të shkatërruar.

03 - Umer bin Hatabi radijallahu anhu ka thënë: **“Ulu me ata që shpesh pendohen, sepse zemrat e tyre janë më të butat.”**

04 - Një njeri i tha Hasan el-Basriut: **“Si jeni? Si e ke gjendjen?”** Ai u përgjigj: **“Si të jetë gjendja nëse njeriu përjeton mëngjesin dhe mbrëmjen, duke pritur që vdekja ta marrë atë dhe pa e ditur se çfarë do të ndodhë me të?”**

05 - el-Hasan el-Basri: **“Vepra më e mirë është frika ndaj Allahut dhe meditimi.”**

## 08. TË MËSUARIT DHE I MENÇURI.

01 - Kur i mençuri mbaron me korrigjimin e së brendshmes së tij, ai obligohet që vazhdimisht të kërkojë dituri. Nuk është e mundur për të arritur diçka në mënyrë të pastër pa dituri të thellë rreth asaj që kërkon. I mençuri nuk duhet të qëndrojë larg nga ajo gjë (**dija**), e cila bën që engjëjt t'i shtrijnë krahët e tyre mbi të.

02 - Nuk është e hijshme që gjatë jetës të kërkojë afërsinë ndaj pushtetarëve apo të ketë motive të tjera të kësaj bote. Ah, sa e shëmtuar është që dijetari t'i nënshtrohet njerëzve, të cilët janë të dhënë pas kësaj bote!

03 - Fudajl bin 'Ijad ka thënë: "Sa e shëmtuar është të shkosh tek dijetari, ta kërkosh atë dhe të të thuhet se ai është te emiri apo te gjykatësi. Çfarë ka të bëjë dijetari me emirin apo me gjykatësin?! Dijetari duhet të jetë në xhami dhe të lexojë."

04 - Esh-Sha'bi ka thënë: "O Nxënës dije! Mos kërko dije me budallallëk e pakujdesi, por kërko dije me rehati, qetësi dhe pa u ngutur."

05 - Esh-Sha'bi ka thënë: "Kjo dije kërkohet vetëm nga ai person, i cili posedon dy veçori: mençurinë dhe adhurimin. Nëse njeriu ka mençuri dhe nuk jepet pas adhurimit, thonë se kjo dituri arrihet vetëm nga ata që jepen fortë pas adhurimit, dhe si rezultat i kësaj njeriu braktis studimet. E nëse ai është i mirë në adhurim, por nuk është i veçantë në mençuri, thonë se kjo dije arrihet vetëm nga ata që janë të veçantë me mençuri. Dhe si rezultat i kësaj, njeriu largohet nga studimet. Kurse në ditët e sotme, dija po kërkohet nga njerëz që u mungon edhe mençuria e veçantë e edhe adhurimi."

06 - Sufjan eth-Theuri ka thënë: "Dituria fillon me heshtje, pastaj me dëgjim, pastaj duke mësuar përmendësh, pastaj duke vepruar dhe pastaj duke e përhapur atë."

07 - Ebu-Derda radijallahu anhu ka thënë: "Nuk je dijetar para se të jesh nxënës dije, dhe ju nuk je dijetar për shkak të dijës që posedon, derisa të veprosh me dijen që ke."

08 - I mençuri nuk kërkon dije për diç tjetër, përveç se të punojë sipas saj. Ai që kërkon dije për motive të tjera, do të bëhet arrogant dhe kryelartë. Përveç kësaj, ai as nuk do të veprojë/punojë. Kjo gjë i dëmton pasuesit e tij më shumë sesa vetë atë.

09 - Malik bin Dinar: “Nëse njeriu kërkon dije për të vepruar sipas saj, dituria e tij do ta bëjë të lumtur. Mirëpo, nëse e bën këtë për qëllime të tjera, ai bëhet arrogant.”

10 - Sufjan eth-Theuri ka thënë: “Dijetari është mjeku i fesë, kurse paraja është helmi e fesë. Kur mjeku helmohet, si mund të presësh që ai t’i shërojë të tjerët?!”

11 - Ibn Mesudi radijallahu anhu ka thënë: “Përqendrohuni në dije para se ajo të humbet. Humbja e saj është me vdekjen e dijetarëve. Do të gjeni njerëz që pretendojnë se ata ju thërrasin për në Librin e Allahut, ndërsa ata vetë e lënë atë pas shpine. Asnjë nga ju nuk e di se kur do të ketë nevojë për dijen, ose kur dija do të ketë nevojë për të. Përqendrohuni në dije, largohuni nga bidatet dhe kapuni për fenë e të parëve!”

12 - Ibn Mesudi radijallahu anhu ka thënë: “Dituria nuk është në transmetime të shumta, por dituria është ta kesh frikë Allahun.”

13 - Imam Maliku ka thënë: “Dituria nuk është në transmetime të shumta, por dituria është ta kesh frikë ndaj Allahut.”

14 - I mençuri i shmanget çdo gjëje të kësaj bote që mund ta njollosë dijen e tij. Ai duhet të veprojë sipas dijes aq sa mundet, edhe nëse kjo është 5 nga 200 hadithe. Në këtë rast, zekati i dijes është dhënë. Mirëpo, edhe nëse ai nuk mund të punojë me dijen që ka, kjo nuk do të thotë që ai duhet ta braktisë të mësuarit e saj.

15 - Uehb bin Munebih ka thënë: “Kush mëson dije të vërtetë të mbështetur në Sunnet, Allahu kurrë nuk do t’ia marrë mendjen atij.”

16 - El-Mu’temir bin Sulejman ka thënë: “Babai im më shkroi letër kur unë isha në Kufe, në të cilën shkruante: “Bli letra dhe shkruaje dijen, ngase pasuria humbet, ndërsa dituria mbetet.”

17 - Udhëtimi i shumtë, braktisja e familjes dhe vendlindjes (për kohë të gjatë) për hir të dijes, por pa vepruar sipas saj ose për ta mësuar përmendësh, nuk i përket cilësive të të mençurve. Gjëja më e mirë që njeriu mund të bëjë në këtë rast, është

që të priret në të mirë, duke e shoqëruar këtë me përkushtim të madh dhe ruajtje nga mëkatet.

**18 - El-Uaki'i ka thënë: “Mësimin përmendësh ndihmoje duke u ruajtur nga mëkatet.”**

19 - I mençuri nuk lufton për diçka që nuk sjell përfitim në të dy jetët. Nëse ai arrin dituri, ai nuk duhet të jetë koprrac, duke mos ua dhënë të tjerëve atë dije. Mirësia e parë e dijes është mësimdhënia. Unë nuk kam parë askënd, i cili është koprrac në mësimdhënie, veçse nuk kanë përfituar nga dituria e tij. Ashtu siç nuk ka dobi nga uji nën tokë, derisa ai të fillon të rrjedhë, po ashtu nuk ka dobi nga dija përderisa ajo nuk përhapet dhe nuk u jepet/mësohet të tjerëve.

**20 - Ebu Derda radijallahu anhu ka thënë: “Njerëzit duhet të jenë ose dijetarë ose janë duke mësuar. Nuk ka hajr/mirësi në kategoritë e tjera.”**

## **09. I MENÇURI DHE HESHTJA.**

01 - I Dërguari i Allahut salallahu alejhi ue semem ka thënë:

لَا يَسْكُتُ أَوْ خَيْرًا فَا لِيَقُلَ الْآخِرَ الْيَوْمَ وَبِإِذْنِ اللَّهِ يَوْمَ كَانَ مِنَ

**“Kush beson në Allahun dhe Ditën e Fundit, le të flasë mirë ose le të heshtë.”**

02 - Njeriu i mençur është i detyruar të luftojë me vetveten, derisa gjuha e tij të flasë vetëm atë që është e mirë. Gjuha e shpie personin në shkatërrim, ndërsa heshtja e shpie në dashuri dhe respekt. Ai që e ruan gjuhën, do të jetë i qetë. Më mirë është të pendohesh përse ke heshtur, se sa të pendohesh përse ke folur. Heshtja është pushim për trurin, ndërsa të folurit është shqetësim për të.

**03 - Imam Malik bin Enesi ka thënë: “Çdo gjë që bëhet më tepër se sa që duhet, është e mirë/pozitive, me përjashtim të të folurit, i cili është i dëmshëm.”**

**04 - Ebu-Derda radijallahu anhu ka thënë: “Nuk ka asgjë të mirë nga jeta e njeriut, përveçse nga jeta e dy personave: nga i heshturi që kupton dhe dijetari që flet.”**

05 - Njeriu i mençur nuk duhet të mbizotërojë ndaj njerëzve kur ata flasin dhe nuk duhet të kundërshtojë. Edhe pse të folurit në kohën e duhur është paraqitja më e mirë, heshtja në kohën e duhur është një shkallë e lartë.

06 - Allahu 'Azze ue Xhel e ka ngritur gjuhën mbi të gjitha pjesët tjera të trupit. Nuk ka asnjë gjymtyrë trupore që sjell më shumë shpërblim sesa ajo nëse është e bindur. Dhe nuk ka ndonjë gjymtyrë tjetër trupore që bën mëkat më të madh sesa ajo nëse është e pabindur.

07 - Fudajl bin Ijad ka thënë: **“Dy gjëra e ngurtësojnë zemrën e njeriut: “Të folurit e shumtë dhe ushqimi i tepërt.”**

08 - Sufjan eth-Theuri ka thënë: **“Adhurimi fillon me heshtje, pastaj me kërkim të dijes, pastaj duke vepruar sipas këtyre mësimëve, pastaj nxënia përmendësh e pastaj duke i përhapur mësimet.”**

09 - El-Ahnef bin Kajs ka thënë: **“Heshtja e mbron njeriun nga fjalimi i shtrembër, fjalët e rreme, dhe të folurit e tepërt. Përveç kësaj, heshtja është shkak që të tjerët të të respektojnë.”**

10 - Njeriu i mençur është i detyruar të heshtë, derisa të detyrohet të flasë. Sa shumë njerëz pendohen pse flasin dhe sa pak njerëz pendohen pse nuk kanë folur! Njeriu më i pafat dhe më i sprovuar, është ai i cili është sprovuar me të folurit e shumtë dhe ngurtësimin e zemrës.

11 - El-Ahnef bin Kajs tregon se Umer bin Hatabi radijallahu anhu ka thënë: **“O Ahnef! Ai që flet shumë, bën gabime shumë. Ai që bën shumë gabime, e humb turpin. Ai që humb turpin, e humb frikën ndaj Allahut. Ai që humb frikën ndaj Allahut, i vdes zemra.”**

12 - Ali bin Bekkar ka thënë: **“Çdo gjëje Allahu i ka bërë dy dyer, përveç gjuhës që ia ka bërë katër dyer: dy buzët që luftojnë mes vete dhe dy palë dhëmbë që luftojnë mes vete.”**

13 - Njeriu i mençur ka një bilanc mes të dëgjuarit dhe të folurit, bilanc i cili bazohet në atë se i janë dhënë dy vesh në mënyrë që të dëgjojë më shumë, ndërsa një gojë e vetme që të flasë më pak. Kur njeriu flet diçka, nesër mund të pendohet, e nuk do të pendohet **(nuk ka nevojë që të pendohet)** nëse qëndron i heshtur. Të kthehesh prapa për atë që nuk e ke folur **(e ta flasësh)**, është më lehtë sesa të kthehesh prapa **(të pendohesh)** për atë që e ke folur. Nëse njeriu flet diçka, atëherë ai është peng i fjalës së vetë, e nëse nuk e flet ndonjë gjë, atëherë ajo fjalë është peng i tij. Është e

çuditshme se si dikush flet diçka, e nëse atë e dëgjon ndonjëri, i bën dëm atij e nëse nuk dëgjohej, nuk i bën dëm. Prandaj, pse nuk hesht njeriu e të mos e thotë fare?! Ka mundësi që një fjalë e vetme të jetë shkaktare në pengimin e arritjes së ndonjë mirësie apo të të largohet ajo mirësi.

14 - Ebu Derda radijallahu anhu ka thënë: **“Mjafton të përpiqesh të bësh padrejtësi për të qenë zullumqarë. Mjafton të diskutosh pa nevojë për të qenë mëkatar. Dhe është e mjaftueshme të flasësh shumë për të qenë gënjeshtar, përveç atëherë kur ti flet në lidhje me Allahun Tebarake ue Te’ala.”**

15 - Ka’bul-ahbar ka thënë: **“Mirëqenia e njeriut përbëhet prej dhjetë pjesëve, nëntë prej tyre janë tek heshtje.”**

16 - El-Euzai ka thënë: **“Askush nuk është vënë në sprovë më të madhe në fe se sa personi që flet shumë.”**

17 - Halid bin el-Harith ka thënë: **“Heshtja është zbukurimi i të mençurit dhe shëmtimi i injorantit.”**

18 - Nëse në heshtjen nuk do të kishte asnjë veçori të mirë përveç zbukurimit të të mençurit dhe shëmtimit të injorantit, do të ishte e detyrueshme për njeriun që të heshtë sa më shumë. Kushdo që dëshiron të shpëtojë, le ta flasë vetëm atë që pranohet prej tij, të jetë kjo në masë të reduktuar, sepse nuk ka guxim të flasë shumë, përveç budallai dhe ai që është më i miri në të gjitha fushat.

19 - Shumë prej dijetarëve nuk kanë transmetuar hadithe nga njerëzit të cilët flisnin shumë çfarë nuk u takonte. Një shembull i tillë është fjala e Se’idit ku thotë: **“E kam pyetur Hakamin se pse ai nuk ka shkruar (nuk ka marrë dije) nga Zadhani. Ai u përgjigj: “Sepse ai flet shumë.”**

20 - Gjuha e të mençurit fshihet pas zemrës së tij. Kur ai dëshiron të flasë, i kthehet zemrës. Nëse se është në të mirën e tij, flet, përndryshe hesht. Zemra e injorantit është në majën e gjuhës së tij, çfarë i vjen tek gjuha e tij, ai e thotë. Ai që nuk e ruan gjuhën e tij, ai nuk e kupton fenë e Allahut.

21 - Si do që të jetë gjuha e njeriut, e mirë apo e keqe, kjo shfaqet në të gjitha gjymtyrët e tij.

22 - Jahja bin Ebi Kethir ka thënë: **“Nuk ka mundësi që të folurit e njeriut të jetë i mirë, e të mos shfaqet kjo edhe në veprimet e tij.”**



23 - I mençuri nuk flet përderisa nuk pyetet dhe flet vetëm me atë i cili e pranon fjalën e tij. Nëse dikush e shpif apo e fyen, ai nuk i kundërpërgjigjet në asnjë formë. Edhe pse heshtja që nga fillimi është gjëja më e mirë, por padyshim se heshtja është e mirë edhe atëherë kur flitet **(për të)** diçka e keqe.

24 - Ibn Mesudi radijallahu anhu ka thënë: **“Betohem në Allahun e Vetëm, se asgjë nuk meriton të burgoset aq gjatë sesa gjuha.”**

25 - I mençuri e ruan veten e tij në mënyrë që të mos bie në mangësi. Prej mangësive që më së shumti e shkatërron shëndetin e brendshëm dhe shpirtin e tij të mirë, është fjala e tepërt. Kjo vlen edhe nëse është i lejuar të folurit e shumtë. Njeriu nuk mund të qëndrojë i heshtur nëse nuk largohet nga të folurit e lejuar.

26 - Ibrahim et-Tejmi ka thënë: **“Një person i cili shoqërohej me er-Rabi’ bin Hajthem për njëzet vjet, më tha se ai kurrë nuk e kishte dëgjuar atë të thoshte diçka që është e qortueshme.”**

27 - I mençuri duhet të mos flasë shumë fjalë që janë të lejuara, në mënyrë që ai të mos bie në ndalesa, e nga kjo ta shkatërrojë vetveten.

28 - Nëse njeriu flet shumë, mosbindja do t’i hyjë në gjak, ngase nëse robi nuk e flet atë që i sjell dobi në jetën tjetër, për të është më mirë që të mos flasë asgjë.

29 - Muvarrik el-‘Ixxhli ka thënë: **“Ka një gjë që po e kërkoj që njëzet vjet dhe që do vazhdoj ta kërkoj ende.”** E pyetën: **“Çfarë është ajo që po e kërkon?”** Ai tha: **“Që të heshti në lidhje me atë që nuk më përket mua.”**

30 - Kharixheh ka thënë: **“Jam shoqëruar me Abdullah bin ‘Aun për pesëmbëdhjetë vite dhe nuk mendoj se engjëjt shkruan diçka të keqe prej tij.”**

## **10. I MENÇURI DHE TURPI.**

01 - Profeti salallahu alejhi ue selem ka thënë:

شدت ما فاصنع ، ت س تحي لم إذا : الأولى ال نبوة ك لام من ال ناس أدرك مما إن

**“Një nga paralajmërimet e mëparshme të profetëve, të cilën e kanë përcjellë tek popujt e tyre, është: “Nëse nuk ke turp, vepro çfarë të duash!”**

02 - Obligim i njeriut të mençur është që të jetë i turpshëm, sepse turpi është baza i mençurisë dhe e mbjella e mirësisë. Ndërsa, mosturpi është baza e injorancës dhe e mbjella e së keqes. Pra, turpi tregon mençurinë e njeriut, kurse mosturpi e tregon injorancën tek ai.

03 - Ibn Mesudi ka thënë: **“Gjëja më e keqe tek besimtari është të mos poseduarit e turpit.”**

04 - Turp do të thotë t’i shmangesh tipareve të urryera.

05 - **Turpi (v.p. i mirë) ndahet në dy lloje:**

- I pari: **“Të turpëroresh para Allahut në lidhje me mëkatin.”**

- I dyti: **“Të turpëroresh nga njerëzit lidhur me fjalët dhe veprimet që ata nuk i duan.”**

06 - I tërë turpi është i rekomandueshëm. Mirëpo, duhet pasur parasysh që ka turp që është i detyrueshëm dhe turp që është i pëlqyeshëm. Turpi i detyrueshëm është ai turp që të bën ta braktisë atë që Allahu e ka ndaluar. Turpi i pëlqyeshëm është të braktisë ato fjalë dhe veprime që njerëzit nuk e duan.

07 - Turpi është prej besimit dhe besimtari është në Xhenet. Ndërsa, fjalët dhe veprat e këqija, janë ngurtësi dhe mosrespekt, ndërsa këto e shpien njeriun në Xhehenem, përveç atyre që i nderon Allahu me mëshirën e Tij, duke i shpëtuar.

08 - Nëse njeriu në vazhdimisht është i turpshëm, kjo është prej shkaqeve të mirësisë. Në mënyrë të njëjtë, nëse njeriu nuk ka kujdes në fjalët dhe veprat e tij **(nuk turpërohet)**, atëherë arsyeja për të pasur mirësi tek ai njeri, nuk ekziston dhe e keqja tek ai është gjithëpërfshirëse, sepse turpi është pengesa mes personit dhe të gjitha mëkateve/veprimeve të liga. Sa më i fortë të jetë turpi, aq më e pamundshme bëhet veprimi i mëkateve dhe veprave të liga. Dhe me zvogëlimin dhe humbjen e turpit, veprimi i mëkateve dhe veprave të liga bëhet më e lehtë.

09 - Zejd bin Thabit radijallahu anhu ka thënë: **“Ai që nuk turpërohet prej njerëzve, ai nuk turpërohet as prej Allahut.”**

10 - Është detyrë e të mençurit që ta bëjë zakon turpin para njerëzve. Prej begative më të mëdha, është të mësohesh për të pasur cilës të mira e të lavdërueshme, e në të njëjtën kohë t'i shmangesh cilësive të këqija, ashtu siç fryti më i madh i turpit ndaj Allahut që është shpëtimi nga Xhehenemi, duke qëndruar larg nga ajo që Allahu ka ndaluar.

Me turp të madh mbrohet nderi, anët e këqija fshihen dhe anët e mira përhapen. Ata që humbin turpin, humbin edhe gëzimin. Ai që humb gëzimin e tij, ai humb vlerën në sytë e të tjerëve dhe bëhet njeri i urryer tek ta. Ai që urrehet prej njerëzve, atij i shkaktohet dëm. Ai që vajton, humb mendjen. Ai që humb mendjen, më shumë flet në dëm të vetin sesa në dobi të tij. Atij që i mungon turpi, nuk gjen ilaç për vete. Atij që i mungon turpi, nuk ka besnikëri. Atij që i mungon besnikëria, nuk ka miq. Ai që ka pak turp, bën atë që do dhe thotë atë që dëshiron.

## **11. ËSHTË MIRË QË NJERËZIT TË DUAN.!**

01 - I mençuri është i detyruar që të bëhet i mirë tek njerëzit edukatës i mirë dhe të njëjtën kohë duke u shmangur nga edukata e keqe. Njeriu duhet të jetë i tillë sepse edukata e mirë i fshinë mëkatet ashtu siç dielli shkrin akullin. Ndërsa edukata e keqe i prish veprat ashtu siç uthulla e prish mjaltin. Mund të ndodhë që njeriu të ketë edukatë shumë të mirë, por në anën tjetër ka ndonjë sjellje të keqe. Dhe mu kjo e fundit mund të fshijë dhe shkatërroj të gjithë edukatën e mirë që ai posedon!

02 - Ibn Abbasi radijallahu anhu ka thënë: **“Lidhjet farefisnore mund të ndërpriten dhe të mirat e tjetrit mund të shprehen me mosmirënjohje. Por nuk kam parë asgjë më me vlerë sesa lidhja e zemrave me njëra-tjetrën.”**

03 - Fudajl bin ‘Ijad (Rahimullah) ka thënë: **“Nëse shoqërohesh me dikë, atëherë shoqërohu me atë i cili ka edukatë të mirë, sepse shoqëruesi i tillë nuk thërret në diçka tjetër përveç në të mirë dhe gjithmonë gjen rehatinë tek ai. Ndërsa, mos u shoqëro me atë të cilin ka edukatë të keqe, sepse ai thërret vetëm në të keqe dhe shoqërimi me të është mundim. Më parë do shoqërohesha me një mëkatar i cili ka edukatë të mirë, sesa me një të ditur i cili ka edukatë të keqe! Nëse mëkatar i cili ka edukatë të mirë, ai jeton i udhëhequr nga mendja dhe intelekt i tij. Ai është “i lehtë” për njerëzit andaj njerëzit e duan atë. Mirëpo nëse i devotshmi ka edukatë të keqe, njerëzit e konsiderojnë atë të bezdisshëm dhe kështu e urrejnë atë.”**

04 - Hammad bin Selemeh (Rahimullah) ka thënë: “Agjërimi në kopsht është shtirje.” (Do të thotë të agjërosh agjërim nafile ndërsa je duke shëtitur me shokët në mesin e kopshteve që kanë fruta që njeriu rrallë mund t'i gjej. Prandaj, ai që agjëron në këtë situatë ai vetëm shtiret.)

05 - Edukata e mirë të bën të dashur tek njerëzit. Ndërsa edukata e keqe të bën njeri të urrejtur nga të tjerët! Ai që ka edukatë të mirë, ai e mbron nderin e vet. Ndërsa ai që ka edukatë të keqe ai e prish nderin e vet.

06 - Ez-Zuhrij (Rahimullah) ka thënë: “A ka ndonjë dobi nga personi që ka edukatë të keqe?!”

07 - Mejmun bin Mehran (radijAll-llahu anhu) ka thënë: “Gjysma e mençurisë është të fitosh dashurin e njerëzve. Gjysma e dijes është të shtrosh pyetje në mënyrë të mirë. Ndërsa të jetosh thjesht do të thotë që harxhon vetëm gjysmën e kohës duke punuar (dhe pjesën tjetër të kohës e shfrytëzon pozitivisht (v.p.).”

08 - Që të jesh në nevojë për njerëzit dhe që ata të duan ty, është më mirë sesa të mos kesh nevojë për ta ndërsa ata të urrejnë. Ajo që i pengon ata që të duan është edukata e keqe. Ai që ka edukatë të keqe, e lodhë familjen e tij, fqinjët e tij dhe i rëndon vëllezërit e tij. Në këtë mënyrë, ata vetëm duan ta heqin qafe dhe luten që ai të vdes sa më parë.

09 - Njerëzit e perceptojnë një person si të bezdisshëm për shkak të dy arsyeve:

- E para: Sepse ai vepron atë që Allahu e ka ndaluar. Kushdo që i tejkalon kufijtë e Allahut urrehet nga Allahu. Atë që e urren Allahu urrehet nga engjëjt. Pastaj ai urrehet në tokë. Pastaj nuk mund të gjesh pothuajse askënd që nuk e konsideron atë të bezdisshëm dhe që nuk e urren atë!

- Së dyti: Bërja e veprave që njerëzit i urrejnë. Nëse ai është kështu, atëherë ata kanë çdo të drejtë ta konsiderojnë atë të bezdisshëm!

10 - Ebu Mishari (Rahimullah) ka treguar se Hisham bin Jahja (Rahimullah) i ka thënë atij: “Në unazën e të atit tënd - Ebu Ebi Misharit - ishin të shkruar inicialet e fjalës: “Ti je i bezdisshëm! Ik nga këtu!” Andaj, çdo herë kur një njeri ulej me të dhe ai e konsideronte atë të bezdisshëm, ia kthente unazën e tij dhe i thoshte: “Lexo se çfarë shkruan në unazë!” Kështu që kur ai e lexonte largohet menjëherë nga aty.”

11 - Makhlad Ebu ebi-‘Asim (Rahimullah) ka thënë: “Kur unë e urrej një njeri që është afër meje, unë e urrej edhe anën e trupit tim që është nga ai!”

12 - Ebu Bekr el-Merurudhij (Rahimullah) ka thënë: “E kam pyetur Ahmed bin Hanbelin në lidhje me njerëzit e bezdisshëm, ai tha: “Unë e pyeta Bishr el-Haaffin rreth tyre dhe ai tha: “Është mjerim të shikosh në ta.” Unë e pyeta Ahmedin: “Kush janë njerëzit e bezdisshëm.” Ai u përgjigj: “Pasuesit e Bidateve.”

13 - Atë që përmendi Imam Ahmed bin Hanbel (Rahimullah) është mënyra specifike për t’i konsideruar njerëzit si të bezdisshëm. Në qoftë se ata e dinë se një person ia kthen shpinën Sunnetit, ata e urrenin atë për shkak të risisë së tij. Kurse, sa i përket njerëzve të thjeshtë dhe aspekti i përgjithshëm, ata urrenin dhe donin vetëm për karakteret e mira gjegjësisht të këqija.

14 - Ebu Usame (Rahimullah) ka thënë: “Ma sjell dikë që është i lehtë për zemrën, ndërsa të bezdisshmit mi mbaj larg. Të bezdisshmit mi mbaj larg.”

15 - Ibn Sirin (Rahimullah) ka thënë: “E kam dëgjuar një beduin duke thënë: “U alivanosa në moment kur pash një person të bezdisshëm”.”

16 - Ibrahim bin Bukejr (Rahimullah) ka thënë: “Kur Ebu Hurajran e bezdiste shoqërimi i dikujt, thoshte: “O Allah! Na fal neve dhe atë, dhe na mëshiro (na mbroj) neve nga gjendja në të cilën ndodhet ai!”

17 - I mençuri është i obliguar që në asnjë mënyrë të mos ketë ndonjë cilësi që i bën njerëzit ta konsiderojnë atë të bezdisshëm. Por në vend të kësaj, ai duhet të ketë cilësi që i bën njerëzit ta duan atë.

18 - Prej faktorëve që kontribuojnë më së shumti që njerëzit ta duan një person, është të ndihmuarit e njerëzve aq sa ke mundësi dhe t’i ruash ata nga ajo që mund të dëmtohen. Ndërsa ata të cilët nuk kanë para kur t’i takojnë njerëzit, le t’u buzëqeshin atyre. Ngase kjo zë vendin e ndihmës ndaj tyre.

19 - Harun bin Abdil-Khalik el-Mazinij (Rahimullah) ka treguar se Ibn-ul-Mubarak (Rahimullah) u pyet në lidhje me edukatën e mirë, tha: “Buzëqeshje dhe shërbime/ndihmë.”

20 - Muxhahidi (Rahimullah) ka thënë: “Nëse një mysliman takon vëllanë e tij, ia shtrëngon dorën atij dhe i buzëqesh në fytyrë, atij i bien mëkatet ashtu siç bie një bistak hurme nga palma.” Pastaj një njeri tha: O ebul-Haxhaxh, kjo është një vepër fare e lehtë!” Kurse Muxhahidi ia ktheu:

قُلُوبِهِمْ بَيْنَ أَلْفَتْ مَا جَمِيعاً الْأَرْضِ فِي مَا أَنْفَقْتَ لَوْ قُلُوبِهِمْ بَيْنَ وَأَلْفَ وَبِالْمُؤْمِنِينَ بِنَصْرِهِ الَّذِي هُوَ

**“Ai të ka forcuar me ndihmën e Tij dhe me besimtarët, duke i bashkuar zemrat e tyre. Sikur të shpenzoje tërë pasurinë që gjendet në Tokë, nuk do të mund t’i bashkoje zemrat e tyre” 8:62-63**

**A është kjo e lehtë?!”**

## **12. TOLERANCA NDAJ MIKUT.!**

**01 - Ibnul-Hanefijjeh ka thënë: “Nuk është i mençur ai që nuk jeton në mirëkuptim dhe harmoni me personin nga i cili nuk e ka të detyrueshme të jetojë, derisa Allahu ta lirojë nga ai apo t’ia hap rrugët.”**

**02 - Ai që dëshiron të jetojë me njerëzit sipas mënyrës së tij do të njollosë jetën e vet dhe do të humbet dashurin e të tjerëve. Sepse dashuria e tyre arrihet vetëm kur ti i ndihmon ata, por jo në mëkat. Në të kundërtën, nëse ndihma e kërkuar prej jush përfshinë mëkatet, dije se ajo nuk ka as dëgjim dhe as bindje në të.**

**Njerëzit janë krijuar me dëshira dhe natyrshmëri të ndryshme nga njëri-tjetri. Ashtu siç të duket e vështirë që ta braktisësh natyrshmërinë tuaj, edhe të tjerëve ju duket e vështirë që ta braktisin natyrshmërinë e vet. Mënyra e vetme për të arritur dashurinë e pastër të njerëzve, është tu përshtatesh atyre dhe t’i anashkalosh mëkatet që ata bëjnë herë pas here.**

**03 - Hasan el-Basri ka thënë: “O Njeri! Sillu me njerëzit ashtu siç dëshiron ti, por mos harro se ata do të sillen me ty në të njëjtën mënyrë!”**

**04 - Ai që pretendon t’i kënaq të gjithë njerëzit, ai është duke pretenduar diçka të pamundur. Mirëpo, i mençuri duhet të ta kënaq partnerin e tij të jetës dhe atë që e ka të detyrueshme të jetoj me të edhe nëse duhet të jetoj me diçka që parimisht nuk e pëlqen, ose të lë gjëra që parimisht i do, por me kusht që të mos bëj mëkat.**

**05 - Mu’adh bin Sad el-A’uar ka thënë: “Isha duke ndenjor tek ‘Ata bin Ebi Rabaha, dhe përderisa një njeri fliste në atë mexhlis, një njeri tjetër u ngrit nga mexhlisi dhe shkoi. ‘Ata u zemëruan dhe i thanë: “Çfarë është ky zakon?! Ky njeri po flet për diçka që kam më shumë dije, megjithatë unë po rri me të sikurse të mos dijë asgjë ”!”**

06 - Nëse njeriu nuk ka durim me gabimet e njerëzve, rreziku është shumë më i madh që ai të njetosë jetën e tij sesa që ta përmirësoj atë. Gjithashtu, me këtë gjë ai ushqen armiqësi dhe urrejtje ndaj njerëzve dhe nuk mund të fitoj në asnjë mënyrë dashurinë e tyre.

07 - Ebu Derda i ka thënë gruas së tij: **“Nëse unë zemërohem ti duhet të më qetësoh. Nëse ti zemëroresh atëherë unë do të qetësoj ty. E nëse ne nuk bëjmë kështu, shumë shpejt do të ndahemi.”**

08 - Nëse ndodh që i mençuri të shoqërohet me dikë të cilit nuk mund t’i besojë, apo të ketë miqësi vëllazërore me të cilët nuk mund tu besohet; në ndërkohë sheh një gabim tek ta dhe i refuzon për shkak të gabimeve të tyre, ai do të mbetet i vetëm pa asnjë shok. Ai duhet të anashkaloj gabimin e shokut tij të vërtetë dhe jo të përmend gabimin e shokut tij të keq. Sepse diskutimet duhet që më shumë të korrigjojnë rrënjët e dashurisë se sa degët e saj.

09 - Ibn Sheudheb ka thënë: **“Një njeri kishte një skllave me të cilën një natë ai kishte marrëdhënie intime me të fshehurazi. Kur shkoi tek gruaja e tij i tha: “Këtë natë Merjemi e kishte zakon të pastrohej, andaj pastrohu edhe ti!” Më pastaj u pastrua ai dhe gruaja e tij. Mirëpo, Merjemi pastrohej çdo natë.”**

10 - Ebu Sa’ib ka thënë: **“Mos mashtro, sepse mashtrimi është cilësi e mëkatarëve. Këshilloje vëllanë tënd sinqerisht pavarësisht nëse këshilla i vije atij se e mirë apo jo. Ndhimojë atë në çdo rast dhe largohu me të kudo që ai shkon.”**

## **13. I MENÇURI DHE TRAJTIMI I MIRË NDAJ NJERËZVE (PËRHAPJA E SELAMIT.)**

01 - Profeti salallahu alejhi ue selem ka thënë:

بِ يَنْكُم فِ افْ شَوْه ، الأَرْض فِ ي وَضَعَه ، اللهُ أَسْمَاء مِّنَ السَّلَامِ إِنَّ

**“Es-Selam është një nga emrat e Allahut që e ka zbritur në tokë. Prandaj, shpërndajeni atë (selamin) mes jush.”**

02 - Detyrë e të mençurit është që ta përhapë selamin në mesin e njerëzve. Ai që i jep selam dhjetë njerëzve është si të ketë liruuar një skllav.

Selami është diçka që e largon mllëfin i cili gjendet tek njeriu në brendi dhe urrejtjen që njeriu mund ta ketë në zemër. Selami ndërpre në bojkotin tek njerëzit dhe i bën vëllezërit të jenë të butë ndaj njëri-tjetrit.

03 - Personi i cili i pari jep selam, është ndërmjet dy të mirave: Allahu 'Azze ue Xhel e ngrit atë një nivel më të lart se sa personin që ai jep selam, për shkak se ai ia kujtoi atij selamin dhe përgjigjes së engjëjve në Selamin e tij në qoftë se njerëzit janë të pakujdesshëm në kthimin e selamit atij.

04 - Zubejd el-Jamii ka thënë: **“Njeriu më bujar është ai që jep diç nga pasuria e tij pa kërkuar shpërblim për këtë. Falësi më i mirë është ai që fal edhe pse mund të ndëshkojë.**

**Njeriu më i mirë është ai që mban lidhjet me atë që i shmanget(e bojkoton/largohet) prej tij. Dhe koprraci më i madh është ai që nuk jep selam.”**

05 - Kur myslimani të takohet me një mysliman tjetër, ai duhet t'i japë atij selam duke buzëqeshur. Ai që vepron kështu, i bien mëkatet e tij ashtu siç i bien pemës gjethet në vjeshtë. Ai që i buzëqeshet njerëzve, e meriton dashurinë e tyre.

06 - Buzëqeshja është cilësi e dijetarëve dhe e njerëzve të mençur. Buzëqeshja shuan zjarrin e kokëfortësisë dhe nxitjen e urrejtjes. Buzëqeshja të mbron nga ai që të urren dhe të shpëton nga ai që është i prirë që të shkatërroj marrëdhëniet midis njerëzve.

07 - 'Uruesh ka thënë: **“Më është treguar se në shkrimet e shenjta të mëparshme shkruan: Bir i dashur! Buzëqeshu njerëzve dhe flit me ta bukur (fjalë të mira dhe të zgjedhura). Në këtë mënyrë njerëzit do të duan më shumë se sa tu japësh dhurata”.**

08 - Nuk është e vepër e mirë për personin e mençur, të udhëzuar e të devotshëm që ta takoj atë që nuk është aq i devotshëm sikurse ai, me ballë të rrudhur. Pra, ai duhet t'i buzëqesh atij.

09 - Habib bin Ebi Thabit ka thënë: **“Prej moralit të mirë të njeriut është që, të buzëqesh kur flet me shokun e tij.”**



10 - Se'id bin Abdirr-Rahman ez-Zubejdi ka thënë: “Më pëlqejnë dijetarët që janë të thjeshtë, që buzëqeshin dhe qeshin lehtësisht. Sa për atë që të takon me ballë të rrudhur duke menduar se ai të ka kryer një punë, e lus Allahun që të mos ketë ndonjë të tillë!”

## 14. I MENÇURI DHE SHAKAJA.

01 - Transmeton Katade, se Enes bin Malik ka thënë: “Profeti salallahu alejhi ue selem kishte një shërbëtor me emrin Enxhesheh i cili kishte zë të bukur, dhe njëherë pre herësh, Profeti salallahu alejhi ue selem i tha atij:

الْقَوَارِيرُ تَكْسِرُ لَا أَنْجِشَةَ يَا

“O Enxhesheh! Mos i the shishet!”

Ndërsa Katade, në lidhje me këtë hadith ka thënë: “E kishte për qëllim grat e dobëta.” (Shih Sahihun e Muslimit (2323))

02 - I mençuri duhet t'i përfitoj njerëzit me shaka dhe duke lënë anash zemërimin.

03 - Ekzistojnë dy lloje të shakasë: e lavdërueshme dhe e qortueshme. Shakaja e lavdërueshme nuk ka të bëjë me atë që Allahu ‘Azze ue Xhel urren, si mëkatet apo shkëputja e lidhjeve farefisnore.

Shakaja e qortueshme është ajo që shkakton armiqësi, largon respektin, prishë miqësinë, bën që i dobëti (ai që nuk kontrollon veten në fjalë v.p.) të sulmojë dikë dhe që fisniku ta urrej atë.

04 - Rabi'ah ka thënë: “Unë ua tërheq vërejtjen ndaj shakasë, sepse ajo shkatërron dashurinë dhe e futë urrejtjen në brendinë e njeriut.”

05 - Ibn Hubejk ka thënë: “Thuhet se: nuk duhet bërë shaka me fisnikun, sepse ai do të të urrejë, e as me të dobëtin sepse ai do të të sulmojë.”

06 - Sa vëllezër janë ndarë për shkak të shakasë? Sa bashkëshortë i kanë prishur lidhjet e tyre po për shkak të saj?! E gjitha filloi me një shaka.

07 - El-Hakem ka thënë: **“Ishte zakon të thuhej se as nuk duhet grindur e as nuk duhet bërë shaka me shokun tënd. Muxhahidi kishte një shokë i cili bënte shaka me të. Kjo përfundoi që të dy ia kthyen shpinën njëri-tjetrit dhe nuk shkëmbyen më shumë se sa selam me njëri-tjetrin derisa ai vdiq.”**

08 - Ka shaka që shkakton grindje. Andaj, i mençuri është i obliguar t’i shmanget kësaj. Sepse, grindjet janë të dënueshme në çdo rast. Kur një person grindet **(debaton)** me dikë, kjo ose ndodhë mes tij dhe mes dikujt që është më i ditur se ai; - e si mund që njeriu të debatoj me dikë që ka dije më shumë se ai?! - Ose grindet **(debaton)** me një person që është më pakë i ditur se ai; - e si të debatoj me dikë, kur ai ka më pak dije?!

09 - Grindja është vëllai i urrejtjes, ashtu siç debati është motra e armiqësisë! Edhe nëse grindja ka dobi, dobia e saj është e vogël, ndërsa e keqja e saj është shumë më e madhe. Grindjet shpjen në sharje dhe shpifje, gjë e cila shpie në konflikt, dhe konflikti çon deri në derdhjen e gjakut. Kurrë nuk është grindur njëri me dikë tjetër, veçse grindja të mos ketë ndryshuar zemrat e tyre!

10 - Bilal bin Sa’di ka thënë: **“Nëse sheh një person që i ndërhyt njerëzve në fjalë, grindet me ta dhe vetëm mendimet e tij i duket të drejta, dije se ai njeri veçse ka humbur.”**

11 - Nëse shakaja ka të bëjë me mëkatet ato e nxijnë fytyrën dhe bëjnë që zemra të rrjedh gjak. Ato përhapin urrejtje dhe i japin jetë armiqësisë. E nëse shakaja nuk është e qortueshme, atëherë ajo e ngushëllon të pikëlluarin, e përmirëson miqësinë, i jep jetë shpirtave dhe largon turpin që duhet larguar. I mençuri bën shaka të këndshme, pa dashur të bezdis dikë apo të kënaq dikë duke dëmtuar dikë tjetër.

12 - Ibrahim ka thënë: **“Vetëm ai që të do bën shaka me ty.”**

13 - Muhamed bin el-Munkedir ka thënë: **“Nëna ime tha për mua kur isha i vogël: Mos bën shaka me fëmijët e tjerë në mënyrë që të mos humbësh vlerën në sytë e tyre, ose në mënyrë që ata të mos gjejnë arsye që të sulmojnë.”**

14 - Umer bin Hatabi radijallahu anhu ka thënë: **“Ai që qesh shumë humbet respektin. Ai që bën shaka nuk do të merret kurrë si njeri serioz. Kushdo që e shpeshton një veprim të caktuar, njihet me të në mesin e njerëzve!”**

15 - Ai që bën shaka me një person që nuk është në të njëjtin nivel me të, do të humbë vlerën në sytë e tij dhe pas një kohe ai do t’i vërsulet, edhe në qoftë se

shakaja është plotësisht e drejtë. Është e lejuar të bësh shaka me njerëzit e nivelit tënd.

16 - Unë e urrej të bërit shaka kur njerëzit e rëndomtë janë të pranishëm. Gjithashtu, unë e urrej mosbërjen shaka kur je me ata që janë të barabartë me ty.

17 - Ebu Abdirr-Rrahman Ebu el-A'raxh ka thënë: **“Ibrahim bin Ed’ham na tregonte hadithe dhe bënte shaka me ne. Por menjëherë kur e shihte dikë që nuk ishte prej nesh, ai thoshte: Ai është spiun.”**

## **15. I MENÇURI DHE TË SHMANGURIT PREJ NJERËZVE.**

01 - Detyrë e të mençurit është që t’i shmanget njerëzve në përgjithësi dhe të qëndrojnë larg nga të ndenjurit shumë me ta. Nëse përfitimi i vetëm në këtë do të ishte mos-bërja mëkate, do të ishte e mjaftueshme për të që të mos e njollos gjendjen e tij të shëndosh me diçka që shpie në zënka.

02 - Umer bin el-Hatab ka thënë: **“Merreni si pjesë të rëndësishme (të jetës suaj) mos-përzierjen me njerëz.”**

03 - Sufjan bin ‘Ujejneh ka thënë: **“Kam parë në ëndërr Sufjan eth-Theurin dhe se unë i thash atij: “Më këshillo ndonjë gjë.” Ndërsa ai më tha: “Ke kujdes nga njohja me shumë njerëz. Ke kujdes nga njohja me shumë njerëz. Ke kujdes nga njohja me shumë njerëz”.**”

04 - Ahmed bin Hanbeli ka thënë: **“E pashë se si Ibnus-Sammak i shkroi letër njërit prej vëllezërve të tij: “Po pate mundësi, bëhu vetëm rob i Allahut dhe mos bë asgjë tjetër (largohu nga njerëzit sa më shumë v.p.).”**

05 - I mençuri nuk duhet të robëroj veten duke ndenjtur me njerëzit e nivelit të tij, duke luftuar për të drejtat e tyre dhe duke i duruar dëmet e mundshme që ata i shkaktojnë. E gjithë kjo, nëse ai ka mundësi ta bëj këtë. Ngase, mos-përzierja me njerëzit e pastron zemrën dhe do ta ruaj kohën e adhurimit nuk do t’i kaloj së koti. Kështu vepruan të parët tanë të mirë dhe të mëvonshmit prej tyre.

06 - Ibnul-Mubarak ka thënë: “Një herë prej herësh, Fudajli e vizitoi Davud et-Taiun, por Davudi e mbylli derën. Pastaj Fudajli u ul jashtë shtëpisë dhe filloi të qante, ndërsa Davudi ishte ulur brenda në shtëpi dhe qante.”

07 - Bekr Muhamed el-‘Abid ka thënë: “Davud et-Taiu më tha mua: “O Bekr! Qëndro larg nga njerëzit ashtu siç qëndron larg nga kafsha e egër grabitqare”.”

08 - Abdul-‘Aziz bin Hattab ka thënë: “Disa njerëz panë se një qen i madh i zi ishte shtrirë pranë Malik bin Dinarit, andaj i thanë atij: “O Ebu Jahja! A nuk po e sheh qenin afër teje?” Ai u përgjigj: “Ky është më i mirë se një shoqëri e keqe.”

09 - Kur dijetarët si Davud et-Taij qëndruan larg prej njerëzve të veçantë - e cila tregon se ata u shmangën edhe njerëzve të thjeshtë -, ata e bënë këtë në mënyrë që të ushtrojnë vetveten që të jenë në gjendje t’i përballojnë vetmisë. Kam frikë se ai i cili nuk braktis atë që është e lejuar do të bie në të ndaluarën. Lidhur me shkakun e kërkon të shmangurit nga të gjithë njerëzit, kjo ndodh kur nuk ka ndonjë të mirë në ta dhe e keqja është e përhapur në mesin e njerëzve. **Sepse njerëzit në përgjithësi janë kurioz/e duan të mirën, ndërsa e shfaqin gjithnjë të keqën! Nëse ai është dijetar ata thonë se ai është bidatçi. Nëse ai është i pa ditur ata e fyejnë atë. Nëse ai është më i lartë se ata, ata e kanë zili atë. Nëse ai është nën ta ata e poshtërojnë atë. Nëse ai flet ata thonë se ai po dërdëllit. Nëse ai hesht ata thonë se ai është budalla. Nëse ai është kursimtar ata thonë se ai është koprrac. Nëse ai është bujar ata thonë se ai është shpenzues i pakujdesshëm. Ai i cili e lejon veten e vet që të mashtrohet nga këta njerëz, në fund do të pendohet , apo do të bie në rangun e tyre!**

10 - El-Ekkaf Hafs bin Humejd ka thënë: “Jam shoqëruar me njerëz për pesëdhjetë vite radhazi, dhe ajo që pashë ishte se, askush nuk fshehu ndonjë nga të metat e mia, askush nuk u mundua të më pajtoj me dikë që unë i kisha ndërprerë lidhjet dhe nuk ndjehesha i sigurt ndaj atyre kur ata zemëroheshin. Andaj, të kalosh kohën me njerëz të tillë, është budallallëk i madh!”

11 - Malik bin Enes ka thënë: “Më kanë treguar se Ebu Dherri radijallahu anhu ka thënë: “Në të kaluarën njerëzit ishin gjethe pa gjemba. Sot janë gjemba pa gjethe”!”

12 - I mençuri e di se karakteret/sjelljet e njerëzve janë të ndryshme. Pothuajse të gjithë dëshirojnë ndihmesën dhe askush nuk dëshiron të lihet mënjanë. Kur të shohësh diçka të pazakontë tek vëllai yt fillon ta mos e duash atë. Kur të sheh diçka të pazakontë mërzitësh nga ai. Kur të mërzitësh nga ai fillon ta konsiderosh atë të bezdisshëm. Kur ta konsiderosh atë të bezdisshëm, atëherë fillon urrejtja. Kur

urrejtja vije, së bashku me të vjen edhe armiqësia. Është budallallëk i madh që i mençuri të kaloj kohën me një njeri të tillë.

13 - Mekhuli ka thënë: “Nëse të shoqëruarit me njerëz është i mirë, dije se edhe më e shëndetshme është të shmangesh prej tyre.”

14 - Malik bin Dinar ka thënë: “Ai i cili nuk është i rehatshëm me fjalën e Allahut dhe pos kësaj ka nevojë për fjalët e njerëzve, atëherë dije se ai njeri ka pak dije, ka zemër të verbër dhe një jetë së koti!”

15 - Ibrahim el-Harbi ka thënë: “Një mbrëmje, pas akshamit, unë shkova në Xhaminë e Shenjtë dhe pash Fudajl bin ‘Ijadin ulur aty, dhe kështu shkova dhe u ula me të. Ai më tha: “Kush është aty?” Unë thashë: “Ibrahimi.” Ai tha: “Pse ke ardhur këtu?” Unë u përgjigja: “Unë të pashë të vetmuar, prandaj erdha tek ti.” Ai tha: “A dëshiron të shpifësh, të zbukurohesh apo që të shohin njerëzit? Unë i thashë: “Jo.” Ai tha: “Andaj, largohu prej meje.”

## 16. I MENÇURI DHE LIDHJA VËLLAZËRORE. (01)

01 - Transmetohet se Enes bin Malik ka thënë:

الصدع بن بين و مالك بن بين أخى و الدرداء أبى و سلمان بن بين سلم و عليه الله صلى الله رسول أخى  
ج ثامة بن

“I Dërguari i Allahut salallahu alejhi ue selem vëllazëroi (bëri lidhje vëllazërore) në mes të Selmanit dhe Ebu Derdasë dhe mes ‘Arf bin Malik dhe es-Sa’b bin Xheththameh.”

02 - I mençur nuk duhet të neglizhojë krijimin e lidhjeve të ngushta me vëllezërit e tjerë dhe të qëndruarit pranë tyre në raste të fatkeqësive e të sprovave, ngase veprimet ndryshe, e bëjnë atë të përfolur për mangësi të shumta dhe mungesë të pastërtisë shpirtërore.

03 - Muhamed bin Uasi’ ka thënë: “E vetmja gjë që ka mbetur në këtë jetë janë tre gjëra: Namazi me xhemat, jeta e thjeshtë dhe vëllai (shoku) i mirë me të cilin ndihesh rehat.”

04 - Njeriu i mençur nuk duhet të ketë lidhje vëllazërore me atë të cilin nuk i del në ndihmë në kohët e vështira dhe nuk gëzohet së bashku me të atëherë kur ai gëzohet. Dhe, ka mundësi që një njeri me të cilin ke lidhje vëllazërore (**një shok i sinqertë**), të jetë më i mirë sesa vëllai nga gjaku. Ndërsa faktori që më së shumti i shërben ruajtjes së lidhjes vëllazërore me të tjerët, është të jesh i kujdesshëm ndaj gjërave që ata i pëlqejnë.

05 - Dashuria e vërtetë dhe e pastër është ajo dashuri që nuk ka të bëjë me interesin. Ndërsa nuk priset në qoftë se ne nuk i jep diçka. Dashuria është siguri, ashtu siç urrejtja është frikë.

06 - I mençuri nuk duhet të ketë asnjë lidhje vëllazërore përveç me atë të cilin e kundërshton në lidhje me epshin, e përkrah atë në mendimin e drejtë dhe që ana e brendshme e tij i përshtatet anës së jashtme. Vëllezërit më të mira janë ata që nuk polemizojnë, ashtu siç lavdërimi më i mirë është ai që vije nga fjalët e njerëzve të mirë. Njeriu nuk mund të ndjehet rehat kur afër e ka të dobëtin ashtu siç nuk mund të kesh dashuri ndaj të pabesit.

07 - Ma'mer ka thënë: **“Shkova në shtëpi tek Katade dhe isha i etur. Në dhomë ishte një enë e madhe me ujë. E pyeta nëse më lejohet të pijë nga uji? Ai u përgjigj: “Ti je shoku ynë”. Ahmedi tregon se, Abdurrazaku në lidhje me këtë shprehje kishte thënë: “Katade deshi të thotë se, shoku nuk ka pse të pyes!”**

08 - Ejub es-Sikhtijani ka thënë: **“Ajo çfarë më motivon që të bëjë haxhin shpesh, është se, përgjatë kësaj periudhe mund të takoj vëllezër që unë nuk mund ti takojë kurrë.”**

09 - I mençur duhet ta dijë se, qëllimi i vëllazërisë nuk janë takimet për të ngrënë dhe për të pirë. Por, ajo që bën të krijohet dhe të ruhet vëllazëria është, vazhdueshmëria në të ecurit e drejtë, të folurit me zë të ulët, të mos bëhet njeriu i vetëkënaqur, modestia dhe lënia anash e mospajtimeve.

10 - Nuk është mirë për njeriun që tu kërkojë vëllezërve të tij shumë shërbime, në mënyrë që pas një kohe të mos konsiderohet i bezdisshëm. Kur fëmija mëkon për një kohë të gjatë në gjirin e nënës, ka mundësi që ta lëndoj atë dhe ajo të detyrohet ta largojë atë pa dashje dhe me forcë!

## **17. I MENÇURI DHE LIDHJA VËLLAZËRORE. (02)**

01 - Kushdo që mund të ndihmojë vëllanë e tij me diçka që e lehtëson fatkeqësinë e tij ose vështirësin e tij duhet ta bëjë këtë.

Myslimani e ka për obligim të mos jetë shkaktar që vëllai i tij të humbas diçka për të cilën ai ka nevojë. Ngase ky veprim për të është fatkeqësi dhe besimtari nuk duhet t'i gëzohet vëllait të vet me këtë.

02 - I mençur nuk duhet të ketë lidhje vëllazërore me mëkatarët. Sepse mëkatar i është sikurse gjarpri i shurdhër i cili vetëm di të kafshoj dhe të lëshoj helmim. Dije se, mëkatar i ka shoqëri dhe mban lidhje vëllazërore me të tjerët vetëm për interesat e tij personale. Fisniku krijon simpati për fisnikun vetëm nga një takim i vetëm, edhe nëse ata nuk takohen më pas kësaj here!

03 - Sufjani tregon se, Junus bin Ubejd u godit me një fatkeqësi; kështuqë, disa i thanë atij: **“A nuk të ka vizituar Ibn ‘Aun?”** Ai tha: **“Nëse ne besojmë në dashurinë e vëllait tonë ndaj nesh, atëherë nuk dëmtohem nëse ai nuk na viziton.”**

04 - I mençuri nuk duhet të jetë arrogant e i pasjellshëm ndaj vëllezërve të tij. Nëse ai e bën një gabim të tillë, duhet që t'i jap fund menjëherë. Njeriu nuk duhet të jetë i pakujdesshëm qoftë edhe ndaj një sjelljeje të pahijshme.

Ai që e nuk është i kujdesshëm ndaj sjelljeve të këqija edhe në rast se ato janë të vogla, shumë shpejt ai mund të bëjë sjellje të këqija të mëdha. Prandaj, është detyrë e çdonjërit që menjëherë t'i jap fund sjelljeve të këqija pa asnjë vlerësim ndaj vetvetes. Nuk ka mirësi në besueshmërinë pa besnikëri, ashtu siç nuk ka mirësi në dijen pa pasur frikë Allahun.

05 - I mençuri duhet të ketë lidhje vëllazërore vetëm me njerëz që kanë të menduar të pastër/të mirë, fe të mirë, dije e moral të mirë, mençuri e cila është fituar për shkak të qëndrimit të vazhdueshëm me të devotshmit. Dhe dije se, të shoqëruarit me një budalla i cili është rritur me njerëz të mençur është më e mirë sesa të shoqëruarit me një të shkathët i cili është rritur me njerëz injorantë!

06 - I mençuri hulumton në lidhje me njerëzit para se ai të krijoj lidhje vëllazërore me ta. Një nga përvojat më të mira të një personi është shprehja e dashurisë edhe në raste të zemërimit.

07 - Llukmani e kishte porositur djalin e tij duke i thënë: **“Bir i dashur! Nëse dëshiron të krijosh lidhje vëllazërore me një njeri, atëherë fillimisht duhet ta**

zemërosh atë! Në rast se ai nuk është i drejtë ndaj teje kur ai është i zemëruar, ti duhet ta braktisësh atë menjëherë.”

08 - Shu'be ka thënë: “Një herë prej herësh, Ibn Mesudi radijallahu anhu i tha shokëve të tij: “**Ju jeni ata të cilët ma largoni mërzinë!**”

09 - Halid bin Safuan ka thënë: “**Vetëm tri gjëra kanë mbetur nga kënaqësitë e kësaj bote: lidhja bashkëshortore, të kesh fëmijët pranë dhe takimi me vëllezërit.**”

10 - I mençuri duhet ta dijë se, asnjë lumturi nuk mund të krahasohet me lumturinë që vjen nga të shoqëruarit me vëllezërit, dhe se asnjë brengë nuk mund të krahasohet me humbjen e tyre!

## **18. I MENÇURI DHE LIDHJA VËLLAZËRORE. (03)**

01 - I mençuri nuk duhet ta përrul vëllanë e tij për gabimin që ai mund të bëj. Ngase, në përgjithësi, ata kanë natyrshmëri të njëjtë. Prandaj, secili duhet të ketë durim me vëllanë e vet.

02 - I mençuri nuk duhet të ketë zili vëllezërit e tij. Zilia ndaj vëllait e infekton dashurinë ndaj tij, ashtu sikurse bujaria dhe zemërgjerësia në dashuri është shtytësi më i madh i angazhimit në të vepruar. Dashuria e vërtetë në asnjë mënyrë nuk mund të burojë nga një zemër e sëmurë. Njeriu duhet që të mos e bezdis/rëndon vëllanë e tij. Ndërsa, ai që e bezdis/rëndon vëllanë, e lë të qetë armikun dhe ia lehtëson atij punën **(ndaj tij dhe vëllait të tij (v.p.))**.

03 - Një nga faktorët që më së miri ngushëllon në rast telasheve, është të pajtuarit me caktimin e Allahut dhe takimi me vëllezërit.

04 - Ibrahim bin Abdil-lah el-Adani ka thënë: U pyet Sufjan eth-Theurij në lidhje me ujin (burimin) e jetës, kurse ai u përgjigj duke thënë: “**Takimi me vëllezërit.**”

05 - Sufjan eth-Theurij ka thënë: “**Ka ndodhur që të kem takuar një vëlla dhe të kem përfituar nga ai takim një muaj më pas!**”



06 - Ebu Sulejmani ka thënë: “Kam shikuar në një nga vëllezërit e Irakut, dhe përgjatë një muaji sa vepra ndonjë gjë, më dukej se atë e kam pranë.”

07 - Rabi'ah ka thënë: “Dinjiteti është dy llojesh: Dinjiteti i udhëtimit dhe dinjiteti i shtëpisë.

- Dinjiteti në udhëtim është që të t'i paguash shpenzimet e të tjerëve, të mos jesh i përcarë me shokët dhe të bësh shaka shumë por pa e zemëruar Allahun.

- Dinjitet në shtëpi është të qenit i rregullt në xhami, të kesh shumë vëllezër që i do për hir të Allahut dhe të lexosh shumë Kuran.”

## **19. I MENÇURI DHE ARMIQËSIA NDAJ NJERËZVE.**

01 - I mençuri duhet ta dijë se, ai që e do atë nuk ia ka zili, dhe se ai që nuk ia ka zili nuk i bëhet armik në asnjë moment. Prandaj, duhet pasur kujdes ndaj armikut të fshehur më shumë sesa ndaj armikut të hapur.

02 - Veprimi më i mirë për të mençurin është që të qëndroj nga larg çdo lloji i armiqësive se të hyjë në to.

03 - El-E'uer ka treguar se, Ismai'li ka thënë: “Armiqësinë e një personi mos e blej qoftë edhe me dashurinë e 1000 njerëzve.”

04 - Nuk i lejohet njeriut të mençur që të hakmerren për të keqen që ia bën dikush. Gjithashtu, nuk është e lejueshme për të që të mallkojë dhe të përgojë armikun e tij. Ndiha më e mirë që mund të jepet kundër atij që të shkakton armiqësi, është që ai (**armiku**) të përmirësohet në lëshimet që i bën, e të cilat janë shkak që ty të të shkaktoj probleme.

05 - I mençuri shikon vendin se ku do të vejë këmbën para se të marrë hapin. Pastaj i afrohet armikut gjithnjë e më afër (**në mënyrë që ta përfitoj atë (v.p.)**), por jo në atë formë që e bën armikun t'i hudhet mbi. I mençuri nuk urren përderisa mund të gjej rrugëdalje deri tek dashuria ndaj personit. Nuk urren atë që detyrohet të jetoj me të, dhe nuk i shfaq armiqësi armikut të zemëruar dhe të padurueshëm. Kjo është zgjidhja e vetme për të shpëtuar prej tij.

06 - Pozita më stabile ndaj armikut është të mos flitet keq për të përderisa nuk është koha për një gjë të tillë. Fitorja më e lehtë ndaj armikut është që armiqtë tuaj të merren me njëri-tjetrin.

07 - Ibnus-Simak ka thënë: **“Mos u frikëso nga ai i cili ruhesh, por ki frikë nga ai të cilit i beson!”**

08 - Armiqësia e krijuar pas miqësisë me dikë është shumë e shëmtuar, ndërsa i mençuri nuk e bën një gabim të tillë! Nëse ndodhë që ai të bie në këtë, gjithnjë e më një hapësirë që të kthehet prapa dhe të përmirësohet.

09 - Abdullah bin Hasan i ka thënë Muhamedit birit të tij: **“Të këshilloj që të kesh kujdes e të mos armiqësohesh me askënd prej njerëzve. Sepse, armiqësia nuk të shpëton nga planet fatkeqe e dinake të armikut të mençur, dhe as nga sulmet e papritura të injorantit.**

10 - I mençuri kurrë nuk ka armiqtë ndaj askujt. Sepse, armiqësia patjetër se do të jetë ndaj njërit prej dy personave: armikut të mençur, nga planet dinake të të cilit kurrë nuk mund të jesh i sigurt, ose ndaj injorantit, sulmet e të cilit gjithnjë janë të atypëratyshme dhe asnjëherë nuk je i sigurt nga ai.

## 20. I MENÇURI DHE SHOQËRIA. (01)

01 - I Dërguari i Allahut salallahu alejhi ue selem ka thënë:

مثل الـسوء جـليس مـثل و ، رـيحـه مـن أـصـابـك مـنـه يـ ذلـك لـم يـن ، الـعـطـار مـثل الـصـالـح الـجـلـيس مـثل  
شـرـه أـصـابـك نـارـه يـ صـبـك لـم يـن ، الـقـيـن

“Shembulli i shokut të mirë është sikurse shembulli i shitësit të parfumeve, nëse nuk merr diçka prej tij, të paktën do të dalësh nga ai me aromë të mirë. Ndërsa, shembulli i shokut të keq është sikurse shembulli i farkëtarit, nëse nuk djegësh nga zjarri që i përdor, së paku do të dalësh nga ai duke ndjerë erë të keqe.”

02 - I mençuri qëndron me njerëzit e mirë dhe shmanget nga të këqijët. Kjo ndodh sepse, dashuria për të mirët krijohet me shpejtësi ndërsa prishja e kësaj lidhje ndodh me ngadalë. Kurse, dashuria për të këqijët shpejt priset dhe merr një kohë të gjatë që ajo të krijohet.

Shoqërimi me njerëz të këqij bën që të lindin mendime të këqija për njerëzit e mirë. Dhe, ai që rri me njerëz të këqij nuk do të mund të shpëtoj që të mos bëhet edhe ai një prej tyre.

03 - I mençur e ka për detyrë që të shmanget nga njerëzit e dyshimtë në mënyrë që edhe ai të mos konsiderohet i tillë. Ashtu siç shoqërimi me njerëz të mirë sjell mirësinë, edhe shoqërimi me njerëz të këqij sjell të keqen.

04 - Sufjan bin Ujejneh ka thënë: **“Ai i cili e do një njeri të mirë, në të vërtetë ai e do Allahun Tabarake ue Te’ala.”**

05 - Malik bin Dinar ka thënë: **“Që të zhvendosësh shkëmbinj me njerëz të mirë është më mirë sesa të hash ëmbëlsira me mëkatarë.”**

06 - I mençur nuk e njollos nderin e tij, e as nuk adaptohet me rrugët e së keqes duke u shoqëruar me të këqijtë. Por, gjithmonë është syçelë në mbrojtje të nderit të vet, dhe egon e tij mëson që gjithmonë të shoqërohet me njerëzit e mirë. Me kalimin e kohës, njeriu diç tjetër nga ajo që ajo që duket në shikim të parë.

07 - Ebu ‘Amr bin el-‘Ala ka thënë: **“Një herë prej herësh, Se’id bin Xhubejri më pa duke ndenjor me disa të rinj, dhe më tha: “Çfarë të shtynë që të ndesh me të rinjtë? Do të ishte më mirë për ty që të shoqërosh të moshuarit”!”**

08 - Ebu Derda radijallahu anhu ka thënë: **“Që të kesh një shokë të mirë është më mirë sesa të jesh i vetëm. Por, më mirë të jesh i vetëm sesa të kesh një shok të keq. Gjithashtu, më mirë është të flasësh mirë se të heshtësh, dhe më mirë është që të heshtësh sesa të flasësh keq.”**

09 - I mençuri nuk shoqërohet me të këqijtë, sepse shoqërimi me të keqin është pjesë e zjarrit që i sjell njeriut mëri. Dashuria e tij nuk është ashtu siç duhet të jetë, dhe ai nuk e mbanë fjalën që ta jep.

10 - Nga lumturia e një personi janë katër gjëra: **“Që bashkëshorti/ja të jetë e të njëjta mendime me të, t’i ketë fëmijët e devotshëm, vëllezërit e tij të jenë të mirë dhe që furnizimi i tij të jetë në vendin e tij (e të mos ketë nevojë që të punoj jashtë vendit (v.p.)).**

## **21. I MENÇURI DHE SHOQËRIA. (02)**

01 - Nëse nuk përfitoni nga shoqëria juaj, atëherë dije se, më mirë që të ulesh me një qen sesa me të! Ai që shoqërohet me një njeri të keq asnjëherë nuk është i sigurt, ashtu siç dhe bëhesh i dyshimtë nëse ecën rrugëve të tilla **(të dyshimta)** apo të rrugëve të këqija.

02 - Hasan el-Basriu ka thënë: **“Humbja jote më e madhe është të humbasësh një personi i cili gjithmonë të jep mendimin e tij dhe të këshillon kur ti ke nevojë. Mirëpo, kur ta humbasësh atë, do ta kërkojsh një tjetër, dhe nuk do ta gjesh dot!”**

03 - Uehb ka thënë: **“Allahu mund të shpëtojë një fis të tërë për hir të një njeriu të mirë!”**

04 - I mençuri është i detyruar të kërkojë mbrojtjen e Allahut nga shoqëria që nuk e ndihmon atë për ta përmendur Allahun, që nuk e ndihmon atë kur ai harron përmendjen e Tij dhe kur ai është i pakujdesshëm **(ndaj përmendjes së Allahut)**, ata e shtyjnë që të mos e përmend Atë.

05 - Ai i cili shoqërohet me shokë të këqij, ai është më i keqi prej tyre. Ashtu siç njeriu i mirë shoqërohet vetëm me të devotshmit, edhe i keqi shoqërohet me mëkatarët. Nëse detyrohesh që për një çast të shoqërohesh me dikë, atëherë shoqërohu me ata të cilët kanë dinjitet.

06 - Abdul-Vahid bin Zejd ka thënë: **“Shoqërohuni me ata që janë fetarë nga njerëzit e kësaj jete dhe jo me dikë tjetër. Nëse detyrohesh që të shoqërohesh me dikë tjetër, atëherë shoqërohu vetëm me ata që kanë dinjitet, ngase, ata nuk janë të pasjellshëm.”**

## **22. I MENÇURI DHE DASHURIA PËR VËLLANË (SHOKUN.)**

01 - Nëse Allahu të mençurit i dhuron dashurinë e sinqertë të një myslimani i cili është i kujdesshëm që ta ruaj atë dashuri, ai detyrohet t'i përmbahet asaj çfarë kërkon dashuria e ndërsjellë. Pastaj, ai duhet të kalitë vetveten që të mbaj lidhjen

me të edhe atëherë kur ai i shkëput ato, të shkojë tek ai edhe kur ai ia kthen shpinën atij, t'i japë **(qoftë edhe dhuratë (v.p.))** atij edhe atëherë kur ai e privon atë nga e drejta themelore e tij, t'i afrohet edhe atëherë kur ai largohet, dhe ta konsiderojë atë sikurse të ishte shtyllë për të!

02 - Një nga mangësitë më të mëdha që njeriu mund të ketë, është që të jetë jostabil në dashuri ndaj të tjerëve.

03 - El-Asme'ij ka thënë: “Një beduin i mençur ka thënë: “Njeriu më i pavlerë për njerëzit, është ai i cili nuk kërkon të ketë vëllezër **(shokë)**! Mirëpo, ka edhe një person që është edhe më i pavlerë, dhe ai është: ai i cili ka pasur vëllezër **(shokë)** ndërsa ka humbur dashurinë e tyre që dikur kishin për të! Ai i cili di të bëj zgjidhje e mirë për veten e tij, di të bëj zgjedhjen edhe për të tjerët.”

04 - I mençuri duhet të mos jetë i shkuajdesur në ruajtjen e dashurisë. Ai nuk mund t'i ketë disa fytyra apo dy zemra. Por e brendshmja e tij përputhet me të jashtmen që ai shfaq, dhe fjalët e tij janë në përputhje me veprat që ai i vepron. Nuk ka mirësi tek vëllazëria, mes të së cilëve të metat dhe gabimet e tyre vetëm shtohen.

05 - Jahja bin Ebi Kethir thotë se, Sulejmani alejhis-selam i ka thënë djalit të tij: **“Bir i dashur! Ruaje lidhjen me shokun tënd të parë, dhe mos mendo se i dyti është sikurse i pari, e ndoshta as nuk i afrohet atij!”**

06 - I mençuri nuk mund të jetë shokë me atë i cili ka shumë fytyra, dhe ai nuk lidhet vëllazërisht me personin i cili ia kthen shpinën. Ai shfaq për shokun atë dashuri që e mban brenda vetes.

Edhe pse më shumë mban dashuri përbrenda sesa atë që ai shfaqë. Kur ndodh ndonjë keqkuptim apo mosmarrëveshje mes tyre, ai është me të ashtu siç ka qenë edhe para se të ndodh ajo gjë. Sepse vëllai **(shoku)** i vetëm i cili ka vlerë është ai që posedon këtë cilësi.

07 - Hisham bin 'Urueh thotë se, babai i tij ka thënë: **“Nga urtësitë e mëhershme është: ”Duaje shokun tënd dhe shokun e babait tënd.”**

08 - Një nga cilësitë më të mëdha të dukshme përmes të cilave identifikohet nëse dashuria është e shëndoshë apo e keqe, është **“të shikuarit”**. Në të shumtën e rasteve, shikimi i mirë shfaq atë dashuri që njeriu ka në zemër. Dhe e kundërta e kësaj, shikimi mund të fsheh atë urretje që njeriu ka përbrenda. Prandaj, njeriu i mençur e sheh dashurinë e cila gjendet në zemër dhe që shfaqet në sytë e vëllait të tij.

09 - Ibrahim bin Shiklah ka thënë: “Nëse një person të thotë ty se të do apo të urren, atëherë atë që ai fsheh në zemër gjykoje të jetë ashtu siç ai shprehet, ngase ti nuk mund ta dish se çfarë ai mban në brendi. Prandaj, trajtoje atë sipas asaj që ai të shfaqet me anë të të shprehurit.”

10 - Ibrahim el-Xhehni ka thënë: “Shenjat e dashurisë i sheh në personin i cili të do edhe nëse ai nuk të shprehet!”

## 23. I MENÇURI DHE ZGJEDHJA E SHOQËRISË.

01 - I Dërguari i Allahut salallahu alejhi ue semem ka thënë:

اخذ تلف منهنّا ت ناكرو وما اند تلف، منهنّا ت عارف فما مجدنة جنود الأرواح

“Shpirtrat janë sikurse ushtarë të mobilizuar. Shpirtrat e afërt (të dashur me njëri-tjetrin) qëndrojnë pranë njëri-tjetrit dhe ata të cilët janë të kundërt (me njëri-tjetrin) ndahen/largohen.”

02 - Arsyeja për afërsinë respektivisht ndarjen e njerëzve, është njohja dhe mosnjohja e njëri-tjetrit (**gjetja e gjuhës së përbashkët me njëri-tjetrin dhe e kundërta e saj**). Kur njerëzit gjejnë gjuhën e përbashkët ata bashkohen, ndërsa kur mes tyre ka diçka që i bën të ndahen, ata qëndrojnë larg njëri-tjetrit.

03 - Muxhahidi ka thënë: “Një herë prej herësh, Ibn Abasi pa një njeri dhe tha: “Ky më do mua!” Të pranishmit i thanë atij: “Si e di këtë?” Ai u përgjigj: “Sepse unë e dua atë dhe “Shpirtrat janë sikurse ushtarë të mobilizuar. Shpirtrat e afërt (**të dashur me njëri-tjetrin**) qëndrojnë pranë njëri-tjetrit dhe ata të cilët janë të kundërt (**me njëri-tjetrin**) ndahen/largohen”.”

04 - Katade, në lidhje me fjalët e Allahut:

خَلَقَهُمْ وَلِدْلِكَ رَبُّكَ رَحِمَ مَنْ إِلَّا مُخْتَلِفِينَ يَرَالُونَ وَلَا

“...por ata vazhdojnë të jenë të përçarë, përveç atyre, që i ka mëshiruar Zoti yt.  
Për këtë qëllim Ai i krijoi ata.” 11:118-119

**ka thënë: “I krijoi për t’i mëshiruar dhe që ata ta adhurojnë Atë. Kur jemi tek ata që i nënshtrohen/adhurojnë Allahun, themi se, zemrat dhe dëshirat e tyre janë të përbashkëta edhe pse ata jetojnë në vende të ndryshme. Ndërsa ata që i bëjnë mëkate Allahut, zemrat e tyre janë të përçara edhe nëse jetojnë në të njëjtin vend!”**

05 - Një nga shenjat më të mëdha që na bëjnë ta njohim dikë në çdo lëvizje dhe qëllim të tij, është të merret parasysh se me kë ai flet dhe kë e do. Sepse, njeriu është në fenë e shokut të tij dhe shpendët fluturoes i bashkohen vetëm tufave të llojit të tyre!

06 - Hubejrah Allahu e mëshiroftë ka thënë: **“Njahi njerëzit në bazë të shoqërisë së tyre.”**

07 - Imam Maliku Rahimullah ka thënë: **“Llojlojshmëria e njerëzve është sikurse llojlojshmëria e shpezëve. Pëllumbi rri me pëllumbin, sorra rri me sorrën, rosa rri me rosën e trumcaku rri me trumcakun! Ashtu ndodh edhe me njeriun; çdo njeri rri me ata të llojit të vet.”**

08 - I mençuri shmanget nga shoqërimi me njerëzit që zakonisht janë labil dhe largohet nga shoqërimi i atij i cili nuk është i përkushtuar ndaj fesë. Ngase, ai që shoqërohet me dikë, njerëzit e identifikojnë përmes tij. I mençuri duhet të shoqërohet vetëm me atë i cili është sikurse ai apo që i ngjason atij. Nëse patjetër duhet të shoqërohesh me njerëzit, atëherë zgjidh atë i cili ta zbukuron ndejnën, nuk të krijon reputacion negativ, nëse të sheh duke bërë ndonjë vepër të mirë e vlerëson atë, nëse të sheh duke bërë ndonjë vepër të keqe ta fsheh atë para të tjerëve **(nuk ta shfaq atë)**, nëse jeni të heshtur ai fillon bisedën dhe nëse i kërkon diçka ai nuk bëhet koprrac ndaj teje.

Mirëpo, shumica e njerëzve në ditët e sotme, ana e tyre e jashtme është ndryshe me anën e tyre të brendshme!

09 - Ka prej njerëzve që posa t’i shohësh të pëlqejnë, dhe sa më shumë t’i njohësh aq më shumë të pëlqejnë. Ndërsa, në anën tjetër ka njerëz që posa t’i njohësh i urren, dhe sa më shumë t’i njohësh urrejtja për ta gjithnjë shtohet. Në realitet, ndarja mes tyre ka ndodhë shumë më parë, dhe atë për shkak se karakteri i tyre nuk përputhet, ndërsa ndarja e tyre është për shkak se brendia e tyre është e ndarë.

10 - Arsyeja për shfaqjen e pikëllimit kur dy vëllezër ndahen nga njëri-tjetri, është të mos qenit i kënaqur me paracaktimin e Allahut. Ai që bind veten që nga fillimi i vëllazërisë që shoqëria mund të përfundojë keq, nuk do të shfaq pikëllimin dhe dëshpërimin më shumë sesa duhet në rast ndarjeje.

## 24. I MENÇURI DHE VIZITA E VËLLAIT.

01 - I Dërguari i Allahut salallahu alejhi ue selem ka thënë:

أَزُورُ : قَالَ ؟ تُرِيدُ أَيْنَ : لَهُ قَالَ الْمَلِكُ أَتَى فَلَمَّا ، مَلَكًا مُدْرَجَتَهُ عَلَى تَعَالَى اللَّهُ فَأَرْصَدَ أُخْرَى قَرْيَةٍ فِي لَهَا أَخَا زَارَ رَجُلًا إِنَّ  
إِنَّ ، إِنَّكَ اللَّهُ رَسُولٌ فَأْتِي : قَالَ . اللَّهُ فِي أَحَبِّتُهُ أَنِّي إِلَّا ، لَا : قَالَ ؟ نِعْمَةٌ مِنْ عِنْدِكَ لَهُ هَلْ : قَالَ . الْقَرْيَةَ هَذِهِ فِي لِي أَخَا  
أَحَبِّتُهُ كَمَا أَحَبَّكَ وَجَلَّ عَرَّ اللَّهُ

“Një herë prej herësh, një njeri vizitoi vëllanë e tij nga një vend tjetër. Allahu Te’ala dërgoi një engjëll i cili e priste në rrugë kur ai të kaloj. Kur arriti njeriu (tek vendi në të cilin qëndronte engjëlli), engjëlli e pyeti: “Nga po shkon?” Ai iu përgjigj: “Po shkoj ta vizitoj një vëlla timin i cili jeton në filan vendin.” Engjëlli i tha atij: “A përfiton prej tij?” Ai ia ktheu: “Jo, por unë po e vizitoj atë sepse e dua atë për hir të Allahut.” Engjëlli i tha atij: “Unë jam i dërguar i Allahut tek ti, dhe të përgëzoj që Allahu ‘Azze ue Xhel të do ty ashtu siç ti e do atë (vëllanë tënd).”

02 - Njeriu i mençur e ka për detyrë që t’i vizitojë vëllezërit dhe të kujdeset për hallet e tyre. Kur besimtari viziton dikë, nga kjo vizitë përfitohen dy gjëra: Shpërblimi në ahiret dhe arritja e kënaqësisë së shoqërimit me atë që e viziton.

03 - Abdullah bin Raxha el-Gadani ka thënë: “Utbeh el-Gulam e kishte zakon të qëndronte në varreza dhe në shkretëtirë, kurse natën e kalonte në vendbanime për të kaluar natën në to. Kur vinte dita e xhumasë, ai shkonte në Basra, falte namazin e Xhumasë dhe takonte vëllezërit e tij.”

04 - El-Firjabi ka thënë: “Uaki bin el-Xherrah erdhi tek unë, kur ishte nisur nga Jerusalemi për në Umre, ndër tjerash më tha: “O Ebu Muhamed! Nuk isha nisur për tek ti, por desha të të vizitoj dhe të qëndroj për pak tek ti.” Ai qëndroi tek unë një natë. Në mënyrë të ngjashme erdhi Abdullah bin Mubarak, i cili erdhi tek unë dhe që kishte veshur ihramin nga Jerusalemi, kur ai ishte në rrugën e tij për në Umre. Ai qëndroi tek unë për tre ditë. Ndër tjerash, unë i thashë atij: “O Eba Abdarr-Rahman, qëndro tek për dhjetë ditë.” Ai tha: “Jo, sepse vizita zgjat për tri ditë.”

05 - Vizita e njerëzve përbëhet nga dy lloje:

- Vizitoni mes dy njerëzve lidhja në mes të cilëve është shumë e mirë, nuk kanë



*ndonjë problem mes tyre dhe çdo gjë mes tyre u shkon mirë. Në rastin e tillë, mendoj se është mirë që ata të dy të vizitohen sa më shpesh me njëri-tjetrin. Vizitat e tilla nuk janë të mërzitshme, përkundrazi dashuria vetëm sa shtohet.*

*- Që dashuria në mes atyre nuk është aq e mirë dhe ata i druhen njëri-tjetrit. Në qoftë se gjendja është kështu, unë mendoj se ata duhet më pak ta vizitojnë njëri-tjetrin. Dhe dije se vizitat e tilla janë paksa të mërzitshme.*

06 - Hasen bin Salih ka thënë: “Dashuria e singertë nuk shtohet në ndonjë formë, përveçse nëpërmjet takimeve të shpeshta.”

07 - Nëse lidhja vëllazërore ndërmjet vëllezërve janë të mira, nuk ka rëndësi në qoftë se nuk takohen shpesh sepse lidhja është e nivelit të lartë që të ruhet edhe me takime më të rralla. Dashuria që dëmtohet nga takimet e pakta është e rreme. Ata të cilët nuk kanë dashuri të singertë ndërmjet vete nuk duhet të vizitohen shpesh, ngase ata mund të bëhen të bezdisshëm dhe të mërzitshëm për njëri-tjetrin.

08 - Ibn Abbasi radijallahu anhu ka thënë: “Njeriu më fisnik tek unë është shoku i cili i kalon të gjithë për tu ulur pranë meje.”

09 - Katade, në lidhje me fjalët e Allahut Te’ala:

الصَّالِحَاتِ وَعَمَلُوا آمَنُوا الَّذِينَ وَيَسْتَجِيبُ

*“Ai u përgjigjet lutjeve të atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira...” 42:26*

Ka thënë: “ky ajet e ka për qëllim atë se, ata ndërmjetësojnë për vëllezërit e tyre.

فَضْلِهِ مِّنْ وَيَزِيدُهُمْ

*“...e u jep edhe më tepër prej dhuntisë së Vet.” 42:26*

Do të thotë se, ata ndërmjetësojnë për vëllezërit e vëllezërve të tyre.”

10 - ‘Amir bin Kajs ka thënë: “**Më mungon Basra për katër arsye:** thirrjet e myezinëve, etja gjatë ditëve, vëllezërit e mi atje dhe se ajo është vendlindja ime.”

## **25. I MENÇURI DHE AHMAKU. (01)**

01 - Profeti salallahu alejhi ue selem thënë:

مثل الـ سوء الـ جدليس ومثل ريح من أصابك عطره من يـ عطك لم إن ، الـ عطار مثل الـ صالح الـ جدليس مثل دخانه من أصابك ثوبك يـ حرق لم إن الـ قين

“Shembulli i shokut të mirë është sikurse shembulli i shitësit të parfumit, nëse nuk të jep asnjë parfum së paku do të ndjesh erën e mirë. Dhe shembulli i shokut të keq është sikurse shembulli farkëtarit, nëse nuk të djeg rrobat së paku do të ndjesh tymin **(që vije nga zjarri që ai e përdor).**”

02 - I mençuri është i detyruar që të mos shoqërohet me ahmakun dhe të marrin. Por është i detyruar të shoqërohet me të mençurin dhe të shkathëtin. Nëse nuk përfiton mençurinë e tij së paku përfiton nga dija që ai ka. Ndërsa shoqërimi me ahmakun, - edhe nëse nuk merr budallallëkun e tij të paktën do të ndotesh nga shoqërimi me të.

03 - Jasir bin ‘Amr **(një prej tabiinëve (v.p.))** ka thënë: **“Bojkotoje ahmakun. Gjëja më e mirë që mund t’ia bësh atij është bojkotimi!”**

4 - Kur nuk e njeh se cili është ahmaku, dije se shenjat e tij janë: kundërpërgjigja shpejtë në shenjë hakmarrjeje, nuk sigurohet në atë që e thotë **(flet atë që e dëgjon edhe pa e ditur se a është e vërtetë, e përhap dhe e beson atë (v.p.))**, të qeshurit e tepërt, është kontradiktor, shpif ndaj njerëzve të mirë dhe shoqërohet me njerëzit e këqij.

05 - Ahmakut, nëse ia kthen shpinën, dëshpërohet. Nëse shoqërohesh me të, iu duket vetja e tij se është dikush me vlerë. Nëse je i butë me të, është i pasjellshëm ndaj teje. Nëse ti je i pasjellshëm ndaj tij, ai është i butë ndaj teje. Nëse ti sillesh mirë ndaj tij, ai sillet keq ndaj teje. Nëse ti sillesh keq ndaj tij, ai sillet mirë ndaj teje. Nëse ti je i pa drejtë ndaj tij, ai është i drejtë ndaj teje. Nëse ti je i drejtë ndaj tij, ai është i pa drejtë ndaj teje.

06 - Se’id bin Ebi Ejub ka thënë: **“Mos u shoqëro me të keqin, ngase ai është sikurse të jetë pjesë e zjarrit. Dashuria e tij nuk është e drejtë dhe ai nuk i përmbahet premtimit të tij.”**

07 - Errësira me e madhe për njeriun është marrëzia **(ahmakllaku)**, ndërsa mendjemprehtësia është reflektim i mençurisë. Nëse njeriu sprovohet me të pasurit nevojë të shoqërohet me ahmakun, ai e ka për obligim që t’i përmbahet karakterit të vet dhe t’i shmanget karakterit të këtij shoqëruesi. Në të njëjtën kohë, ai duhet ta

falënderoj Allahun sa më shumë për atë që e ka bërë të kuptoj diçka që të tjerët nuk e kanë arritur.

08 - El-A'mesh ka thënë: **“Heshtja është përgjigja më e përshtatshme ndaj ahmakut.”**

09 - I mençuri është sprovuar me të shoqëruarit me dikë që ka cilësi të tilla, nganjëherë ai duhet të shtiret kinse nuk ka ndodhur ndonjë gjë. Butësia ndonjëherë është nënshtrim, e ndonjëherë kjo është shtylla e mençurisë.

10 - Sufjan eth-Theuri ka thënë: **“Njeriu është krijuar vetëm si ahmak. Përndryshe, nuk do kishte pasur vlerë jeta e tij!”**

## **26. I MENÇURI DHE AHMAKU. (02)**

01 - Disa nga cilësitë e ahmakut janë nxitimi, moskujdesi, mosveprimi, mëkatet, injoranca, urrejtja, ligësia, lavdërimi i vetvetes, kundërshtimet e tepërta, zilia, padrejtësia, mashtrimi, neglizhenca, harresa, mashtrimi, veprimet e turpshme, arroganca, armiqësia dhe përbuzja.

02 - Një nga shenja më e mëdha e ahmakut është gjuha e tij. Zemra e tij është në majën e gjuhës, ajo që i vije në mendje, menjëherë e shpreh gjuha e tij.

03 - I mençuri duhet t'i shmanget personit që ka këto cilësi dhe e ka për obligim që të braktis shoqërimin me të. Ata që kanë cilësi të tilla, shpeshherë ndodh t'i vërsulen atyre që shoqërohen me ta **(kacafyten me ta padrejtësisht)**.

04 - Uehb bin Munebih ka thënë: **“Ahmaku është sikurse petku i shqyer nga të gjitha anët. Nëse e arnon njërën anë, ana tjetër shqyhet. Ai është sikurse gota balte e thyer. As nuk mund të riparohet e as të rikthehet në baltë.”**

05 - Nëse shoqërohesh me ahmakun, gjithnjë do të vuash prej tij. Kur t'i shmangesh do të të përgojë. Nëse ai të jep ndonjë gjë apo të kryen ndonjë shërbim, do ta kujtoj atë gjë. Nëse ti i jep atij apo i kryen ndonjë shërbim, ai është jo-falënderues. Nëse ta tregon ndonjë sekret, dyshon në ty, e nëse ti i tregon një sekret atij, ai të

mashton (**e përhapë atë**). Nëse ai është mbi ty të nënvlerëson, e nëse ai është nën ty atëherë të fyen.

06 - Ahmaku beson se ai është krijesa më e mençur dhe se të gjithë të tjerët janë të marrë deri në një masë! Ahmaku urrehet nga njerëzit dhe do mbetet i pa njohur në botë (**për mirësinë e pretenduar të tij (v.p.)**). Veprimet e tij nuk janë të mira. Ai nuk është i lavdëruar tek Allahu dhe as tek njerëzit e mirë. Ndërsa i mençuri, është i dashur tek njerëzit dhe zotëria në mesin e tyre. Allahu është i kënaqur me veprimet e tij në jetën tjetër dhe njerëzit e mirë janë të kënaqur me veprimet e tij në jetën e kësaj bote.

07 - Hasan el-Basriu ka thënë: **“Më e dashur për mua është që një i mençur të ma kthej shpinën, sesa të më dojë një ahmak.”**

08 - Njeriu i mençur e ka për detyrë të mos shoqërohet me dikë që nuk përfiton prej tij.

09 - Prej tipareve të mençurit janë dhembshuria, heshtja, qetësia, sinqeriteti, sakrificia, urtësia, dija, devotshmëria, drejtësia, forca, vendosmëria, shkathtësia, butësia, toleranca, ulja e shikimit, dëlirësia dhe trajtimi i mirë i të tjerëve.

Nëse i jepet mundësia njeriut që të shoqërohet me ndonjë të mençur, ai duhet të mos i ndahet atij për asnjë çast dhe për asnjë arsye.

10 - Malik bin Dirhem ka thënë: **“Një herë prej herësh, përderisa isha në udhëtim e sipër, kalova pran një manastiri në të cilin pash një murg, më përshëndeti dhe, edhe unë e përshëndeta. Ndër tjerash më tha: “Të këshilloj që të kesh kujdes nga shoqëria e cila nuk ke dobi. Mos u ul afër dhe as larg saj.”**

## **27. I MENÇURI DHE SPIUNIMI (GJURMIMI I GABIMEVE TË NJERËZVE.)**

01 - Profeti salallahu alejhi ue selem ka thënë:

الله عباد وكونوا تباغضوا، ولا تحسدوا، ولا تدرسوا، ولا تحديث، أكذب الظن فإن والظن، إي اكم  
إخوانا

“Largohuni nga paragjykimi (dhe hamendësimi), sepse paragjykimi është thënia më e gënjeshtërt. Mos spiunoni, mos gjurmoni dhe mos urreni njëri-tjetrin, por jini robër të Allahut dhe vëllezër.”

02 - Hasan el-Basriu ka thënë: **“Mos pyet për veprat e mira dhe të këqija të vëllait tënd, ngase kjo është spiunim.”**

03 - I mençuri e ka për detyrë që të ketë zemër të pastër duke mos gjurmuar për gabimet e njerëzve, por në vend kësaj duhet të preokupohet me gabimet dhe mangësitë e tij.

Ai që merret me mangësitë e tij dhe jo me ato të tjerëve, do ta pushoj trupin dhe nuk do të lodhë zemrën. Sa herë që ai i kupton gabimet e veta, i konsideron ato më të lehta gabimet sesa gabimet e njëjta të vëllait të tij. Mirëpo, nëse njeriu merret me gabimet e të tjerëve në vend të gabimeve të tij, do t'i verbohet zemra dhe do t'i lodhet trupi; gjë e cila ia pamundëson atij largimin e gabimeve të veta.

04 - Esh-Shejbani ka thënë: **“Në shkrimet e mëparshme thuhet: ‘Atë që mbjell do ta korrësh’.”**

05 - Kërkimi i mangësive të të tjerëve është prej llojeve të hipokrizisë, kurse mendimi i mirë për tjetrin është pjesë e besimit. I mençuri mendon më të mirën për të tjerët, ndërsa telashet dhe pikëllimet i mban për veten e vet. Injoranti ka mendim të keq për njerëzit dhe nuk mendon fare për telashet dhe mëkatet e veta.

06 - **Mendimi i keq mund ndahet në dy lloje:**

a) - I ndaluar. **Atëherë kur njeriu ka mendim të keq për myslimanët në përgjithësi.**

b) - I rekomanduar. **Atëherë kur njeriu ka mendim të keq në lidhje me atë që, -për shembull, ka një grindje në çështjet fetare apo të kësaj bote, gjë e cila të bën që të kesh frikë prej tij. Në këtë rast është e rekomandueshme për të pasur mendim të keq për të që të ruhesh prej kurthave të tij.**

07 - Abdullah bin ‘Amr bin ‘As radijallahu anhumu ka thënë: **“Në Teurat thuhet: ‘Ai që bën tregti ka shumë mundësi që të bëhet njeri i prishur. Ndërsa ai që ia bën gropën shokut të tij, do të bie vetë në të’.”**

08 - I mençuri e ka për detyrë që të mos ketë moralin dhe veprat e njerëzve të thjeshtë, prandaj nuk duhet të gjurmoj gabimet e njerëzve. Ai që gjurmon gabimet e

të tjerëve, në realitet i përhap gabimet e veta. Ka mundësi që, gjurmimi për gabimet e të tjerëve është shkak që gabimet e tij të përhapen.

Prandaj, si ka mundësi që myslimani të kritikoj vëllanë e tij për gabime të cilat edhe vetë bie në to?!

## **28. I MENÇURI DHE DHËNIA PAS KËSAJ BOTE.**

01 - Allahu Azze ue Xhel ka bërë njeriun të jepet pas kësaj bote kalimtare aq sa të mos shkatërrohet ajo. Ngase, kjo botë është shtëpia e të devotshmëve, vendi ku të nënshtruarit ndaj Tij punojnë për të fituar shpërblime dhe vend ku njeriu e mbush bagazhin me vepra të mira. Sikur të kishin hequr dorë nga kjo botë, atëherë ajo do të shkatërrohej. Gjë e cila do të shkaktonte që njerëzit të mos kenë mundësi që ti kryejnë obligimet e Allahut, e lëre më kur jemi tek veprimet vullnetare që i bëjnë robit dobi në ahiret.

02 - Është e qortueshme që njeriu ta lë anash dynjanë.

03 - Ibnul-Mubarak ka thënë: **“Bujaria e mos preokupimit me atë se çfarë kanë të tjerët, është më me vlerë sesa bujaria në dorëlibëri ndaj të tjerëve. Dinjiteti i të genit i kënaqur me atë që ke është më me vlerë sesa dorëlibëria ndaj të tjerëve.”**

04 - Ibn Sirini ka thënë: **“Nëse gjërat nuk janë ashtu si dëshiron ti, atëherë duaji ashtu siç janë.”**

05 - Njeriu më i pasur është ai që nuk është rob i kësaj bote. Kurse, njeriu më i varfër është ai që udhëhiqet nga robëria pas kësaj jete. Dhënia pas kësaj bote është arsye pse gjërat zhvendosen nga vendi i tyre. Dhënia pas kësaj bote është e ndaluar **(ngase ajo e vdes zemrën e njeriut)**, ashtu siç frika shkakton vdekjen. Nëse dëmi i vetëm i dhënies pas kësaj bote do të ishte llogaridhënia e gjatë para Allahut për atë që ka fituar, do të ishte e mjaftueshme që besimtari të mos jepej pas kësaj bote.

06 - Dhënia pas kësaj bote nuk do ta shtojë rrizkun. Po që se vepron kështu, më së paku që mund të dënohet është se, nuk do ta shijoj atë që e ka deri më tash. Kështu që, njeriu lodhet për të arritur diçka që ai nuk është i sigurt nëse do ta arrij atë apo do të vdes. Nëse i dhëni pas kësaj bote nuk do të ishte i tillë, por më shumë do

mbështetej në Krijuesin e qiejve, do të furnizohej me atë që në realitet as që e ka pritur.

07 - Dhënia pas kësaj bote është shenjë e varfërisë, ndërsa koprracia petku i varfërisë. Koprracia është ushqim i të dhënit pas kësaj jete, ashtu siç fanatizmi e ushqen injorancën. Mosbamiçësia është vëllai i të dhënit pas kësaj bote, ndërsa mendjemadhësia është vëllai binjak i budallallëkut.

08 - Transmeton Abdirr-Rrahman el-'Utbi se babai i tij ka thënë: **“Benu israilët u grinden në lidhje me kaderin 500 vjet. Pastaj ata shkuan tek njëri prej dijetarëve të tyre në mënyrë që ai të gjykonte mes tyre. Ata thanë: “Na trego për kaderin? Por bëjë këtë shkurtimisht dhe qartë, në mënyrë që njerëzit e thjeshtë ta kenë më të lehtë që të kuptojnë.” Ai tha: “Kjo është humbje për të mençurit dhe fitore për injorantët”.**”

09 - Ai që i nënshtrohet dhënies pas kësaj bote nuk do të ketë paqe dhe rahat i asnjëherë. Ngase gjëja e tillë në vazhdimësi i sjell njeriut probleme.

10 - I mençuri e ka për detyrë që të mos jepet shumë pas kësaj jete në mënyrë që të mos fajësohet në dynja dhe ahiret. Por qëllimi i tij duhet të jetë që t'i përmbush obligimet e Allahut. Atij që i mungon synimi i shëndoshë do ta dëmtoj veten dhe do ta lodhë trupin. Ai i cili jepet pas kësaj dynjaje në këtë mënyrë **(pra, me qëllime të pastra dhe duke iu bindur caktimeve të Allahut ashtu siç duhet (v.p.))** ka qëllime të pastra dhe të lavdërueshme.

## 29. I MENÇURI DHE XHELOZIA.

01 - Profeti salallahu alejhi ue selem ka thënë:

إخوانا الله عباد وكونوا تدابروا ولا تحاسدوا ولا تبغضوا لا

**“Mos e urreni njëri-tjetrin, mos keni zili njëri-tjetrin dhe mos ia ktheni shpinën njëri-tjetrit, por bëhuni robër të Allahut, vëllezër të vërtetë.”**

02 - I mençuri është i obliguar që gjithnjë të qëndrojnë larg të gjitha llojeve të xhelozisë. Shenja më e vogël e xhelozisë është që njeriu të mos jetë kënaqur me

caktimin e Allahut, ai dëshiron të kundërtën e asaj që Allahu ka vendosur për të dhe pastaj dëshirën që tjetri të humb dhuntinë e Tij.

03 - Shpirti dhe mendja e ziliqarit nuk rehatohen derisa ta sheh vëllanë e tij t'i ketë humbur dhuntitë që Allahu ia ka dhënë.

04 - Umer bin Hatabi radijallahu anhu ka thënë: **“Nuk ka asnjë njeri të cilin Allahu e ka veçuar me ndonjë dhunti shtesë ndaj të tjerëve, veçse ka edhe një njeri që ia ka zili për atë.”**

05 - Muhamed bin Sirin ka thënë: **“Kurrë nuk kam pasur dikë zili për diçka të kësaj bote. Si mund ta kem atë zili (për ndonjë gjë të kësaj bote) kur ai është rrugës për në Xhenet (është i devotshëm (v.p.))?! Apo, si ta kem mëkatarin zili për diçka, kur ai është rrugës për në Zjarr të Xhehenemit?!”**

06 - Xhelozia është cilësi e të mallkuarve, ndërsa mungesa e saj është cilësi e njerëzve të ndershëm. Çdo gjë që digjet mund të shuhet, me përjashtim të zjarrit të zilisë i cili nuk shuhet.

07 - Nga xhelozia lind urrejtja, ndërsa urrejtja është thelbi i së keqes. Kush mbjell të keqën në zemrën e tij, padyshim se nga ajo do të mbijë një bimë e hidhur. Trungu i saj është urrejtja, kurse fryti i saj është pendimi.

08 - Xhelozia do të thotë që të dëshirosh që vëllai yt ta humbet dhuntinë që i është dhënë për ta zotëruar vetë atë. Kurse ai i cili dëshiron që edhe ai ta ketë të njëjtën dhunti sikurse të vëllait të vet pa e humbur atë vëllai i tij, kjo nuk është xhelozia e keqe nga e cila jemi ndaluar.

09 - Ndoshta nuk do të ekzistonte aspak xhelozia, por ja që Allahu i ka veçuar disa njerëz me dhunti shumë më specifike se disa të tjerë. Aq më më të mëdha dhe të shumta të jenë dhuntitë e Allahut ndaj njeriut, edhe më shumë do të shtoheshin xhelozët ndaj tij.

10 - Muhamed bin Sirin ka thënë: **“Kurrë nuk kam pasur zili dikë, qoftë në çështje të fesë apo të dynjasë.”**

11 - Nuk ka shpëtim më të mirë nga ai që të xhelozon, sesa të qëndrosh larg tij. Përderisa ai i sheh dhuntitë tuaja që t'i ka dhënë ty Allahu, në vazhdimësi do të ndjehet i parehatshëm në lidhje me këtë, do të ketë mendim të keq për Allahun dhe zilia e tij ndaj teje vetëm se do të shtohet edhe më shumë.



12 - I mençuri duhet të sigurohet që ta largoj xhelozinë për njerëzit sa më shpejt që mundet. Ilaçi më i mirë kundër shërimit nga kjo sëmundje, është qëndrimi larg atij që ti po e xhelozon. Nuk të xhelozon askush për shkak të ndonjë të mete që ti ke apo për shkak të të këqijave që ti i posedon, por xhelozia vije si rezultat që njeriu nuk është i kënaqur me caktimin e Allahut për të.

13 - Hammad bin Humejd i tha Hasan el-Basriut: **“O Ebu Se’id, a mund të ketë zili dikë besimtari?”** Ai u përgjigj: **“Sa shpejt harrove bijtë e Ja’kubit alejhis-selam kur ata kishin zili Jusufin alejhis-selam! Por fshihe xhelozinë në gjoksin tënd. Ajo nuk do të dëmtojë përderisa nuk flet apo vepron diçka si rezultat i saj.”**

14 - Po t’i vije në mend të mençurit që ta ketë zili vëllanë e tij, ai lufton për ta fshehur atë që ka dhe nuk e shfaq atë që ka brenda.

15 - Zakonisht xhelozia gjendet në mesin e atyre që janë të barabartë ose përafërsisht të njëjtë. Nuk ka njeri i cili arrin diçka në këtë jetë, veçse ekziston dikush që e urren atë apo e ka zili për këtë që ka arritur.

16 - Njeriu xheloz është armik i pazbërthyesëm. I mençuri nuk duhet të lejojë xhelozin që të gjykojë në qoftë se ndodhë diçka. Ngase, nëse ai gjykon, do të gjykojë vetëm në dëm të rivalit të tij. Nëse i kërkohet të ndaj drejtësinë, atë do ta ndaj në dëm të atij që e xhelozon. Nëse do të privojë dikë nga diçka, e privon vetëm rivalin e tij apo në dëm të tij **(që e xhelozon)**. E gjithë kjo, me të vetmen arsye sepse rivali i tij ka diçka për të cilën ai e ka zili. Andaj, njeriu duhet të ketë kujdes nga njerëzit që kanë cilësi të tilla. Ata mund të jenë shumë të afërt me të, kolegë, fqinjë e kushërinj.

17 - El-‘Abbas bin Bekkar ka thënë: **“Një njeri i tha Shubejb bin Shebbas: Me të vërtetë unë të dua ty.”** Shubejbi i tha atij: **“E di këtë.”** Ai i tha: **“Si e di ti këtë?”** Ai u përgjigj: **“Sepse ti nuk je fqinji im e as kushëri im.”**

18 - Sa shenjë e keqe që është xhelozia! Ajo e shpie njeriun në pikëllim e mjerim. Ajo është sëmundje që nuk ka shërim.

19 - Kur e sheh xhelozin dhuntinë që i është dhënë vëllait të tij, shtanget. Kur e sheh vëllanë e tij të bëjë ndonjë gabim, gëzohet. Fytyra e tij dëshmon qartë atë që ka në zemrën e tij. Nuk kam parë ndonjë njeri që është xheloz në dikë, të sillt mirë me njerëzit.

20 - Xhelozia thërret në mjerim. Kujtoje ngjarjen e Ademit alejhis-selam me Iblisin, **kur ky i fundit e pati zili atë, dhe zilia që ai pati i sollti atij mjerimin e**

*përjetshëm. Zilia ishte shkaku që ai u mallkua pasi që i ishte dhënë pozitë e lartë.*

## **30. I MENÇURI DHE ZEMËRIMI.**

01 - Transmeton Xhabir bin Abdilah radijallahu anhu se, një njeri erdhi tek Profeti salallahu alejhi ue selem dhe tha: “O i Dërguari i Allahut, më mëso diçka me të cilën do të hyjë në Xhenet, por mos flis shumë gjatë në mënyrë që unë ta mbaj në mend.” Ai salallahu alejhi ue selem i tha:

تَغْضِبْ لَا

“Mos u zemëro.”

02 - Njerëzit më të mençur dhe më të përgatiturit në përgjigjet e tyre janë ata që nuk zemërohen.

03 - Zemërimi i shpejtë është më i dëmshëm për të mençurin sesa zjarri për barin e thatë. Ngase, ai që zemërohet mençuria i largohet dhe thotë e vepron gjëra i ndikuar nga epshi.

04 - Vuhejb ka thënë: “Në Inxhil shkruan: **“O biri i Ademit, më kujto Mua kur ti zemërohesh dhe Unë do të të kujtoj ty kur zemërohem Unë.”**

05 - Zemërimi i shpejt është prej cilësive të budallenjve. Ndërsa mungesa e tij është prej cilësive të të mençurve.

06 - Zemërimi të bën që ti të veprosh vepra që nesër do të ndjesh keqardhje. Korrigjimi i gjërave është më i lehtë para zemërimit sesa pas.

07 - Bekkar bin Muhamed ka thënë: **“Ibn ‘Aun nuk e kishte zakon të zemërohej. Nëse dikush e zemëronte atë, ai i thoshte atij: ‘Allahu të bekoftë!’”**

08 - Ebu Se’id ka thënë: “Kur ‘Aun bin Abdilah bin ‘Utbeh zemërohej në ndonjë prej robërve të tij, e kishte zakon t’i thoshte: **“Ti i përngjan shumë pronarit tënd (d.m.th. ‘Aunit)! Ti më kundërshton mua, dhe unë e kundërshtoj Allahun.”** E nëse

ndodhte që ta zemëronte edhe më shumë, thoshte: **“Ti je i lirë për hir të Allahut” (d.m.th. nuk je më robi im).”**

09 - Atëherë kur i mençuri sheh diçka që ai e urren, është i detyruar të mendoj se sa shpesh bën mëkate ndaj Zotit ndërsa Ai është i Butë me të! Atëherë zemërimi i tij do të kaloj dhe nuk do të bëj ndonjë veprim që nuk e bëjnë njerëzit e mençur. Përveç kësaj, do të ketë edhe shpërblim tek Allahu si rezultat i braktisjes së kësaj cilësie.

10 - Nëse dëmi i vetëm i zemërimit do të ishte se, njerëzit e mençur të zemëruarit nuk ia marrin fjalën, do të ishte e mjaftueshme për të që t’i shmanget zemërimit në çdo mënyrë të mundshme.

11 - Asnjë dijetarë nuk justifikon atë që lëshon gruan e vet ose atë që liron robin e Tij kur është i zemëruar. Kurse, në të njëjtën kohë, këta dijetarë e justifikojnë atë që ndahet nga gruaja e tij ose liron robin e tij si rezultati i gjendjes së dehur.

12 - Krijimtaria e njeriut është e përbërë nga zemërimi dhe butësia në të njëjtën kohë. Kushdo që zemërohet dhe bëhet i butë në të njëjtën vepër, nuk ka bërë asgjë të keqe përderisa zemërimi nuk e shtynë atë që të bëjë apo të thotë diçka të urryer. Megjithatë, është më e lavdërueshme të shmangurit zemërimin në çfarëdo gjendje.

13 - Abdul-Melik bin Mervani ka thënë: **“Ai i cili nuk zemërohet nuk mund të jetë i butë sepse i butësia e njeriut vërehet vetëm atëherë kur ai zemërohet.”**

## **31. I MENÇURI DHE LAKMIA.**

01 - Sehl bin Sa’di radijallahu anhu ka thënë: “Një njeri erdhi tek Profeti salallahu alejhi ue selem dhe i tha: **“O i Dërguari i Allahut! Ma mëso një vepër e cila e bën Allahun dhe njerëzit të më duan mua nëse unë e bëj atë.”** Ai u përgjigj:

الناس يحبك اناس ابيدي في في يما وأزهد الله ، يحبك الدنيا يا في أزهد

**“Hiq dorë nga gjërat e kësaj bote (dhe kontrollo veten nga ajo që të tërheq) do të dojë Allahu. Hiq dorë nga ajo që është në dorë të njerëzve do të duan ata.”**

02 - I mençuri nuk lakmon në atë që posedojnë të tjerët dhe në atë që nuk mund të bëhet e tija në asnjë mënyrë; këtë gjë duhet ta anashkaloj plotësisht **(pra, të mos**

**mundohet ta bëj të tijën).** Të shpresosh atë që është e të tjerëve është varfëri e plotë, e çfarë mund të thuhet për atë që nuk ekzistonë fare **(që nuk mund të jetë e tij në asnjë mënyrë)?**

03 - Sa'd bin 'Ammarah radijallahu anhu ka thënë: **“Bir i dashur, mos u bëj shumë lakmitar duke shfaqur lakminë për diçka, sepse kjo mos-lakmia është një thesar i vërtetë. Kurse të këshilloj që të largohesh nga ajo që është në dorë të të tjerëve, sepse kjo është varfëria më e madhe.”**

04 - Përpjekja më fisnike që e bën njeriu për diçka në jetën e tij, është që të mos lakmoj atë që e kanë të tjerët. Ai që lakmon kurrë nuk do të fitoj pasuri dhe kjo të sjell nderin më të madh. Përgëzoje atë të cilin ka njëmend zemër të devotshme dhe që nuk i janë verbuar sytë nga lakmia për atë që e kanë të tjerët!

05 - Kushdo që dëshiron të jetë i lirë e të mos jetë i robëruar, nuk duhet të lakmojë për atë që nuk e ka. Ngase lakmia është varfëri dhe e kundërta e saj është pasuria e vërtetë. Ai që lakmon do të poshtërohet dhe nënçmohet, ndërsa ai që është i kënaqur me atë që ka do të jetë i ndershëm dhe i pavarur.

06 - Tregohet se Ahmed bin Hanbel e ka dëgjuar Ibnus-Simakun duke thënë: **“Lakmia është litar për zemrën tuaj dhe zinxhirë me të cilën të janë lidhur këmbët. Andaj, largoje lakminë nga zemra në mënyrë që të zgjidhet zinxhiri përreth këmbëve.”**

07 - I mençuri nuk lakmon në atë çfarë kanë miqtë e tij, ngase për të kjo është poshtërim dhe në të njëjtën kohë, bëhet i shkujdesur ndaj hapave real që i ndërmerr armiku i vërtetë. Vetëm kështu njeriu e shpëton veten e vet.

08 - Mos-lakmia mbjell paqe dhe nder, kurse përmallimi dhe lakmia mbjellin lodhje dhe poshtërim. Sa e sa njerëz kanë lakmuar, por janë lodhur dhe janë poshtëruar pa arritur qëllimet e tyre? Sa e sa njerëz nuk lakmuan, por që në anën tjetër jetuan në paqe dhe me nder, pos kësaj iu është dhënë edhe më shumë nga ajo që dëshiruan?!

09 - Mu'aujeh bin 'Ammar transmeton se Ebu Xha'feri ka thënë: **“Të mos lakmosh në atë që kanë të tjerët është ndershmëria e vërtetë!”**

## **32. I MENÇURI DHE TË LYPURIT.**

01 - I mençuri e ka për detyrë që në çfarëdo gjendje t'i shmanget lypjes. Që njeriut t'i ikën mendja për të lypur, e bën atë ta nënvlerësoj veten dhe të humbas pozitën ndër njerëzit. Dhe e kundërta e kësaj, i jep atij krenari/nder dhe e ngrit pozitën e tij ndër të tjerët.

02 - Musa bin Tarif ka thënë: **“Kur unë kam nevojë për dikë, krenaria/nderi më largohet nga zemra ime. Ndërsa kur e largoj këtë nevojë nga agjenda ime (nuk merrem me të), më kthehet krenaria/nderi në zemrën time.”**

03 - Umer bin Hatabi radijallahu anhu ka thënë: **“Ai i cili lyp për tu bërë i pasur le ta dijë se kjo është një prej gurëve të ndezur në Xhehenem që do të futet në gojën e tij. Prandaj, ai që dëshiron të kërkoj pak, le të kërkojë sa më pak dhe ai që dëshiron të kërkoj shumë le të kërkoj sa më shumë.”**

04 - Hakim bin Kajs bin Asim tregon se babai i tij kur ishte në prag të vdekjes i këshilloi fëmijët e tij duke u thënë: **“Bijtë e mi të dashur! Keni kujdes nga lypja! Ngase lypja duhet të jetë furnizimi i fundit i njeriut.”**

05 - I mençuri nuk duhet të lypë që njerëzit ta kthejnë duarthatë dhe nuk duhet që të bëhet i tepërt kur të lyp që njerëzit të mos e privojnë **(edhe nga ajo që kanë pasur t'ia japin)**. I mençuri duhet të jetë i përmbajtur dhe fisnik e të mos kërkoj diçka që s'është për të dhe të mos e lë atë që i takon dhe e ka pranë. Dhe më mirë është që të humbasësh diçka sesa t'ua kërkosh atë njerëzve të gabuar. Ai që i kërkon diçka personit të gabuar e ul vetën dy herë më shumë dhe ngritë personin të cilit i ka kërkuar.

06 - Sufjan bin Ujejneh ka thënë: **“Ai që i kërkon diçka një personit të pa vlerë ai e ka ngritur atë.”**

07 - Mutarrif bin Abdil-lah bin esh-Shikhir i tha djalit të vëllait të tij: **“Nipi im i dashur! Nëse ke nevojë për ndonjë gjë prej meje, atëherë shkruaje atë në një copë letër. Me këtë unë dua ta ruaj fytyrën tënde nga poshtërimi/nënçmimi i lypjes.”**

08 - Fatkeqësia më e madhe është e keqja që vije më pas. Gjysma e matufërisë është që të lypësh prej njerëzve ose që të shkoj mendja që të lypësh prej tyre. Ai që ndjehet i ndershëm dhe krenar i nënvlerëson gjërat materiale të kësaj bote. Ndërsa nuk bëhet njeriu i ndershëm përderisa nuk qëndron larg nga ajo që të tjerët kanë dhe të ketë durim me atë që bëjnë ata. Që t'i lypësh vëllezërve tu diçka, kjo i lodhë ata. Kurse t'i lypësh të tjerëve është e pafrytshme.

09 - Ibn Mes'udi radijallahu anhu ka thënë: **“T’i kërkohet vëllait diçka është sprovë. Nëse i jep atij, ai lavdëron dikë tjetër dhe jo personin që i ka dhënë. Nëse ai nuk i jep atij, ai flet keq edhe për të tjerët që nuk ka kërkuar prej tyre.”**

10 - Nëse dëmi i vetëm i lypjes do të kishte qenë nënçmimi i vetvetes gjatë kryerjes së vet aktit apo edhe atëherë kur të shkon mendja që të lypësh, do të ishte më mirë që i mençuri të haj dhe e të përtyp bërthama e të mos lyp përderisa ia del disi.

Megjithatë, nëse njeriu detyrohet që të lyp, atëherë le të lyp prej dikujt për të cilin e di se do t’i japë ose t’i lyp atij që ka pushtet dhe i cili nuk e qet në pozitë të palakmueshme, ashtu siç është gjendja me atë të cilin jep pa kërkuar prej tij. Kush mbështetet në Allahun, Allahu do t’i mjaftoj atij. Dhe kush kërkon lavdinë tek Allahu, Ai nuk do ta bëj që të ndjehet asnjëherë i varfër. Kurse ai që kërkon lavdinë tek njerëzit, do të poshtërohet para tyre!

### **33. I MENÇURI DHE KËNAQËSIA.**

01 - Ibn Umeri ka thënë:

“I Dërguari i Allahut salAllahu alejhi ue selem më kapi për krahu dhe më tha: **“Bëhu në këtë jetë si të jesh një i huaj ose udhëtar.”**

***Nuk ka asnjë dyshim në lidhje me vërtetësin e hadithit.***

02 - Në këtë hadithë Profeti salAllahu alejhi ue selem e urdhëroi Ibn Umerin radijAllahu anhu që të jetë në këtë jetë si të ishte një i huaj ose udhëtar. Është sikurse ai e urdhëron atë që të jetë i knaqur me pak nga kjo jetë. Sepse, kur i huaji dhe udhëtari janë larg nga shtëpitë e tyre nuk kanë për qëllim që të arrijnë ndonjë pasuri të shumtë. Ata preferojnë që të jenë të knaqur më pak sesa të fitojnë shumë nga gjërat e kësaj bote.

03 - Aktham bin Sejfi Allahu e mëshiroftë ka thënë: **“Bir i dashur! Ai i cili nuk e ka humb shpresën për atë të humburën ai e lodhë trupin e tij. Ai që është i kënaqur me atë që ai ka është gjithmonë i lumtur. “**

04 - Ibn Mesudi radijAllahu anhu ka thënë: **“Katër gjëra tashmë janë të mbaruara dhe askush nuk mund të fitoj më shumë se sa tjetri; krijimi, morali, furnizimi dhe jetëgjatësia.”**

05 - Një nga dhuratat më të mëdha që Allahu mund ti jap robit të Tij është kënaqësia. Nuk ka asgjë që e pushon trupin me tepër se si të qenurit i kënaqur me kënaqësinë dhe të mbështeturit në rrizkun që ia ka caktuar Allahu. Nëse dobia e vetme e kënaqësisë do të ishte se ajo e pushon trupin dhe e mbron atë nga vendet e këqija për të arritur pak më shumë, do të kishte qenë e mjaftueshme për të urdhëruar të mençurin që gjithmonë të jetë i kënaqur pa marr parasysh gjendjen e tij.

06 - Muhamed bin el-Munkadir ka thënë: **“Kënaqësia është një pronë që kurrë nuk përfundon.”**

07 - I mençuri e di se atij që i mungon kënaqësia kurrë nuk do ta shtone atë me para. Është më mirë që të kesh pak të holla dhe pak shqetësime se shumë të holla dhe shumë shqetsime. I mençuri i hakmerret zellit të kënaqësisë në të njëjtën mënyrë siç i hakmerret armikut me hakmarrje. Se shkaku që e pengon furnizimin e të mençurit, është shkaku në furnizimin e injorantit.

08 - Ibn-ul-Mubarak Allahu e mëshiroftë ka thënë: **“Kënaqësia është një cilësi më e mirë se sa bujaria.”**

09 - Kënaqësia gjendet në zemër. Ai që ka një zemër të pasur edhe duart i ka të pasura. Ai që ka një zemër të varfër ska kurrëfarë dobie nga pasuria e tij. Ai që është i kënaqur nuk ndjen asnjëherë zemërimin. Ai jeton në paqe dhe rehati. I pa kënaquri kurrë nuk ndalet përmalluari pas të humburës. Është sikur se pasuria dhe varfëria luftojnë me njerëzit.

10 - el-Medini Allahu e mëshiroftë ka thënë: **“Durimi në formë të përmbajtjes dhe të kënaqësisë në lidhje me nevojat dhe varfërin është më e madhe se sa bujaria.”**

11 - Ai i cili e detyron veten që të jetë i kënaqur dhe pastaj i ka zili njerëzit për atë që ata kanë nuk është kështu për shkak të kënaqësisë dhe bujaris - ai është kështu për shkak të paaftësisë dhe dështimit.

12 - Muhamed bin Ka'b el-Kuradhi Rahimullah ka thënë në lidhje me fjalët e Allahut Te ala:

طَيِّبَةَ حَيَاةٍ فَلْنُحْيِيَنَّهٗ مُؤْمِنٌ وَهُوَ أَنْشَىٰ أَوْ ذَكَرٍ مِّنْ صَالِحًا عَمِلَ مِنْ

**“Kush bën vepër të mirë, qoftë mashkull ose femër, e duke qenë besimtar, Ne do t'i japim atij një jetë të mirë (në këtë botë), e (në botën tjetër) do t'u japim shpërblimin më të mirë për veprat e tyre.” 16:97**

*“Do të thotë kënaqësia.”*

## **34. NXITJA NË TË QENURIT I KËNAQUR NË VËSHIRËSI DHE DURIMI PREJ SAJ.**

Ibn Abbasi (radijAllahu anhu) ka thënë se i Dërguari i Allahut salAllahu alejhi ue selem ka thënë: “Gjëja e parë që Allahu e krijoi ishte lapsi, më pas Ai e urdhëroi atë dhe shkruajti gjithçka që do të ndodh deri në Ditën e Gjykimit.”

Ka thënë Ebu Hatim (Rahimullah): “Është e obliguar për të mençurin që të jetë i bindur se të gjitha gjërat e kanë caktimin e tyre. Ka prej atyre (gjërave) të cilat kanë ndodhur dhe është e pamundur që të mos ndodhin, sikurse ka gjëra të cilat nuk mund të ndodhin, gjëra të cilat njerëzit nuk kanë mundësi me i bërë të ndodhin.

Nëse njeriun në një moment e kap koha e vështirësisë, obligohet që të vishet me një rrobe e cila i ka dy cepe. Njëra prej tyre të jetë durimi dhe tjetra të jetë kënaqësia. Nëse e vepron këtë gjë (pajiset apo vesh këtë rrobë) do të përfitojë shpërblimin e plotë. Sa e sa vështirësi kanë qenë të vështira që të largohen dhe më pas janë larguar me lehtësi për një çast.”

Ebul Haxhxhaxh El-Ezdi (Rahimullah) ka thënë: “E kemi pyetur Selmanin (radijAllahu anhu) se çfarë është imani në kader?”

Ai u përgjigj: “Kur ta mësoi robi se ajo që e ka goditur nuk ka pas mundësi që të mos e godasë [dhe ajo që nuk e ka goditur nuk ka mundësi ta godas atë].”

Abdul Uahid Ibn Zejd (Rahimullah) ka thënë: “I kam thënë Hasen (El-Basriut); O babai i Seid-it: “Nga ka ardhur ky moral?”

Ai u përgjigj: “Nga mungesa e të qenurit i kënaqur me Allahun.”

Unë i thashë: “Nga vjen mungesa e të qenurit i kënaqur me Allahun?”

Ai u përgjigj: “Nga mungesa e njohjës së Allahut.”

Sufjan Ibn Ujejneh (Rahimullah) ka thënë: “Kam dëgjuar një burrë nga pasuesit e librit i cili e pranoi islami duke thënë: “Allahu i shpalli Daudit; O Daud! Duro në vështirësitë dhe do të vij prej Meje ndihma.”

Abdul Uahid Ibn Zejd (Rahimullah) ka thënë: “Unë nuk dua që ndonjë vepër t`i paraprij durimit përveçse kënaqësisë dhe unë nuk di ndonjë gradë me të çmuar



dhe më të lartë se kënaqësia. Kënaqësia është koka (maja më e lartë) e dashurisë (ndaj Allahut).”

Ka thënë Ebu Hatim (Rahimullah): “Durimi i bashkon të gjitha çështjet, (durimi) është rregulluesi i vendosshmërisë dhe shtyllë e mençurisë, (durimi) është mbjellës i mirësisë dhe zgjidhës (i problemeve etj) për ata që nuk kanë zgjidhje.”

Mejmun Ibn Mehran (Rahimullah) ka thënë: “Nuk e arrin diçka të mirë asnjë rob, qoftë i dërguar apo jo, vetëm se me durim.”

Ka thënë Ebu Hatim (Rahimullah): “Durimi (mund të) ndahet në tri pjesë; Durimi prej mëkateve, durimi në bindje dhe durimi në vështirësi dhe në fatkeqësi.

Më i miri prej tyre është durimi prej mëkateve. I mençuri i mediton gjendjet e tij duke u bërë i qendrueshëm në të tri gjendjet të cilat i përmendëm. Ai duhet të ketë durim në tri ndarjet që ne i cilësuam më parë, në mënyrë që të ngrihet me to në gradat e kënaqësisë me Allahun e Lartësuar gjatë gjendjes se tij të rëndë dhe të lehtë. Unë lus Allahun që të arrijmë në ato grada me ndihmën e Tij.

Transmeton Thabit El-Bunani nga Muadhetu gruaja e Siletu Ibn Ushejm (Rahimullah) se ka thënë: “Silah bin Ushejm ishte jashtë në betejë me djalin e tij. Ai i tha atij: “O biri im! Shko para dhe lufto derisa të vritesh në mënyrë që unë të pres shpërblim për durimin tim. Ai veproi kështu dhe luftoi derisa u vra. Pastaj pas tij babai i tij luftoi dhe u vra.”

“Kur i erdhi lajmi për vdekjen e burrit dhe djalit të saj, i erdhën gratë dhe ajo tha; Nëse keni ardhur (për të më uruar) me çfarë Allahu na ka nderuar (mirësevini), përndryshe kthehuni mbrapsht.”

## **35. NXITJA NË TË QENURIT TOLERANT NDAJ NJERËZVE.**

Ebu Hurejra (radijAllahu anhu) ka thënë:

“Një burrë erdhi dhe tha: “O i Dërguari i Allahut! Unë kam të afërm me të cilët i mbaj lidhjet ndersa ata i shkëpusin me mua, ata sillen keq me mua e unë sillem mirë me ta, ata më injorojnë mua ndërsa unë jam i butë me ta.” I Dërguari i Allahut (salAllahu alejhi ue selem) tha:

“Nëse çështja është sikurse po thua, kjo është e njëjtë sikur po i spërkat ata me

pluhur të ndezur. Me ty do të jetë një përcjellës prej Allahut përderisa do të vazhdosh në këtë gjendje.”

Ka thënë Ebu Hatim (Rahimullah): “Është i obliguar i mençuri që të jetë tolerues me të gjithë njerëzit në përgjithësi dhe të mos hakmerret ndaj tyre sepse nuk ka ndonjë shkak që e parandalon të keqen më mirë sesa mirësia dhe nuk ka ndonjë shkak që e rrit të keqen më shumë sesa përdorimi i njëjtë (kthimi i të keqes me të keqe) me të.”

Ejubi (Rahimullah) ka thënë: “Një burrë nuk mund të jetë fisnik derisa t`i ketë dy cilësi; të qenurit i përmbajtur ndaj asaj që kanë njerëzit dhe të jetë i tolerueshëm ndaj tyre.”

Umer Ibn Abdul Aziz (Rahimullah) ka thënë: “Çështjet më të dashura tek Allahu janë tri; Të falësh kur ke mundësi, të jeshë i mesëm kur ke pasuri dhe të jesh i butë në adhurim. Çdo kush i cili sillet butë ndaj dikujt në këtë dynja vetëmse do të sillet butë Allahu me të në ditën e kijametit.”

Ka thënë Ebu Hatim (Rahimullah): “Njeriu i mençur obligohet që të jetë falës ndaj të tjerëve të cilët e trajtojnë atë keq, duke shpresuar se Allahu i Lartësuar do t`ia falë gjynahet të cilat i ka bërë më parë, sepse njeriu që është falës ndaj të tjerëve ia obligon vetes faljen për shkak që të marrë shpërblime, ndërsa personi i cili dënon edhe nëse ai hakmerret (ndaj të tjerëve duke i dënuar), është më afër pendimit. Ndërsa ai i cili e ka një vëlla të cilin e done arsyeton atë gjatë gjithë jetës për gabimet e tij.

El-Fedajl Ibn Ijjad (Rahimullah) ka thënë: “Arsyetoje vëllain tënd deri në 70 gabime.”

Iu tha atij: “Si mund të bëhet kjo o babai i Aliut?!”

Ai u përgjigj: “Sespe vëllai të cilin e vëllazërove për hirë të Allahut, nuk mund të shtojë mbi 70 gabime.”

El-Fedajl Ibn Ijjad (Rahimullah) ka thënë: “Ai i cili kërkon një vëlla pa të meta, do të ngeli pa vëlla.”

Ka thënë Ebu Hatim (Rahimullah): “Njerëzit që janë më së shumti larg urrejtjes janë ata të cilët e rrisin (duke i falur të tjerët) shpërblimin. Ndërsa njerëzit me shkallën më të lartë, janë ata të cilët e mbulojnë injorancën me urtësi. Mirësia është vetëm për atë i cili sillet mirë me atë që i është sjellur keq, ndërsa shpërblimi i të mirës me të mirë është vetëm një karakter i barabartë, të cilën mund ta kenë vepruar edhe kafshët ndonjëherë.

Nëse në falje (ndaj të tjerëve) dhe në mos hakmarrje të mos kishte cilësi falënderuese përveçse rehatimit të shpirtit dhe lumturisë së zemrës, kjo do të

mjaftonte që të ishte e obliguar mbi njeriun e mençur që të mos e humb kohën e tij duke u sjellur me moralin e kafshëve. Kush i përgjigjet të keqes me të keqe, ai është i keqi, edhe pse nuk është ai që e ka nisur i pari.

Lukmani (salAllahu alejhi ue selem) i tha të birit:

“Ka gënjyer ai i cili ka thënë se sherri (e keqia) e shuan sherrin (të keqen). Nëse ai është i sinqertë në këtë, atëherë le të ndezi një zjarr afër një zjarri tjetër dhe të shikoi a e shuajnë ata njëri tjetrin? Vetëm mirësia e shuan sherrin (të keqen) ashtu sikurse e shuan uji zjarrin.”

## **36. PËRMENDJA E CILËSIVE TË TË MENÇURIT DHE TË KEQIT.**

Ebu Hurejra (radijAllahu anhu) ka thënë: “U tha: “O i Dërguari i Allahut! Cilët janë njerëzit më të mirë?”

Tha: “Njerëzit më të mirë tek Allahu janë ata më të devotshmit.”

Ata thanë: “Ne nuk të pyetëm për këtë.”

Tha: “A po më pyesni mua për origjinën e Arabëve?”

Ata thanë: “Po.”

Tha: “Më i miri prej jush në periudhën e injorancës është më i miri prej jush në islam nëse ata e kuptojnë (fenë).”

Ka thënë Ebu Hatim (Rahimullah): “Njeriu më i mirë është ai që më së shumti i friksohet Allahut. Njeriu i mirë është personi i devotshëm.

Devotshmëria është vendosshmëria për të vepruar gjërat e urdhëruara dhe për tu përmbajtur nga të gjitha gjërat e ndaluara. Atij që i është vërtetuar vendosshmëria në këto dy cilësi, ai është “i devotshmi” dhe e meriton që të quhet “më i miri”. Ndërsa ai që i humb te dyja ato apo njëren prej tyre apo një pjesë prej tyre, të tillit i mangësohet nga mirësia e tij aq saka humbur prej tyre.”

Ka thënë Ebu Hatim (Rahimullah): “Njeriu i mirë nuk është urrejtës, as ziliqar, as që kënaqet me diçka që e ka goditur dikënd, as nuk i sulmon të tjerët, as nuk e proekupon veten me gjëra të kota, as nuk është i shkujdesur derisa të shkatërrohet, as keqbërës, as mburrës, as gënjeshtar, as nuk mërzhitet shpejt, as

nuk i këput lidhjet me shokun e tij, as nuk i dëmton shokët e tij, as nuk e humb atë për të cilën është përgjegjës, as nuk ka mungesë respekti në dashuri, ai i jep atij prej të cilit nuk pret që t`ia kthejë atë të mirë, ai e siguron atë që nuk ka frikë, ai fal kur ka mundësi të dënojë apo marr hak dhe i vazhdon lidhjet me ata të cilët i këpusin ato.”

**Ibrahim Ibn Shikiletu (Rahimullah) ka thënë:** “Çdo gjë ka jetë dhe vdekje. Ajo që i jep jetë njeriut të mirë është kontakti me njerëzit e mirë. Ndërsa ajo që i jep jetë njeriut të keq është shoqërimi me njerëzit e këqinj.”

**Ka thënë Ebu Hatim (Rahimullah):** “Njeriu i mirë bëhet i butë kur ai fiton ndjeshmërinë, ndërsa i keqi bëhet i vrazhdë kur trajtohet me mirësi. Njeriu i mirë i çmon njerëzit e mirë dhe nuk i poshtëron të këqinjët. Ai nuk e dëmton/bezdis të mençurin dhe as nuk bën shaka me budallain. Ai nuk shoqërohet me mëkatarin e paturpshëm porse u jep përparësi vëllezërve të tij duke u dhënë atyre atë çfarë ai zotëron...”

**Ibrahim Ibn Ebi Alijeh (Rahimullah) ka thënë:** “Kam parë Salim Ibn Abdullahin dhe Muhammed Ibn Abdul Aziz duke ecur me kalë në tokën romake. Njëri prej tyre e la kafshën e tij që të pushojë ndërsa tjetri ndaloi në mënyrë që të vinte tjetri (ai që pushoi).”

**Unë e pashë se si Salim bin Abdil-lah dhe Muhamed bin Abdil-Aziz shalëronin në Perandorinë Romake. Kur njëri prej tyre ishte duke pushuar kalin e tij, tjetri ndalohej në mënyrë që ai tjetri ta zinte atë.”**

**Sha’biu (Rahimullah) ka thënë:** “Njerëzit më të mirë janë ata që duan shpejtë dhe urrejnë ngadalë, të tillët ngjasojnë me gotën e argjendë e cila thyhet ngadalë dhe riparohet shpejtë. Njerëzit më të këqinj janë ata që duan ngadalë dhe urrejnë shpejtë, të tillët ngjasojnë me gotën prej balte e cila thyhet shpejtë dhe riparohet ngadalë.”

**Ka thënë Ebu Hatim (Rahimullah):** “Njeriu i mirë është ai që kur i jipet diçka falenderon, ndërsa atë që nuk i jep gjë ai e arsyeton, ndërsa ata që i këpusin lidhjet me të ai i vazhdon ato, ai që i mban lidhjet me të, atij i jep përparësi, kush kërkon prej tij, ai i jep, ndërsa atij që nuk kërkon, ai fillon dhe i jep, nëse dikush mendon se ai është i dobët, e mëshiron atë, nëse dikush e mendon si të dobët, ai e shikon vdekjen më të mirë për të se sa ajo çka ai përcepton për të. Ndërsa njeriu i keq, është e kundërta e çdo gjëje që kemi përmendur.”

**Ebu Isa (Rahimullah) ka thënë:** “Ibrahim Ibn Ed`hem ishte fisnik. Ai shoqërohej me njerëzit ashtu siç ata ishin dhe hante me ta.

**Tha:** Ndonjëherë ai u dhuronte atyre mish të pjekur në skarë dhe lloje hurmash. Ndodhte që kur ai ishte i vetëm me shokët e tij, me të cilët ai ndjehej rehat, ndodhte që ata të bënin mundje.

**Tha:** Ai bënte punën e dy burrave dhe kur ai ishte vetëm, hante brum (miell të përzier) me ujë.”

**Ebul Hauari (Rahimullah)** ka thënë: E kam dëgjuar babain tim duke thënë; Nuk ka njeri të cilit nuk i pranohet pendimi, përveç atij me karakter të keq. Ai nuk pendohet nga ndonjë mëkat vetëm se do të bjerë një mëkat më të keq (se ai që u pendua).”

**Ka thënë Ebu Hatim (Rahimullah):** “Njeriu i mirë në këtë jetë len pas tij gjurmë të lavdërueshme. Veprat e tij janë të pranuar në jetën tjetër. E don atë ai që është larg dhe ai që është afër, i pakënaquri dhe i kënaquri ndjehen rehat me të. Armiku dhe i keqi qëndrojnë larg tij, shoqërohen me të, të mençurit dhe më të mirët.

Unë nuk kam parë asnjë gjë që më së shumti e ul fisnikërinë e njeriut të mirë sikurse varfëria, pavarësisht nëse ajo është në zemër apo në materie.”

**Ebu Xhuhejfe (Rahimullah)** ka thënë: “Uluni me të moshuarit, shoqërohu me të mençurit dhe pyesni dijetarët.”

## **37. PËRMENDJA E NDËSHKIMIT NDAJ PRANIMIT TË FJALËS SË THASHETHEMXHIVE APO GËNJESHTARËVE.**

**Hudhejfja (radijAllahu anhu)** ka thënë: E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (salAllahu alejhi ue selem) duke thënë:

“Nuk do të hyjë në xhennet thashethemxhiu.”

**Ka thënë Ebu Hatim (Rahimullah):** “Janë të obliguar të gjithë njerëzit që të largohen nga të gjitha mendimet shkaqet e të cilave të shpien në urrejtje dhe ndarje mes njerëzve. I mençuri nuk futet në mendimet të cilat i përmendëm dhe as që i pranon fjalët e thashethemxhiut sepse ai e din se çfarë gjynahu merr dhe çfarë ndëshkimi ka për thashethemxhiun për veprën e tij.”

**Sulejman Ibn Daud (Rahimullah)** i ka thënë birit të tij: “Biri im! Bëj kujdes nga thashethemet sepse ato janë më të mprehta se shpata.”

Amr Ibn Mejmun (Rahimullah) ka thënë: “Kur Musa i biri i Imranit nxitoi që të takohet me Zotin e tij, pa një burrë poshtë Arshit dhe dëshiroi edhe ai një vend si të atij burri, dhe e pyeti Zotin e tij që t`i tregoi emrin e atij burrit.”

Zoti iu përgjigj dhe i tha: “Unë nga veprat e tij do të të tregoj tri vepra; Ai nuk i kishte zili (hased) njerëzit për ato gjëra që Allahu i kishte dhënë atyre, nuk ishte i keq me prindërit e tij dhe nuk merrej me thashetheme.”

El-Utbijju (Rahimullah) ka thënë: “E kam dëgjuar një grua beduine duke e këshilluar të birin e saj, i thoshte: Ruaji sekretet dhe ki kujdes nga thashethemet sepse thashethemet nuk lënë miqësi vetëm se e prishin atë dhe çdo urrejtje vetëm se e ndez (edhe më shumë) atë.”

Ka thënë Ebu Hatim (Rahimullah): “Duhet patjetër që të ruhemi nga të ulurit me atë që është i njohur për thashetheme, as duhet t`i besojmë dashurisë (që shfaq) së tij dhe nuk duhet t`i vazhdojmë lidhjet apo të jetojmë me të.”

Ibrahim Ibn Ebi Uljeh (Rahimullah) ka thënë: “Isha i ulur me Ummu Derdan, i erdhi dikush dhe i tha; Oj Ummu Derda! Një burrë të shau ty tek Abdul Melik Ibn Meruan.”

Ajo u përgjigj dhe tha: “Disa herë akuzohemi me atë që nuk gjendet tek ne e disa herë ngrehemi (duke u lavdëruar) me diçka e cila nuk gjendet tek ne.”

Ka thënë Ebu Hatim (Rahimullah): “Obligohet i mençuri që t`i injorojë (mos t`i japi rëndësi) fjalëve që transportojnë thashethemexhijtë duke i refuzuar të gjitha ato me mirësi si dhe të largohet nga gjërat që nuk i përshtaten njerëzve të mençur.”

Jahja Ibn Ebi Kethiri (Rahimullah) ka thënë: “Atë që e arrin thashethemexhiu për një orë (kohë të shkurtër) nuk e arrin magjستاني për një muaj.”

Ka thënë Ebu Hatim (Rahimullah): “Prej fryteve të thashethemeve është se ato i heqin perdet (gjërave që janë të mbuluara dhe zbulohen), i përhapin sekretet, nxisin urrejtje, e largojnë dashurinë, e ripërtërisin (e shtojnë) armiqësinë, e ndajnë xhematin, e rrisin urrejtjen dhe e shtojnë frikën.

Nëse dikush lajmërohet se vëllai i tij i ka bërë diçka, atëherë obligohet ta këshillojë atë duke ia pranuar ndjesën nëse ajo thuhet dhe duke ia pranuar arsyetimin nëse arsyetohet. Nuk duhet ta kritikojë shumë, duke u siguruar dhe duke qenë falenderues kur të drejtat të ruhen, duhet të jetë i durueshëm kur ato (të drejtat) humbin dhe të jetë këshillues kur trajtohet me të keqe.”

Alij Ibn Ebi Talib (radijaAllahu anhu) ka thënë: “Mos kritiko shumë sepse kritika mbjell urrejtje të madhe, dhe shtimi i tepërt i kritikës është prej edukatës së keqe.”

## **38. PËRMENDJA E MIRËSISË SE PRANIMIT TË ARSYETIMIT NGA ARSYETUESI.**

I Dërguari i Allahut salAllahu alejhi ue selem ka thënë:

“Ai i cili i kërkon falje vëllait të tij dhe nuk ia pranon faljen, ai do të marrë një dënim të njejtë si ai që merr taksa.” (Hadithi është Hasen).

Ka thënë Ebu Hatim (Rahimullah): “I mençuri është i obliguar që kur vëllai i tij të kërkojë falje për gabimet apo për mangësitë e kaluara, t`ia pranojë faljen dhe ta llogarisë atë si ai i cili nuk ka gabuar. Sepse unë kam frikë se ai i cili nuk i pranon justifikimet nuk do ta arrijë Haudin e të përzgjedhurit salAllahu alejhi ue selem. Ai i cili është i pakujdesshëm për shkak të ndonjë arsye, është i obliguar që t`i kërkojë falje vëllait të tij për mangësitë e tij.”

Ka thënë Ebu Hatim (Rahimullah): “Nuk është e lejuar që të shtohen shumë të kërkuarit falje tek vëllai ytë, sepse shtimi i kërimit falje është shkak që të çon në dyshime. Unë rekomandoj që të kërkonit falje sa më pak në përgjithësi sepse justifikimet përzihen me gënjeshtra. Të pakët janë ata që unë kam parë të cilët janë justifikuar dhe nuk e kanë përzier justifikimin e tyre me gënjeshtra.”

Ai i cili e pranon gabimin, meriton të falet për të, pasi poshtërimi në kërkimin e faljes për gabimin bën që zemërimi të shuhet.

Ebu Kilabe (Rahimullah) ka thënë: “Nëse të arrin diçka nga vëllai jot të cilën e urren, gjeji atij një justifikim, nëse nuk i gjen ndonjë justifikim, thuaj; ndoshta ai ka ndonjë arsyetim të cilin unë nuk e di.”

Ka thënë Ebu Hatim (Rahimullah): “Nuk është e lejuar që të publikohet dënimi ndaj personit të cilit nuk i është publikuar mëkati i tij. Sepse njerëzit më të këqinj janë ata të cilët nuk i fshehin gabimet dhe fajet, dhe në qoftë se ai nuk është i sinqertë, është e obliguar për atë që e din se ai po gënjen dhe akoma e poshtëron veten me arsyetime, që të mos ta ndëshkojë për një mëkat që ka kaluar. Në vend të kësaj, ai duhet ta falënderoj atë për veprën e tij të madhe që tregohet në kërkimin e faljes nga ai. Nuk është mangësi që personi i cili arsyetohet duke poshtëruar veten e tij dhe përulet përpara vëllait të tij kur ai kërkon falje prej tij.”

**Ka thënë Ebu Hatim (Rahimullah):** “Kërkimi i faljes e largon shqetësimin, pikëllim, urrejtjen dhe tmerrin. Të pakësosh kërkimet e faljes i fundosin kundërvajtjet e mëdha dhe mëkatet e shumta. Shtimi në kërkimet e faljes të shpien në dyshime dhe në mendime të këqija. Sikur cilësia e vetme e personit i cili kërkon falje, do të ishte se personi i cili kërkon falje nuk është mëndjemadh kur ai kërkon falje, kjo do të kishte qenë e mjaftueshme për ta obliguar personin e mençur që ta falë atë për çdo gabim që vepron.”

## **39. NXITJA PËR TË MOS I TREGUAR TË FSHEHTAT.**

**Ka thënë Ebu Hatim (Rahimullah):** “I mençuri është i detyruar që të mos ia zbulojë sekretet e tij dikujt, pavarësisht nëse personi është i besueshëm apo jo. Herët ose vonë do tu ndodh atyre diçka e cila e bën atë që t`ia zbuloi sekretin e tij.”

**El-Meda'ini (Rahimullah) ka thënë:** “U ka pas thënë, se personi me durimin më të fortë është ai i cili nuk ia zbulon të fshehtën shokut të tij, nga frika se mos ndodh diçka mes tyre dhe më pas ai ia përhap të fshehtën.”

**Ka thënë Ebu Hatim (Rahimullah):** “Ai i cili e ruan të fshehtën e tij, do t`i dal për zot programit të tij, do të arrijë qëllimet e tij dhe do t`i shpëtoi dështimeve dhe dëmeve. Nëse nuk i jipet ajo që ai e shpresonte, ai e ruan sekretin e tij në një enë dhe e ruan atë larg nga të gjithë. Nëse ai detyrohet që ta zbuloj atë, ai ia tregon atë personit i cili ia dëshiron të mirën atij, sepse e sekretin është amanet dhe zbulimi i tij është tradhëti. Zemra ka enët e saj. Ka enë që nuk mbajnë dhe nuk zënë shumë, dhe ka që mbajnë dhe zënë shumë.”

**Ibnul E`arabij (Rahimullah) ka thënë:** “Ishte zakon të thuhej se; I mençur është ai i cili ruhet nga shoku i tij.”

**Ka thënë Ebu Hatim (Rahimullah):** “Është paaftësi që të mos jesh në gjendje të ruash sekrete. Atë që e fshehu ndaj armikut, nuk të obligohet që t`ia tregosh shokut. Përvojat vlejné si mësim për të mençurit. Kushdo që e dëgjon një ndodhi ta mbuloi atë dhe jo ta shqyej apo ta përhap atë, sepse sekretin është quajtur sekret për arsyen se nuk duhet të përhapet.

Kështu që, obligohet njeriu i mençur që të ketë një gjoks më të gjërë se të tjerët për sekretet e tij, dhe të kujdeset që të mos e përhap atë.”

**Ka thënë Ebu Hatim (Rahimullah):** “Fitorja vjen me vendosmëri. Vendosmëria vjen me reflektime. Reflektimet vijnë me ruajtjen e sekreteve. Ai që e ruan sekretin e



tij, zgjedhjen e ka në dorë. Ai që ua tregon të tjerëve të fshehtat e tij, bjen në sytë e tyre dhe e fshehta e tij zbulohet. Kushdo që nuk e mban të fshehtë, meriton që të kritikohet dhe ai që e meriton kritikimin, ka logjikë të mangët, ndërsa ai i cili vazhdon po në këtë gjendje, kthehet në injorancë.”

**Ka thënë Ebu Hatim (Rahimullah):** ” I mençuri duhet ta dijë se konsultimi i zbulon të fshehtat. Prandaj, ai nuk duhet të konsultohet me dikë që nuk është i mençur, këshillues, i dashur dhe fetar. Një konsultim me një person në mënyrën e përshkruar është prej mirësive.”

**Hasan El-Basri (Rahimullah) ka thënë:** “Ai i cili kërkon nga këshilluesi një këshillë nuk do të pendohet.”

**Ka thënë Ebu Hatim (Rahimullah):** “Obligohet i mençuri i cili gjendet në mesin e një grupi njerëzish prej të cilëve kërkohet që të japin këshilla, të jetë i fundit që do të japë ndonjë këshillë. Sepse kjo i jep atij më shumë kohë për të menduar dhe e mbron atë nga gabimet, në këtë rast shanci është më i madh për të qenë vendimtar dhe rreziku që të gaboi është më i vogël.

Ai i cili kërkon këshilla, duhet të sigurohet që të mos pyes ndonjë person të paaftë për këshilla, e njëjta mënyrë sikurse nuk i kërkohet ndihmë personit përtac. Konsultimi është udhëzim i pastër. Ai i cili kërkon këshillë nuk do ta humbas udhëzimin. Ai i cili nuk kërkon këshilla nuk do të jetë larg humbjes dhe ai i cili kërkon nga këshilluesi një këshillë nuk do të pendohet.”

**Ka thënë Ebu Hatim (Rahimullah):** “Prej cilësive të personit të mençur është se në raste vështirësie kërkon këshillë nga personi i mençur dhe këshillues dhe më pas i bindet atij. Ai duhet ta pranojë të vërtetën dhe të mos mbahet pas të kotës, porse duhet ta pranojë të vërtetën prej çdokujt që vjen. Ai nuk duhet ta nënvlerësoi mendimin e saktë nëse ai i vjen nga një person i ulët. Sepse perla e rrezikshme nuk ndikohet nga rreziku i pakët i zhytësit i cili don ta nxjerri atë dhe më pas e lut Allahun që ta udhëzojë dhe të heci sipas udhëzimit.”

Në rast vështirësie është prej cilësive të së mençurit që të kërkon këshillë nga personi dashamirës dhe pastaj t’i bindet atij. Gjatë konsultimit, ai duhet të pranojë të vërtetën dhe të mos disputoj me gënjeshtër. Ai duhet ta pranojë të vërtetën nga personi i cili ia paraqet atë. Ai nuk duhet ta nënvlerësojë mendimin fisnik që vie nga personi i ulët. Perla e rrezikshme nuk ndikohet në mënyrë negative nga rreziku i pakonsiderueshëm i zhytësit. Pastaj ai lut Allahun për udhëzim dhe vepronë përgjatë udhëzimeve.

## **40. NXITJA PËR TË KËSHILLUAR TË GJITHË MYSLIMANËT NË PËRGJITHËSI.**

I Dërguari i Allahut salAllahu alejhi ue selem ka thënë:

**“Feja është këshillë.”**

Ata thanë: **“Për kë, o i Dërguari i Allahut?”**

Ai tha: **“Për Allahun, për Librin e Tij, të Dërguarin e Tij, për udhëheqësit e myslimanëve dhe për njerëzit e thjeshtë (masën e gjërë).”**

**Ka thënë Ebu Hatim (Rahimullah): “Është i obliguar njeriu i mençur që të jetë këshillues për të gjithë myslimanët në përgjithësi dhe të mos e zhgënjej askënd në asnjë lloj mënyre. Profeti i zgjedhur salAllahu alejhi ue selem i vendoste kusht secilit prej shokëve të Tij, i cili vinte të besatohej se “Këshillimi (me ja dasht të mirën) ndaj çdo myslimani, të falte namazin dhe të jepte zekatin.”**

**Alij Ibn Ebi Talib radijallahu anhu ka thënë: “Mos mashtro sepse mashtrimi është karakteristikë e njerëzve të këqinj. Dëshiroja të mirën vëllait tënd sido që ta kuptojë dhe zhduku kur ai të zhduket.”**

**Ka thënë Ebu Hatim (Rahimullah): “Vëllezërit më të mirë janë ata që ia duan të mirën (i këshillojnë) vëllezërve të tyre. Sikurse edhe veprat më të mira janë ato që kanë frytet e mira dhe më të mirat prej tyre janë ato të sinqertat. Të të rrah ai i cili të këshillon është më e mirë se sa të të përshëndes ai i cili të urren.”**

**Hasan El-Basri (Rahimullah) ka thënë: “Besimtari është pjesë e besimtarit. Ai është pasqyra e vëllait të tij. Nëse sheh tek ai diçka që nuk i pëlqen, ai e korrigjon, e udhëzon dhe e këshillon atë fshehurazi dhe haptazi.”**

**Ka thënë Ebu Hatim (Rahimullah): “Këshilla është e rrethuar nga akuzat. Këshilla duhet tu jepet vetëm atyre që e pranojnë atë, e njëjtë sikurse dynjaja është vetëm për atë që e braktis atë dhe se bota tjetër është vetëm për ata që e kërkojnë atë.**

Është më mirë që të konsultoheni me një person të shurdhur se sa me një person i cili ta kthen shpinën. Ta këshillosh një person i cili është përbuzës, është e njëjtë sikur të mbjellësh në tokë të kripur. Shumica e njerëzve të cilët nuk i pranojnë këshillat janë ata të cilët janë të dashuruar në vetvetet e tyre.

Është e detyrueshme që t`ia duash të gjithve të mirën, gjë të cilën e kemi thënë më lartë. Megjithatë, këshilla duhet të bëhet vetëm fshehurazi. Ai që e qorton vëllain e tij publikisht, ai vetëm se e ka shëmtuar atë, ndërsa ai që e qorton vëllain e tij

fshehurazi, vetëm se e ka zbukuruar atë. Është më mirë për myslimanin që të veprojë atë që e zbukuron vëllain e tij se sa atë që e shëmton atë.

**Sufjani (Rahimullah) ka thënë: “Unë i thashë Mis’arit; A dëshiron që një njeri të vij tek ti dhe t`i tregosh për mangësitë e tua?”**

**Ai u përgjigj: “Jo, në qoftë se ai do të më dënoj, ndërsa dëshiroj (që t`i tregoj) vetëm nëse ai më këshillon mua.”**

**Ibnul Mubarak (Rahimullah) ka thënë: “Kanë qenë burrat që kur shikonin prej vëllezërve të tyre atë gjë që e urrenin, i këshillonin ata fshehurazi dhe i ndalonin ata fshehurazi. Ata shpërblehen për shkak të këshillimit dhe ndalimit fshehurazi. Ndërsa sot, nëse shikon dikush prej dikujt atë çfarë e urren, fillimisht e ngacmon dhe më pas ia përhap.”**

**Sufjani (Rahimullah) ka thënë: “Erdhi Talha tek Abdul Xheb-bar Ibn Ua’il, dhe tek ai ishte një grup me njerëz. Talha i tha atij diçka të cilën nuk e dëgjoj askush dhe më pas u largua. Më pas (Abdul Xheb-bari) tha: “A e dini se çfarë më tha mua? Ai më tha: “Unë të pashë që ti u ktheve dhe ti ishe duke u falur.”**

**Ka thënë Ebu Hatim (Rahimullah): “Nëse këshilla jipet në mënyrën të cilën e përmendëm, atëherë ajo do të plotësohet dhe të drejtat vëllazërore do të përmbushen.”**

## **41. POROSITË E KHATTAB EL-MAKHZUMIJ DREJTUAR BIRIT TË TIJ.**

**“Biri im i dashur! Kije frikë Allahun dhe bindju Atij. Largohu ndalesave të Tij duke pasuar rrugën e Tij në mënyrë që të metat e tua të përmisohen dhe të jesh i lumtur.**

**Bindju babait tënd, ji i kënaqur me këshillat e tij dhe përqendrohu plotësisht në të.**

**Unë ta tërheq vërejtjen ndaj të folurës së tepërt, ndaj të qeshurit të shumtë dhe ndaj shakasë si dhe ndaj gabimeve me vëllezërit sepse këto e largojnë respektin dhe sjellin urrejtjen.**

**Ti duhet të jesh hijerëndë dhe i respektuar, dhe jo mendjemadh dhe i cilësuar me të.**

Takohu me mikun dhe armikun tënd me një fytyrë të kënaqur. Kurseji atyre vuajtjet pa e poshtëruar veten tënde dhe pa pasur frikë ndaj tyre.

Ji i mesëm në të gjitha punët e tua sepse punët më të mira janë ato të mesmet. Mos flit shumë. Përhape selamin dhe mos u ul nëpër vende ku ka shumë njerëz dhe as tregjet mos i merr si vend takimi.”

## **42. POROSITË E KHATTAB EL-MAKHZUMIJ DREJTUAR BIRIT TË TIJ**

“Mos debato shumë. Mos u grind me idiotat. Në qoftëse flet, fol pak. Nëse bën shaka, bëj pak. Në qoftë se ulesh dikund, ulu këmbëkryq. Bëj kujdes nga të kërciturat e gishtave, luajtjen me mjekërrën, unazën dhe me këllëfin e shpatës. Mos i pastro dhëmbët (në prani të të tjerëve) dhe mos e fut gishtin në hundë. Mos i largo mizat prej teje gjatë gjithë kohës dhe çdo gjë tjetër e cila i bën njerëzit të nënvlerësojnë dhe të përgojnë ty.

Ulu i qetë dhe le të jetë biseda yte e ndarë. Dëgjoje atë që flet diçka të bukur pa u çuditur dhe pa i kërkuar atij që ta përsërisi. Rri larg humorit, tregimeve dhe përrallave.

Mos u trego të tjerëve se sa të pëlqen djali, robëresha, kali apo dhe shpat jote. Gjithashtu të tërheq vëmendjen që të mos i tregosh ëndrrat e tua.

Mos u sill me sjelljen e gruas dhe as mos u ndrysho sikurse ndryshon robi.”

## **43. POROSITË E KHATTAB EL-MAKHZUMIJ DREJTUAR BIRIT TË TIJ**

“Mos i hiq qimet e ashpra nga fytyra jote dhe as mos i hiq qimet poshtë mjekrës. Mos u kruaj shumë. Mos i hiq qimet e thinjura. Mos vendos shumë kuhl në sytë e tu. Mos e tepro duke vendosur shumë vaj në flokët e tua.

Mos ia trego gruas tënde dhe fëmijëve tuaj apo dikujt tjetër se sa është pasuria jote. Sepse nëse ata mendojnë se janë të pakta, ata të nënvlerësojnë dhe nëse ata mendojnë se ato janë shumë, ata kurrë nuk janë të kënaqur me ty.

Trembi ata pa dhunë dhe ji i butë ndaj tyre pa dobësi. Mos bëj shaka me robërëshën tënde. Kur të grindesh bëje atë me dinjitet. Mos ji pa respekt, mos u nxito dhe mendo për argumentet e tua. Sigurohu që të mos skuqesh në fytyrë dhe të mos djersitet balli. Nëse dikush të trajton me respekt ktheja me butësi. Flit atëherë kur zemërimi yt ka rënë. Nderoje nderin tënd dhe qëndro larg nga bollëku.

Nëse sundimtari të afron ty, ti duhet të qëndrosh larg tij sa distanca e një shtize. Nëse ai të flet ty i qetë, nuk duhet të jeshë i sigurt se ai nuk do të kthehet kundër teje. Sillu butë me të ashtu sikurse sillesh butë me fëmijët dhe thuaji atij atë që ai dëshiron të dëgjojë.

Kur të flasësh, fol të vërtetën. Mos e ngrej zërin sikurse ngrehet kur flet me një person që nuk dëgjon dhe as mos e ul zërin tënd si memec. Zgjidhi fjalët e tua dhe flit një fjalim të bukur. Mos flit për gjëra të çuditshme të cilat nuk i pranojnë zemrat dhe të cilat ta rrënqethin lëkurën.

Mos i përsërit fjalët tuaja, p.sh të thuash; “Po, po”, “Jo, jo”, “Shpejto, shpejto,” dhe të ngjashme.

Mos ji koprrac. Mos ji shkapërderdhës. Sigurohu që të kesh dije në lidhje me obligimin e parave tuaja dhe për shenjtërin e mikut tuaj. Mos ji në nevojë të njerëzve dhe ata do të jenë në nevojë për ty.

Kur një person i njeh aftësitë e tij, e nderon emrin e tij.”

## **44. POROSITË E KHATTAB EL-MAKHZUMIJ DREJTUAR BIRIT TË TIJ**

Një grua e keqe është një sëmundje e pashërueshme. Martesa me një grua të vjetër e largon drojën dhe bindja ndaj grave i poshtëron të mençurit.

Imitojë të mençurit dhe do të bëhesh një prej tyre. Përpiqu ta fitosh nderin dhe do ta arrish atë.

Një person njihet përmes shokut të tij. Qëndro larg nga vëllezërit e këqinj, sepse ata i mashtrojnë dhe i shqetësojnë shokët e tyre. Afrimi i tyre është më i dëmshëm se sa zgjebeja. Të qëndruarit larg prej tyre është prej etikave të larta.

Egzistojnë dy lloje të shokëve. Njëri që kujdeset për ty në vështirësi dhe njëri është shokë i ytë vetëm atëherë kur nuk je në vështirësi. Qëndro me shokun e

vështirësive dhe shmangu nga shoku i rehatllëkut sepse ata janë armiqtë më të këqinj.

Qëndro larg nga korrupsioni edhe në qoftë se gjendesh në vendin e armikut. Mos e poshtëro veten tënde për dikë që është më me pak vlerë se sa ti. Sigurohu që të mos shkëlqesh shumë dhe të jesh shumë i butë.

Që injoranti të të dënojë ty, është më mirë se sa të lavdëroi ty. Njohja e së vërtetës i takon karaktereve të besimit.

Ai i cili është në nevojë është i poshtëruar, fjala e tij nuk hecën dhe egziston frika që ai të mohohet.

Misvaku le të jetë nga natyrshmëria jote dhe kur ta përdorësh atë, pastro anash.

Ai i cili e nderon nderin e tij nderohet nga njerëzit.”

## **45. POROSITË E KHATTAB EL-MAKHZUMIJ DREJTUAR BIRIT TË TIJ**

Biri im i dashur! Gruaja është e qetësia e burrit. Ai nuk mund të jetojë bashkë me të nëse ata nuk bien dakord. Nëse dëshiron të martohesh me një grua, duhet të pyesësh në lidhje me familjen e saj sepse rrënjët e mira japin fryte të mira.

Duhet ta dish se gratë janë të ndryshme. Largoju grave të bezdisshme. Ka gra që vetja ju duket dikushi dhe nënvlerësojnë burrat e tyre. Nëse ajo i jep atij diçka, ajo e sheh veten sipër tij. Ajo nuk falënderon për një trajtim të mirë. Ajo nuk kënaqet nëse ai i jep pak asaj. Gjuha e saj kundër tij është si një shpatë e mprehtë.

Ajo nuk kujdeset për fenë e tij apo jetën në dynja. Ajo nuk kujdeset për të, për hir të shoqërisë apo për hir të fëmijëve të shumtë. Petku i tij është grisur dhe është shpërndarë. Ai zgjohet i mërzitur dhe është i mallkuar në mbrëmje. Pija e tij është hidhërimi dhe ushqimi i tij është urrejtja. Fëmijët e tij janë të devijuar. Shtëpia e tij është e konsumuar. Rrobat e tij janë të pista. Flokët e tij janë të pakrehura. Nëse ai qesh, ai është i poshtëruar. Nëse ai flet, ai është i detyruar. Dita e tij është natë dhe nata e tij është një dhimbje. Ajo e kafshon atë si një gjarpër dhe e shpon atë si një akrep.

Ka gra helmuese. Ato kthejnë shaminë nga fryen era. Nëse ai thotë “Po”, ajo thotë “Jo”. Nëse ai thotë “Jo”, ajo thotë “Po”. Ajo e poshtëron atë.

Ka gra budallaqe. Ato flirtojnë në kohët e gabuara dhe mirren me gjëra që nuk u përkasin atyre. Ajo është e kënaqur me dashurinë dhe të hollat e tij. Ajo ha sikurse gomari kur kullot. Dielli ngrihet pa thënë ajo asnjë fjalë. Shtëpia e tij është e parregulluar. Ushqimi i tij është i ngelur. Pjatat e saj janë me yndyrë. Brumi i saj është i tharë.

Ka gra që janë të dashura dhe tërheqëse. Ato janë të bekuara dhe pjellore. Ato janë të besueshme kur burrat mungojnë. Komshijtë e duan atë. Ajo është e lavdëruar në vetminë e saj dhe kur ajo është me të tjerët. Ajo është një grua fisnike. Ajo është shumë bujare. Ajo flet me zë të ulët. Shtëpia e saj është e pastër. Shërbëtori i saj është i trashë. Djali i saj është i pastër dhe i bukur. Mirësia e saj është e qëndrueshme. Burri i saj kënaqet.

## **46. PËRKUJTIMI NGA RREZIKSHMËRIA E BOJKOTIMIT MIDIS MYSLIMANËVE NË PËRGJITHËSI**

Profeti salAllahu alejhi ue selem ka thënë:

**“Mos e urreni njëri-tjetrin. Mos garoni kundër njëri-tjetrit. Mos e keni zili njëri-tjetrin. Mos ia ktheni shpinën njëri-tjetrit. Jini o robër të Allahut vëllezër.”**

Ka thënë Ebu Hatim (Rahimullah): **“Nuk është e lejuar për myslimanët që të urrejnë njëri-tjetrin, të garojnë kundër njëri-tjetrit, ta kenë zili njëri-tjetrin apo tia kthejnë shpinën njëri-tjetrit. Ata janë të obliguar që të jenë myslimanë ashtu siç ka urdhëruar Allahu dhe i Dërguarit i Tij salAllahu alejhi ue selem.**

Nëse njëri vuan nga një dhimbje vuan edhe tjetri po nga ajo dhimbje. Nëse njëri është i lumtur edhe tjetri është i lumtur. Ai nuk gënjen dhe as nuk mashtron, duke ia dorëzuar veten Allahut të Lartësuar, duke qenë i kënaqur me obligueshmërinë e të gjitha dispozitave Nuk është e obliguar që myslimanët të bojkotojnë njëri-tjetrin për shkak të një gabimi që dikush vepron. Në vend të kësaj, ata janë të obliguar që ta zëvendësojnë gabimin me një sjellje të bukur dhe me një përkujdesje dhe ta braktisin bojkotimin e njëri-tjetrit.

Ka thënë Ebu Hatim (Rahimullah): **“Personi nuk duhet të jetë si një njeri i thjeshtë dhe njeri injorant, i cili e përdhos dashurinë ndaj vëllezërve për shkak të faktorëve që shkaktojnë bojkotin, që Profetit salAllahu alejhi ue selem e ndaloi. Në vend të kësaj, ai duhet të sigurohet që të injorojë gabimet dhe të mos diskutoj**

në lidhje me gabimet e bëra. Kjo vlenë në veçanti në lidhje me çështjet që mund të kuptohen në mënyrë të saktë dhe në të gabuar.”

Muhamed Ibn Abdir Rahman (Rahimullah) ka thënë: “Kam dëgjuar Ebu Ammar Husejn Ibn Hurejthin të thotë:” “Iu tha një burri; A ke ti të meta?” Ai tha: “Jo.” Iu tha atij: “A ekziston dikush i cili është në kërkim të të metave të tuaja?” Ai tha: “Po.” Iu tha atij: ” Sa shumë të meta që paske!”

Ka thënë Ebu Hatim (Rahimullah): “Shkaqet që çojnë në bojkotimin midis myslimanëve janë tri; Gabimi i vëllait të tij, i cili është e pashmangshëm. Shpifja e personit që mirret me thashetheme dhe mërzitnia e cila iu bashkangjitet njërit prej këtyre dy gjërave. Mërzitnija të çon në shkëputjen e lidhjeve, ndërsa një person i mërzitshëm nuk ka asnjë shok.

Ka thënë Ebu Hatim (Rahimullah): “Nuk i lejohet asnjë myslimani që ta bojkotojë vëllain e tij më shumë se tri ditë. A i cili e vepron këtë gjë ka rënë në ndalesën e Profetit salAllahu alejhi ue selem. Më i miri prej tyre është ai i cili fillon të jap selamin. Ai i cili e jep selamin i pari, ai do të hyjë në xhennet i pari. Ai i cili e bojkoton vëllain e tij për një vit, është e njëjtë sikur i ke derdhur gjakun (sikur e ke vrarë). Ai i cili e ka bojkotuar vëllain e tij dhe vdes, do të hyj në zjarr nëse nuk e fal dhe e mëshiron Allahu. Maksimumi që u lejohet muslimanëve të bojkotohen është tri ditë.”

## 47. I MENÇURI DHE NDJESHMËRIA

Ka thënë Ebu Hatim (Rahimullah): “Ndjeshmëria do të thotë që ta frenosh veten kur ajo trajtohet në një mënyrë të keqe, në mënyrë që ai të mos arrijë tek e ndaluara. Ndjeshmëria përbëhet prej dijes, durimit, qetësimi dhe qëndrueshmërisë. Nuk ka asnjë cilësi më të bukur se sa kur bashkohen ndjeshmëria dhe pushteti. Ndjeshmëria më e bukur është kur je i ndjeshëm dhe kur ke aftësinë për t’u hakmarrur.”

Damratu (Rahimullah) ka thënë: “Ndjeshmëria është më lartë se sa logjika sepse Allahu i Lartësuar e ka quajtur Vetën e Tij me atë emër.”

Ka thënë Ebu Hatim (Rahimullah): “Nëse cilësia e vetme e ndjeshmërisë do të kishte qenë se ajo e pengon personin nga mëkatet, ajo do të ishte e mjaftueshme për ta obliguar të mençurin që ta mos e braktisë kurrë ndjeshmërinë për derisa ka mundësi. Ndjeshmëria është një cilësi me të cilën lind njeriu ose përvojë ose që të dyja.”



Muauije Ibn Ebi Sufjan radijaAllahu anhu ka thënë: “Nuk ka ndjeshmëri vetëm se me përvojë.”

Ebu Derda radijAllahu anhu ka thënë: “Dituria arrihet vetëm me të mësuar dhe ndjeshmëria arrihet vetëm me përvojë. Ai që e synon mirësinë do ta arrijë atë dhe ai që i shmanget të keqes do të shpëtojë prej saj.”

Ka thënë Ebu Hatim (Rahimullah): “I mençuri është i ndjeshëm ndaj të gjithë njerëzve. Nëse ai e sheh këtë shumë të vështirë ai duhet të pretendojë se është i ndjeshëm, sepse kjo gjë shpie në ndjeshmëri.”

Ibnul Mubarak (Rahimullah) ka thënë: “Na thirri Abdullah Ibn Aun për të ngrënë. Ne ishim duke ngënë dhe shëbërtorja e tij hyri dhe në dorë kishte një enë, u ngatarrua me rrobot e saj dhe i ra ena nga dora, dhe i tha asaj Ibn Auni; “Mos u frikëso! Ti je e lirë.”

Muhamed Ibnus Sa'da (Rahimullah) i tha djalit të tij Ur`ues kur ai mori pushtetin në Jemen: “Nëse zemërohesh shiko lart në qiell dhe poshtë në tokë dhe më pas madhëroje Krijuesin e tyre.”

Xhafer Ibn Sulejman (Rahimullah) ka thënë: “Ishte një grua e devotshme në Basra, të cilën gjithmonë e godisnin fatkeqësi. Ne habiteshim me durimin e saj, derisa një ditë ajo u godit nga një fatkeqësi e rëndë dhe ajo vazhdoi të duronte. Kur fola me të në lidhje me këtë ajo tha; “Çdo fatkeqësi që më godet, bashkë me të kujtoj edhe xhehennemin dhe ajo (fatkeqësia) bëhet tek sytë e mi sikurse rëra.”

Bekr Ibn Mudar (Rahimullah) ka thënë: “Ebul Hejthemit i vdiq djali dhe ai la jetim një foshnje të vogël, e cila vdiq. I erdhën vëllezërit për ngushëllim dhe ai ishte në një anë të xhamisë, dhe u tha atyre; Brenga në ditën e gjykimit më ka bërë mua që të mos pikëllohem për çfarë unë kam humbur dhe as të gëzohem për atë që më është dhënë.”

## **48. I MENÇURI DHE BUTËSIA DHE NXITIMI**

01 - I mençuri është i obliguar të jetë i butë në të gjitha çështjet dhe të mos nxitohet. Allahu Azze ue Xhel e do butësinë në të gjitha çështjet. Ai që privohet nga butësia është privuar nga mirësia, sikurse që atij që i ipet butësia i ipet mirësia. Një person vështirë që të zbatojë ëndrrën e tij nëse ai nuk i përmbahet butësisë dhe ti shmanget nxitimit.

02 - I mençuri është i butë në disa çaste dhe i mesëm në disa situata, sepse teprimi përtej masës është mangësi, ashtu edhe mangësimi i gjërave të obliguara është paaftësi. Ai që nuk korrigohet nga butësia nuk korrigohet as nga dhuna. Nuk ka dëshmi më të përsosur se sa mirësia, nuk asnjë ndihmë më të fortë se sa mençuria. Butësia të shpie në kujdes, ndërsa me kujdes shpresohet shpëtimi. Mungesa e butësisë shkakton të çara, ndërsa nga të çarat vie shkatërrimi.

03 - Njeriu i butë vështirë se mund të tejkalohet, sikurse që personi inxituar është vështirë të arrihet. Sikurse ai që hesht është vështirë që do të ndjejë keqardhje. Ai që flet vështirë që do të shpëtoj. Personi në nxitim flet para se ai të dij, përgjigjet para se ai të kuptoj, lavdëron pa e provuar, qorton pasi ka lavdëruar, vendos para se ai të mendoj dhe vepron para se ai të vendos. Nxitimin e shoqëron keqardhja dhe e braktisë shpëtimi. Arabët e kishin zakon ta quanin nxitimin “Nëna e keqardhjeve.”

04 - Nxitimi është nga ashpërsia, kur personit të nxituar i vie rasti nuk bën vepër të lavdëruar, e nëse nuk i vie rasti ai është i qortuar. Është më vendosmëri për të bërë një akt pas shqyrtimit të tij se sa ta braktisë atë pasi ke filluar ta veprosh. Nxitimi kurrë nuk është i lavdërueshëm.

05 - Esh-Shamardal ka thënë: **“Paaftësia u martua me vonesën dhe iu lindi keqardhja.”**

06 - Shkaku i suksesit qëndron në mungesën e vonesës, ndërsa faktor i privimit është përtacia, sepse ajo është armik i dinjitetit dhe dënimi i rinisë. Vonesa dhe paaftësia shpien në shkatërrim. Ndrësa ngadalësimi pasi të vie rasti është gabimi më i madh. Nxitimi para se të vie rasti është një gabim i njëjtë. Njeriu i udhëzuar është ai që i shpëton nxitimit, ndërsa i humburi është ai që humb për shkak të ngadalësisë. Ai që nxitet gjithmonë gabon. Ai që sigurohet mirë gjithmonë është korrekt.

## **49. I MENÇURI DHE ELOKUENCA**

01 - Profeti salAllahu alejhi ue selem ka thënë:

**“Vërtetë ka gojëtarin që është magji.”**

02 - Profeti salAllahu alejhi ue selem e krahasoi gojëtarinë me magjin. Sepse magjistari tërheq zemrën e shikuesve përmes magjisë ndërsa gojëtarin tërheq zemrën e dëgjuesve nëpërmjet gojëtarisë dhe retorikës.

03 - Ibn Shubrumah ka thënë: “Unë nuk kam parë një tipar më të mirë tek një burrë sesa gojëtaria, dhe unë nuk kam parë një tipar më të mirë tek një grua se sa trashësia e saj. Kur një njeri flet me gojëtarin është sikurse ai të ketë veshur mëndafsh të errët. Kur një njeri ka defekte në të folurit e tij është sikurse ai të jetë i veshur me rroba të grisura. Nëse do ta nënvlerësosh personin e moshuar dhe ta vlerësosh të riun duhet ta mësoshë gramatikën.”

04 - Gojëtaria është veshja më e bukur që një njeri mund të ketë dhe izari më i bukur që mund ta posedon një i mençur. Letërsia është një mik në vetmi, një shoqërim në boshllëk, një bukuri në turmë, një shtesë e mençurisë dhe një dëshmi e dinjitetit. Ai që përfiton nga letërsia si i ri do të përfitojnë nga ajo si i vjetër. Ai që mbjell një palme të vogël së shpejti do të ha hurmat e freskëta të saj. Të mençurit nuk i shohin të barabartë dy njerëz; gojëtarin dhe të kundërtën e tij.

05 - Selim bin Kutejbe ka thënë: “Ne ishim ulur dhe bisedonim tek Ibn Hubejreh kur ra biseda për gjuhën arabe. Ai tha: “Beto hem në Allahun se të dy burra nuk janë të barabartë; të dy kanë të njëjtën origjinë dhe të dytë posedojnë dinjitetin e vet, por njëri ka defekt në fjalimin e tij ndryshe nga tjetri. Më i miri prej tyre në të dy jetët është ai që nuk ka defekte në të folurit.” I thashë: “Allahu e përmirësoftë udhëheqësin! Unë e kuptoj se ai është më i mirë në këtë jetë për shkak të gojëtarisë dhe arabishtës, por çfarë e bënë që ai të jetë më i mirë në jetën tjetër?” Ai u përgjigj: “Ai e lexon Kuranin sikurse ai është shpallur. Njeriu me defekte në të folurit e tij futë tek Kurani atë që nuk i përket atij dhe nxerr prej tij atë që i përket atij.” Atëherë unë thashë: “Udhëheqësi ka folur të vërtetën!”

06 - I mençuri është i detyruar që ta ndez zemrën e tij me letërsi në të njëjtën mënyrë sikurse zjarri ndezet me dru. Ai që nuk e ndez zemrën e tij do të ketë një zemër të errët.

07 - Abdurr-Rahman bin Mehdi ka thënë: “Nuk pendohem për asgjë sikurse pendohem se nuk kam studiuar gjuhën arabe.”

08 - el-Esma'i ka thënë: “Mësone gramatikën! Izraelitët dolën nga feja për shkak të një germe. Allahu tha: “O Isa! Unë të kam krijuar (ualladtuk) ty!” Ata lexuan: “O Isa! Unë të kam lindur (ualadtuk) ty! “Si rezultat ata dolën nga feja.”

09 - Njerëzit me nevojën më të mëdha për letërsi dhe gojëtarin janë dijetarët sepse ata lexojnë shumë hadithe dhe mirren me aftësi të ndryshme.

10 - el-Esma'i ka thënë: “Asaj që unë i frigohem për momentin, është se në qoftë se ai nuk e dinë gramatikën ai bie në fjalët e Profetit salAllahu alejhi ue selem:

**“Ai që qëllimisht gënjenë për mua le të përgatisë vendin e tij në Zjarr.”**

**Profeti salAllahu alejhi ue selem nuk bënte gabime në të folur. Sido që të rrëfesh për të me një pengesë në të folur, ti ke gënjyer rreth tij.”**

**11 - Shu’beh ka thënë: “Studenti i cili studion hadithin pa e ditur gramatikën është sikurse si një kafshë me një rastë ushqimi bosh rreth qafës.”**

## **50. I MENÇURI DHE PASURIA**

**01 - I Dërguari i Allahut salAllahu alejhi ue selem ka thënë:**

**“O Amr! Sa e mrekullueshme një pasuri e drejtë e një njeriu të drejtë!”**

**02 - Në këtë transmetim deklaron Profeti salAllahu aejhi ue selem se është e lejuar për të grumbulluar pasurinë duke u siguruar të jetë e detyrueshme dhe e ligjshme për personin, që përmbushë të drejtat e pasurisë. Është e qartë se pasuria e drejtë përmendet së bashku me burrin e drejtë. Sepse lejohet grumbullimi i të hollave në qoftë se ato nuk janë të ndaluara për personin. Më pas, personi duhet të përmbushë të drejtat e Allahut lidhur me këtë pasuri.**

**03 - Kajs bin Asim i tha bijve të tij kur ai ishte në shtratin e vdekjes: “Kini dhe fitoni para! Ato e karakterizojnë bujarin. Ai që ka para nuk ka nevojë për të mallkuarin. Unë iu paralajmëroj nga të lypurit nga njerëzit! Lypja është furnizimi i fundit i njeriut.”**

**04 - Megjithatë, ajo që i sjell dobi më së shumti njeriut në të dy jetët është devotshmëria dhe veprat e mira.**

**05 - I mençuri është i detyruar që në rini të punoj për të përmbushur nevojat e tij, si diçka që kurrë nuk e lë atë, dhe ta korigjojë fenë e tij, sikurse të jetë diçka që ai nuk mund ta gjejë nesër. Marrëdhëniet e tij me të pasurinë duhet të jetë në mënyrë që ai të mund të jetojë, të mbroj veten dhe të përfitojnë prej tyre në jetën tjetër dhe ta kënaq Krijuesin e tij. Varfëria është më e mirë se pasuria e ndaluar. Personi i pasur dhe i pa vlerë është më i keq se qeni.**

**06 - Muhamed bin el-Munkadir ka thënë: “Pasuria është një ndihmë e mirë për devotshmërinë.”**

07 - ez-Zubejri ka thënë: “Umer bin el-Hatabi kaloi pranë Muhamed bin Meslemeh që qëndronte duke mbjellë pemë të vogla. Ai i tha: “O Ibn Meslemeh! Çfarë po bën?” Ai u përgjigj: Ti po e sheh. Unë veprojë kështu që të mos kam nevojë për të tjerët.”

08 - Abdan ka thënë: “Unë hyra tek Abdullah bin el-Mubarak i cili ishte ulur dhe qante. Unë i thashë: “Abu Abdirr-Rahman! Pse po qan?” Ai u përgjigj: “Më ka humbur një mall.” I thash: “A je duke qarë për një pronë?” Ai tha: “Ajo mban fenë time.”

09 - Një nga njerëzit më të lumtur është personi i cili përmbahet kur ai është i pasur dhe i lumtur dhe kur ai është i varfër. I varfëri detyrohet që ta braktis drojën. Varfëria shkatërron intelektin dhe dinjitetin e njeriut. Ajo heq dijen dhe etiken. Varfëria është pothuajse mosbesim. I varfëri është gjithmonë i dyshar. Ai është i prirur për të gjitha sprovat. Përrjashtimi i vetëm është i varfëri që ka një zemër të devotshëm dhe të kënaqur.

10 - Ejubi ka thënë: “Ebu Kilabeh më tha: “O Ejub! Rri në tregun tënd. Vëllezërit e tu do të vlerësojnë për derisa nuk ke nevojë për ta.”

11 - Nuk ka asnjë cilësi që është e lavdërueshme tek i pasuri pa qenë e njejta cilësi e dënueshme tek i varfëri. Nëse i varfri është i butë, thuhet se ai është budalla. Nëse i varfëri është i mençur, thuhet se ai është dinak. Nëse i varfëri është gojëtar, thuhet se ai flet palidhje. Nëse i varfëri është i zgjuar, thuhet se ai është brutal. Nëse i varfëri hesht, thuhet se ai është injorant. Nëse i varfëri është i kujdesshëm, thuhet se ai është frikacak. Nëse i varfëri është i ditur, thuhet se ai është i pamatur. Nëse njeri i varfëri është bujar, thuhet se ai është shkapërderdhës. Nëse i varfëri është kursimtarë, thuhet se ai është koprrac.

12 - Pasuritë më të këqija janë ato që janë fituar në mënyrë të ndaluar dhe janë shpenzuar në një mënyrë të ndaluar. Ekzistenca dhe jo-ekzistenca e pasurisë nuk varet nga durimi dhe shtegdaljet. Ato varen nga shpërndarja dhe dhurimi i të Gjithëdijshmit Krijuesit.

13 - Ka'b ka thënë: “Personi i parë që bëri monedha ari dhe argjendi ishte Ademi (alejhisselam). Ai tha: “Nuk mund të jetohet pa këto të dya.”

## **51. I MENÇURI DHE BESUESHMËRIA**

01 - I mençuri është i detyruar të jetë i denjë në mënyrë që ai të zotëroj cilësi të bukura aq sa të mundet dhe ti shmanget cilësivë të këqija aq sa të mundet.

02 - Unë nuk kam parë askënd që është aq humbës i madh dhe aq budalla dhe qesharak se sa personi që mburret me cilësitë e paraardhësve të tij ndërsa vetë nuk i ka ato.

03 - Hasan el-Basri ka thënë: **“Nuk ka fe pa dinjitet.”**

04 - Disa thanë se dinjiteti është që ti japësh ushqim axhallarëve, të shtoshë pasurin dhe të ulësh në karrige në shtëpinë tënde.

*Disa thanë se dinjiteti është që të jeshë i drejtë ndaj atij që është më i ulët se ti, ta nderosh atë që është më i lartë se ti dhe të shpërbleshë një dhuratë me po aq shumë.*

*Disa thanë se dinjiteti është që ta pranosh të vërtetën dhe të kujdesesh për mysafirët.*

*Disa thanë se dinjiteti është që ta flasësh të vërtetën, të durosh më të qijat e fqinjët, tu japësh njerëzve dhe të mos i bezdisësh njerëzit e huaj dhe fqinjët.*

*Disa thanë se dinjiteti është vetëm që të mos posedosh karaktere të shëmtuara.*

*Disa thanë se dinjiteti është të jeshë i butë dhe të ke karaktere të bukura.*

*Disa thanë se dinjiteti është të përmbahesh dhe të punosh; të përmbahesh nga ajo që Allahu e ka ndaluar dhe të punoshë me atë që Allahu e ka lejuar.*

*Disa thanë se dinjiteti është të jesh mirënjohës kur të ipet diçka, të jesh i durueshëm kur sprovohesh, të falësh kur ke mundësin të dënoshë dhe të përmbushësh premtimin kur premttonë.*

*Disa thanë se dinjiteti është të jesh i dashur dhe i zgjuar.*

*Disa thanë se dinjiteti është që ti shmangesh çdo gjëje të dyshimte, sepse i dyshuari nuk është fisnik, ta shtosh pasurin tënde, sepse i varfëri nuk është fisnik, dhe ta furnizoshë familjen tënde, sepse ai familja e të cilit ka nevojë për të tjerët nuk është fisnik.*

*Disa thanë se dinjiteti është të qenurit i pastër dhe aromatik.*

*Disa thanë se dinjiteti është elokuenca dhe tolerimi.*

*Disa thanë se dinjiteti është të kujdesurit për marrëveshjet dhe respektimi i kontratës.*

*Disa thanë se dinjiteti është të bësh shaka dhe të buzëqeshësh.*

05 - Ata kanë mendime të ndryshme për dinjitetin, por ato janë të gjithë të përafërta.

06 - Sipas meje, dinjiteti është ti shmangesh të gjitha veprave që Allahu dhe myslimanët i urrejnë dhe të bëjë të gjitha veprat që Allahu dhe myslimanët i duan.

07 - Ibn Sirin ka thënë: “Tre gjëra nuk i përkasin dinjitetit; ngrënia jashtë në treg, të parfumosurit tek shitësi i parfumeve dhe shikosh në pasqyrë tek njeriut që bën hixhame.”

08 - Esh-Sha’bi ka thënë: “Nuk është dinjitet të shikosh në pasqyrë tek njeriut që bën hixhame.”

09 - Ebu Kilabeh ka thënë: “Nuk është e dinjitet që të fitosh para nga shoku ytë.”

10 - Muavija bin Ebi Sufjani ka thënë: “Sëmundja e dinjitetit qëndron në të paturit miq të këqijë.”

11 - Sherik ka thënë: “Poshtërimi i botës është në pesë gjëra: të vizitosh hamamet para agimit pa kovë, të ecësh në një kalim për këmbësorë pa kalim ku nuk ka udhëkryq, të shkosh në leksion pa libër, nevojat e të nderuarit e personit më të ulët se ti dhe nevoja e burrit për gruan e tij.”

## **52. I MENÇURI DHE BUJARIA**

01 - Bujaria është e dashur dhe e lavdëruar dhe koprracia është e urrejur dhe e qortuar. Nuk ka asgjë të mirë në të pasurinë pa bujari.

02 - Bujaria më e mirë është që të jeshë bujar me pasurinë tënde dhe të qëndroshë largë pasurisë së njerëzve të tjerë. Ai që është bujar bëhet zotëri, ndërsa si që është koprrac bëhet i ulët.

03 - Koprracia është një pemë në Xhehnm, degët e së cilës janë këtu në tokë. Ai që kap një prej degëve të saj shkon poshtë në Xhehnm. Bujaria është një pemë në Xhenet, degët e së cilës janë këtu në tokë. Ai që kap një prej degëve të saj ngjitet lartë me të në Xhenet. Xheneti është vendbanimi i njerëzve bujar.

04 - Nuk ka asnjë cilësi që e diskreditonë dhe turpëron një person dhe fenë e tij aq shumë si koprracia.

05 - Nafi ka thënë: **“Kur Ibn Umeri u sëmur në Medine, atë e morri malli për rrush ndërsa nuk ishte periudha e rrushit. Ata dolën për të kërkuar rrush dhe e gjetën atë vetëm tek një njeri. Ai bleu shtatë kokrra rrushi për një monedhë argjendi. Pastaj erdhi një lypës dhe urdhëroi që ti ipen ato.”**

06 - Unë nuk kam parë dikë në lindje ose në perëndim të jetë bujar dhe të mos i bezdis të tjerët, përçesë është bërë prijësë i të gjithë njerëzve. Ai që dëshiron një nivel të lartë në jetën tjetër dhe një nivel fisnik në këtë jetë duhet të jetë bujar dhe të mos shqetësojë njerëzit e tjerë. Ai që dëshiron të diskreditojë dhe turpërojë personalitetin dhe religjiozitetin e tij, ti mërzis vëllezërit e tij dhe të shqetësojë fqinjët e tij duhet të jetë koprrac.

07 - Koprracia ka qenë e dënuar nga të gjithë njerëzit e mençur në kohët pagane dhe në Islam deri në ditët e sotme.

## **53. I MENÇURI DHE DHURATAT**

01 - Është e detyrueshme të marrësh një dhuratë kur të ipet. Nuk lejohet ta refuzoshë atë. Pastaj ai duhet të shpërblejë për të nëse është e mundur dhe të falënderoj për të. Unë rekomandoj vëllezërit që t'i japin njeri tjetrit dhurata. Ky veprim sjell dashuri dhe largon grindjet.

02 - Abdul-Malik bin Rifa'ah el-Fehmi ka thënë: **“Dhuratë është një magji e qartë.”**

03 - Aban ka thënë: **“El-Hasan bin Amarah e morri vesh se al-A'mash e kishte fyer atë. Si rezultat, ai ia dhuroi atij një rrobë. Pastaj el-A'mash e kishet zakon të fliste mirë për të. Njerëzit i thanë: “Si mundesh që së pari ta fyesh atë dhe pastaj ta lavdëroshë atë?” Ai tha: “Khejthemeh më tha se Ibn Mesudi ka thënë:” Zemrat**



janë krijuar me natyrshmërinë për të dashur atë që sillet mirë ndaj teje dhe ta urresh atë që sillet keq ndaj teje.”

04 - Ibn Sirin ka thënë: “Ata e kishin zakon t’i dhuronin njëri-tjetrit monedha prej argjendi në pjatë.”

05 - I mençur është i obliguar që të përdor gjëra që janë të përshtatura për kohën dhe të jetë i kënaqur me kaderin. Ai nuk duhet të dëshiroj diçka tjetër përveç asaj që i është dhuruar si furnizim. Nëse ai posedon një gjë të pavlerë, ai nuk duhet të mos e jep atë si lëmoshë vetëm sepse ajo nuk ka vlerë tek ai. Një veprim i tillë përbëhet të themi më së paku nga koprracia. Kushdo që nënvlerëson diçka edhe nuk e dhuron atë.

06 - El-Esma’i ka thënë: “Ne shkuam në shtëpinë e Kahmas i cili na i dhuroi njëzet e pesë hurme të kuqe dhe të papjekura. Atëherë ai tha: “Ky është mundi i vëllait tuaj, dhe nga Allahu kërkohet ndihmë.”

07 - Mejmun ka thënë: “Kushdo që dëshiron vëllezër pa diçka duhet të shoqërohet me të vdekurit në varret e tyre.”

08 - Is´haq bin Ibrahim ka thënë: “I është thënë el-Mugireh bin Shu’behs:” Çfarë po shijon ende?” Ai u përgjigj: “Nga dhuratat të cilat ia dhurojë vëllezërve.” Ai u pyet: “Kush jeton jetën më të mirë?” Ai u përgjigj: “Ai nga i cili të tjerët jetojnë.” Ai u pyet: “Kush jeton jetën më të keqe?” Ai u përgjigj: “Ai nga i cili askush nuk jeton.”

## **54. I MENÇURI DHE TË NDIHMUARIT E MYSLIMANËVE**

01 - I Dërguari i Allahut salAllahu alejhi ue semem ka thënë:

“Ai që ia lehtëson vëllaut të tij një vështirësi në këtë jetë, Allahu ia lehtëson një nga vështirësitë në Ditën e Gjykimit.”

02 - Të gjithë myslimanët janë të detyruar që t’u duan myslimanëve të mirën dhe t’ua largojnë brengat dhe vështirësitë e tyre. Kush ia largon një myslimani një vështirësi në këtë jetë, Allahu ia largon atij një nga vështirësitë në Ditën e Gjykimit.

03 - Vëllezërit e vërtetë dihen në kohë të vështira. Të gjithë njerëzit janë miq kur ata janë në gjendje të mirë. Vëllezërit më të këqij janë ata që ia kthejnë shpinën vëllezërve të tyre kur gjendja është më e vështirë dhe vendi më i keq është vendi që ka mungesë së tokës pjellore dhe mungesë të sigurisë.

04 - Hasan el-Basri ka thënë: **“Unë preferoj më tepër që të plotësojë nevojat e vëllait tim se sa që të bëjë l’tikaf dy muaj.”**

05 - Personi i cili e di shpërblimin nuk duhet të dështojë në të ndihmuarit të tjerët me pozitën e tij ose me pasurin e tij nëse është e mundur. Ai duhet ta bëjë këtë para vdekjes. Me vdekjen pushojnë të gjitha veprat e mira dhe atëherë vajton çdo të mirë që ke humbur.

06 - Nevojttari nuk duhet të dërdëllit ndihmë. Dërdëllitja në fakt mund të shkaktojë që të mos ipet ndihmë fare. Atij që i ipet duhet të falënderoj dhe atij që nuk i ipet duhet të jetë i kënaqur me kaderin. Pyetja duhet ti bëhet vetëm në shtëpi të atyre të cilëve i kërkon ndihmë. Ajo nuk duhet të bëhet në turma, në xhamitë apo në publik.

07 - Umer bin Hatabi ka thënë: **“Mos kërkoni prej njerëzve kur ata janë në tubime dhe në xhami në mënyrë që të mos i bezdisni ata. Kërkojuni atyre kur ata janë në shtëpi. Atij që i ipet, i ipet, dhe atij që nuk i ipet, nuk i ipet.”**

08 - Fjalët e Umerit radijAllahu anhu kanë të bëjnë me personin bujar. Nëse personi bujar pyetet kur ai është me të tjerët dhe nuk ka, ai turpërohet. Nëse atij që është i qortuar tek njerëzit i kërkohet në një tubim ose në xhami, ka një shans të madhe që ai të jep. Sepse i qortuari nuk jep nga besimi apo dinjiteti, por ai jep vetëm për të marrë një reputacion të mirë.

09 - Unë e rekomandoj të mençurin që ai të ha lëkurë dhe të thithë mbi shkëmbinj dhe të duron në vend se të lyp nga i qortuari. Që i qortuari të jepë është vepër e shëmtuar dhe që ai të mos jep është vdekje.

10 - Të mençurit nuk i lejohet ti kërkojë ndihmë armikut, budallasë, mëkatarit, gënjeshtarit apo atij që është në kërkim të interesave të tij. Nuk është e lejuar që të kërkosh dy gjëra në të njëjtën kohë. Kjo nuk është e lejuar të shprehësh nevojën e madhe që ke. Për personin fisnik, është e mjaftueshme që ai të dijë për nevojën pa e dëdallisur.

## 55. I MENÇURI DHE DHËNIA LËMOSHË NEVOJTARËVE

01 - Xhabiri ka thënë: “Profeti salAllahu alejhi ue selem kurrë nuk ka thënë jo, kur atij i kërkohej ndonjë gjë dhe as nuk e goditi dikë me dorën e tij.”

02 - Unë e rekomandoj çdonjërin që të ketë karaktere të larta dhe të mos i refuzojë lypësat. Është më mirë të mos kesh para se sa të mos kesh karaktere të bukura.

03 - Njeri me të vërtetë i lirë është ai i cili është liruar nga karakteret e tij të bukura. Rob më i keq është ai i cili është i skllavëruar nga karakteret e tij të shëmtuara. Prej gjërave më të mira që mund të posedosh në jetën tjetër janë karakteret e lavdërueshme.

04 - Jusuf bin Asbat ka thënë: “Që kur u krijua bota, paraja kurrë nuk ka qenë aq e dobishëm sikurse është sot.”

05 - Ubejdullah bin Zijad bin Dhijan ka thënë: “Unë e kisha një dajë nga fisi Kelb. Ai e kishte zakon të më thoshte: “Ki ambicie të larta! Sepse ambiciet e larta janë gjysma e dinjitetit.”

06 - Ebu Sulejman edh Dhabbi ka thënë: “Ibrahimi alejhis-selam kishte tetë porta në kështjellën e tij. Pa marrë parasysh se në cilën portë vinte lypësi, i ipej atij.”

07 - Seid bin Abdil-Aziz ka thënë: “El-Hasan bin Ali bin Ebi Talib radijAllahu anhuma dëgjoi një burrë pranë tij duke lutur Allahun që ti jep atij 10.000 monedha argjendi. Ai u largua nga aty dhe dërgoi një mesazh tek ai që i dha atij këtë shumë.”

08 - Ebu Said tregon nga mësuesi i tij, i cili tha: “Unë e pashë Ibn-ul-Mubarak duke e kafshuar në dorë shërbëtorin e tij. I thashë: “A po e kafshon shërbëtorin tënd në dorën e tij?” Ai u përgjigj: “Sa herë duhet ti them atij që të mos i numëroj monedhat për lypësat? Jepu atyre ca grushte monedha!”

09 - I mençuri është i deturuar që tu japë të tjerëve dhe të trajtojë të tjerët mirë. Ai duhet të fillojë me ata që janë më shumë të detyrueshëm për tu kujdesur mirë ndaj tyre dhe pastaj ata që vijnë pas tyre. Ai duhet të fillojë me familjen e tij, pastaj me

vëllezërit dhe fqinjët e tij dhe kështu me radhë. Ai duhet të sigurohet që prioritet të kenë njerëzit fetar dhe dijetarët.

10 - I mençuri fillon tu japë të tjerëve para se të kërkohet prej tij. Është më mirë për të marrë hapin e parë se sa të kompensoshë për të. Është më mirë që të mos lypësh sesa të japësh. Bamirësia është e mirë kur ajo të plotësohet dhe pastaj vazhdon. Fundi i mirë pastron fillimin. Është më mirë të japësh pasi që nuk ke dhënë sesa të mos japësh pasi ke dhënë.

11 - Bamirësia më e mirë që ndikon në zemër më së shumti dhe zgjatë dhe shmang fatkeqësitë më së miri është lëmosha që nuk përfundon duke ia përkujtuar atë personit që ia ke dhënë.

## **56. I MENÇURI DHE MIKPRITJA**

01 - I Dërguari i Allahut salAllahu alejhi ue selem ka thënë:

**“Ai që beson në Allahun dhe Ditën e Fundit duhet të nderojë mysafirin e tij. Ai që beson në Allahun dhe Ditën e Fundit nuk duhet ta bezdis fqinjin e tij.”**

02 - Unë e rekomandoj të mençurin që të ketë si zakon të ftojë njerëzit për ushqim dhe të jetë mikpritës. Të ftosh njerëzit për ushqim është një nga cilësitë më fisnike, më të mëdha dhe më të bukura. Ai që është i njohur për të ftuar njerëzit për ushqim konsiderohet i çmuar tek të gjithë njerëzit. Mikpritja e ngritë një person në nivelet më të larta, madje edhe në qoftë se ai vjen nga një prejardhje më e ulët.

03 - Seid bin el-Musejib ka thënë: **“Njeriu i parë i cili u kujdes për mysafirët ishte Ibrahim i alejhis-selam.”**

04 - Çdo njeri i cili ka qenë lider në kohët pagane dhe në Islam është bërë duke i ftuar njerëzit në ushqim dhe duke qenë mikpritës.

05 - Arabët nuk e konsideronin bujarin të jetë asgjë pa mikpritje dhe të ftuarit njerëzit në ushqim. Ata nuk e konsideronin një person të jetë bujar në qoftë se ai nuk posedon këto cilësi. Disa prej tyre mund të ecnin disa milje me shpresën për ta gjetur një mysafir.

06 - Hasan bin Isa Masarxhas ka thënë: **“Kam udhëtuar me Ibn-ul-Mubarak nga Horasani për në Bagdad dhe unë nuk e pashë atë duke ngrënë i vetëm asnjë herë.”**

07 - Qëllimi në mikpritjen është që të mos e nënvlerësosh atë të pak që e ke. Duhet ta ftosh në atë që ke. Ai që nënvlerëson diçka nuk e dhuronë atë.

08 - Ukbeh bin Alkameh dhe Mubashshir bin Isma'il e pyeti el-Euzain, **në lidhje me domethënien e mikpritjes. Ai tha: “Një buzëqeshje dhe një fjalim i mirë.”**

09 - Njeriu më koprrac është ai që është koprrac në ushqim dhe më bujari, është ai që është bujar në ushqim.

10 - Prej mikpritjes është një fjalim i mirë, një buzëqeshje dhe që zoti i shtëpisë personalisht të kujdeset për mysafirin e tij. Ai që i shërbenë mysafirëve të tij nuk është i poshtëruar dhe ai që shfrytëzon mysafirët e tij ose kërkon pagesë nuk është i fuqishëm.

11 - Seid bin el-Musejib ka thënë: **“Unë më parë e ngopi një person se sa të bëjë haxhin disa herë.”**

## **57. I MENÇURI DHE SHËRBIMI**

01 - Profeti salAllahu alejhi ue selem ka thënë:

**“Ai i cili nuk falënderon njerëzit nuk e falënderon Allahun.”**

02 - Personi i cili shërbehet është i detyruar ta kthej me një shërbim më të mirë ose të të njejtin. Një shërbim si mirënjohje nuk mund të krahasohet me iniciativën edhe nëse ajo do të jetë më e pakët. Ai që nuk është në gjendje ti kthej një të mirë duhet ta lavdërojë dhuruesin. Në rast pamundësie falënderimi, lavdërimi zë vendin e falënderimit. Askush nuk mund të jetë pa mirënjohje.

03 - Personi i lirë nuk është mosmirënjohës. Ai nuk zemërohet në rast fatkeqësie. Ai falënderon kur ai merr një dhuratë. Duron kur ai goditet nga ndonjë fatkeqësi. Ai që nuk falënderon për një gjë të thjeshtë vështirë që do të falëndrojë për shumë.

Dhuratat shtohen vetëm kur Allahu falënderohet, pastaj dhuruesi dhe fatkeqësitë shmangen në këtë mënyrë.

04 - Një person është i detyruar të falënderoj për dhuratat që ai merr. Ai duhet të lavdërojë për shërbimin aq sa mundet. Ose me dy herë më shumë, me aq shumë ose edhe me urtësinë e dijës se nga kush i ka ardhur dhurata dhe t'ia kthej me një shërbim dhe mirënjohje. Ai duhet të thotë:

خَيْرًا لِلَّهِ زَكَاةً

“Allahu të shpërbleftë me të mira.”

*Ai që nuk ka asgjë për ti dhënë dhe përgjigjet në këtë mënyrë e ka lavdëruar atë shumë.*

05 - Ka njerëz të cilët i përgjigjen me një mënyrë përbuzëse kur atyre i ipet dhuratë. Një prej tyre nuk ka njohuri për faktorët prapa dhuratës apo se si duhet falënderuar për të sepse ai nuk e di se si duhet kujdesur për një familje. Me këtë person duhet pasur tolerim. I dyti është i ndjeshëm dhe nuk falënderonë për dhuratën. Ai e nënvlerëson dhuruesin dhe e zhvlerëson dhuratën. Nëse ai është kështu, është detyrim për të mençurin që të mos i jep më dhurata atij.

## **58. I MENÇURI DHE PUSHTETI**

01 - Profeti salAllahu alejhi ue selem ka thënë:

“Secili nga ju është bari për kopenë e vet. Udhëheqësi është bari dhe është përgjegjës për kopenë e tij. Burri është bari për familjen e vet dhe është përgjegjës për kopenë e vet. Gruaja është baresh në shtëpinë e burrit të saj dhe ajo është përgjegjëse për kopenë e saj.”

02 - Sunneti ka ardhur nëpërmjet të zgjedhurit salAllahu alejhi ue selem, shprehimisht deklaruar se çdo bari është përgjegjës për kopenë e tij. Kështu që secili bari është i detyruar të kujdeset për të mirën e kopesë së tij. Barinjtë e njerëzve janë dijetarët. bariu i mbretërve është mendja. Bariu i të devotshmëve është frika ndaj Allahut. Bariu i studentit është mësuesi i tij. Bariu i fëmijës është babai i saj.

Roja e gruas është burri i saj. Roja e robit është pronari i tij. Secili bari është përgjegjës siç u tha për kopenë e tij.

03 - Përgjegjësinë më të madhe mbi kopenë e kanë mbretërit. Ata janë përgjegjës për popujt. Ata janë barinj më të lartë për shkak se urdhëresat e tyre zbatohen aq shpesh. Nëse ata nuk kujdesen për kohën e tyre dhe lënë pas dore qytetarët e tyre, ata shkatërrohen dhe i shkatërrojnë të tjerët. Një botë e tërë mund të shkatërrohet për shkak të një mbreti të keq. Fuqia e mbretit do të mbetet për derisa ndihmësit e tij i binden atij. Ndihmësit nuk do t'i binden atij pa një ministër. Kjo nuk do të ndodhë derisa përderisa ministri nuk është i dashur dhe dashamirës. Ministëri nuk do të jetë i tillë për derisa ai nuk është i përmbajtur dhe i kuptueshëm. Këta njerëz nuk mund të mbahen në kontroll pa para. Paratë vien vetëm nëse qytetarët janë të mirë. Qytetarët bëhen të mirë vetëm nëse ata qeverisen me drejtësi. Nga ana tjetër, ***pushteti mbetet vetëm nëse është i drejtë. Nga ana tjetër, ai pushon vetëm nëse është i padrejtë.***

04 - Mbreti është i detyruar të kujdeset për punëtorët e tij kështu që ai është i vetëdijshëm për mirësinë e të mirit dhe të keqen e të keqit. Kur mbreti nuk e di se çfarë bëjë punëtorët e tij, ai nuk mund të jetë i drejtë.

05 - Pushtetari nuk duhet të jetë shumë i kënaqur dhe i lumtur me qytetarët e tij, e as tepër pak. Shumë nga këto tipare shkaktojnë marrëzi. Pak nga këto tipare sjellin mendjemadhësi dhe arrogancë. Mbreti nuk duhet të zemërohet, sepse fuqia e tij shtrihet përtej nevojave të tij. Mbreti nuk duhet të gënjejë, sepse askush nuk mund ta detyrojë atë në asgjë. Mbreti nuk duhet të jetë koprrac sepse nuk ka asnjë justifikim nëse posedon pronë dhe pozitë. Mbreti nuk duhet të jetë urrejtës, sepse ai duhet të jetë më fisnik se sa të ndëshkon. Pushtetari më i mirë nuk është arrogant.

06 - Pushtetari është si zjarri. Nëse zjarri është shumë i vogël, është i padobishëm. Nëse është shumë i madhë, e keqja e tij tejkalon kufirin. Pushtetari më i mirë është ai që të kujton shiun që sjell dobi në rrethinën e tij dhe jo e zjarrin që djeg rrethinën e tij.

07 - Një pushtetar i drejtë është më i mirë se shiu. Një pushtetarë i padrejtë është më mirë se një sprovë e gjatë. Njerëzit janë në nevojë më të madhe për një pushtetarë të drejtë, sesa për një kohë pjellore.

08 - El-Ahnaf bin Kajs ka thënë: ***“Marrëdhënia e pushtetarit ndaj qytetarëve është sikurse lidhja e shpirtit me trupin pa të cilin smund të jetoj dhe marrëdhënia e kokës me pjesët e trupit pa të cilën ato nuk funksionojnë.”***

09 - Së pari dhe më kryesorja është se pushtetari është detyruar që ta ketë frikë Allahun dhe të përmirësojë marrëdhëniet e tij të fshehta me Krijuesin e tij. Pastaj ai duhet të mendojnë për përgjegjësinë që Allahu i ka dhënë atij mbi vëllezërit e tij dhe me të cilën Ai e ka ngritë atë mbi ta. Ai duhet ta dijë se ai është përgjegjës për të gjitha çështjet e tyre të vogla dhe të mëdha. Pastaj ai duhet ta dijë se ai do të jetë përgjegjshës për të gjitha çështjet e tyre të pakta apo të shumta. Pastaj ai duhet të emërojë një ministër të drejtë, të urtë, të dëlirë, dhe dashamirës. Ai duhet të ketë punëtorë të devotshëm, të drejtë dhe të ndjeshëm. Ai duhet të ketë ndihmëtarë të fshehur dhe shërbyes të njohur.

10 - Pushtetari duhet të kërkojë nga punëtorët e tij devotshmëri dhe bindje ndaj Allahut. Pasuritë lejohet të mirren vetëm nga burime të ligjshme dhe pastaj ti shpërndahen atyre që e meritojnë. Pushtetari duhet ta ketë nën kujdes arkën kështu që as edhe një kokërr e ndaluar me anë të detyrimit, padrejtësisë, plaçkitjes, grabitjes apo ryshfetit të hyjë në të. Pushtetari është përgjegjës për gjënë më të vogël në të. Ai do të jetë i përgjegjshëm për çdo kokërr në të. Pastaj ai nuk duhet ta shpenzojnë këtë pronë në diçka tjetër përveç asaj që Allahu urdhëron në kapitullin el-Enfal.

Allahu Te ala ka thënë:

إِنَّ السَّبِيلَ وَابْنَ وَالْمَسَاكِينَ وَالْيَتَامَى الْقُرْبَىٰ وَلِذِي وَاللرَّسُولِ حُْمْسَهُ لِّلَّهِ فَإِنَّ شَيْءٍ مِّنْ غَنَمْتُمْ أَنَّمَا وَعَلَّمُوا قَدِيرٌ شَيْءٍ كُلِّ عَلَىٰ وَاللَّهُ الْجَمْعَانَ النَّقَىٰ يَوْمَ الْفُرْقَانِ يَوْمَ عَبْدَنَا عَلَىٰ أَنْزَلْنَا وَمَا بِاللَّهِ آمَنْتُمْ كُنْتُمْ

*“Ju (besimtarë) ta dini se një e pesta e asaj që e fituat, nga ndonjë send, i takon (përkujtuesve të) Allahut, të dërguarit të Tij, të afërmve të tij (të dërguarit), jetimave, nevojtarëve dhe atyre në mërgim, (ky është përcaktimi i Zotit), nëse keni besuar Allahun, dhe atë (Kur’anin) që ia zbritëm robit Tonë (Muhammedit) ditën e furkanit (ditën e Bedrit, kur u dallua e vërteta nga e shtrembëra), ditën e konfrontimit të dy grupeve. Allahu është i fuqishëm për çdo gjë.” 8:41*

## **59. I MENÇURI DHE QËNDRIMI NDAJ KËSAJ JETE**

01 - I Dërguari i Allahut salAllahu alejhi ue selem ka thënë:

**“Të zgjohesh i sigurt në shtëpinë tënde, i shëndetshëm në trup dhe të kesh furnizim të mjaftueshëm në një ditë është si të kesh të gjithë botën.”**



02 - I mençur e ka detyrimin që të mos lejoj që të mashtrohet nga kjo jetë dhe nga bukuria e saj kështu që ai të preokupohet me të në vend të jetës së përjetshme. Ai duhet ta konsiderojnë këtë jetë sikurse e konsideron atë Allahu. Kjo shpie në mënyrë të pashmangshme në një fund. Ndërtesat e saj do të shkatërrohen dhe banorët e saj do të vdesin. Kopshtet e saj do të shuhe, gjelbërimi i saj do të ikë dhe.

03 - Nuk mbetet udhëheqës tiranik dhe imponues apo varfanjakë i poshtëruar, vetëm se që të gjithë do të pijnë nga kupa e vdekjes. Pastaj ata çohen tek ajo tokë ku ata do të kalben derisa ata të zhduken. Pastaj është Ai që e di të fshehtën që trashëgon tokën dhe çdo gjë në të.

04 - I mençuri nuk do të rri duarkryq në një botë të tillë si kjo. Ai nuk duhet të ndjehet i qetë me një botë si kjo. Atë është duke e pritur atë që syri kurrë nuk e ka parë, veshi nuk e ka dëgjuar dhe një zemër kurrë nuk e ka imagjinuar.

05 - Kjo jetë është një det i bollshëm. Njerëzit notojnë në valët e tij. Ditët japin shembuj për njerëzit. Çdo gjë që po shkonë drejt fundit të saj ta kujton atë. Ai që merr tre gjëra nga kjo jetë ka marrë të gjitha; sigurinë, jetesën dhe shëndetin. Vetëm i mashtruari gënjejhet nga diçka gjë në këtë jetë.

06 - I mençuri e di se ajo nuk është lënë për të tjerët nuk është lënë as për të. Ai e di se ajo që është marrë nga tjerët nuk do të mbetet tek ai.

07 - Ai që dëshiron të jetë i lirë duhet të qëndrojnë larg epsheve edhe në qoftë se ato do të jenë të kënaqshme. Çdo gjë e kënaqshme nuk është e mirë, por çdo gjë e dobishme është e kënaqshme. Të gjitha epshet bëhen të mërzitshme pas një kohe. Përjashtimi i vetëm janë fitimet dhe fitimi më i madh është Xheneti, dhe që të mos kesh nevojë për askënd tjetër përveç Allahut.

**08 - Ma'n bin Aun ka thënë: "Sa shumë njerëz fillojnë ditën pa e përfunduar atë? Sa shumë njerëz e presin të nesërmen pa e përjetuar atë? Nëse ju shikoni në shpërblimin dhe rrugën drejt tij, do të urreni planet për të ardhshmen."**

09 - Ajo që e bën të mençurin që ta konsiderojë këtë jetë sikurse duhet, ai nuk duhet të rri duarkryq në lidhje me të dhe në vend të kësaj ai duhet të bëjë atë që mundet për të arritur jetën e përjetshme dhe lumturinë e qëndrueshme. Ai nuk duhet të ketë plane afatgjata për të ardhmen. Ai duhet të mendoj se mund të vdes në çdo kohë.

10 - I mençur nuk duhet të ketë plane për të ardhshmen. Në vend të kësaj, ai duhet gjithmonë ti ketë parasysh popujt e mëparshëm të cilët kanë jetuar. Gjurmët e tyre janë zhdukur. Lajmi i tyre ka pushuar. E vetmja gjë që mbetet prej tyre është emri i

tyre. E vetmja gjë që ka mbetur nga shtëpia e tyre janë vizatimet e tyre. I pa të meta është Ai që ka mundësinë që ti ringjallë ata dhe ti mbledhë për shpërblimin dhe ndëshkimin.

## 60. I MENÇURI DHE PRITJA E VDEKJES

01 - I Dërguari i Allahut salAllahu alejhi ue semem ka thënë:

“Kujtone shumë shkaërruesin e kënaqësive - vdekjen.”

02 - Përveç çdo urtësie të cilën e kemi përmendur në këtë libër, i mençuri është i detyruar që të përkujtojë vdekjen gjithmonë, dhe të mos mashtrohet nga kjo jetë. Vdekja është një mulli krahët e të cilit sillen në mesin e të gjitha krijesave. Vdekja është një kupë nga i cili të gjithë të gjallë duhet të pinë dhe ta shijojnë.

03 - Vdekja shkatërron kënaqësitë, përmbytë epshet, trazon kohët, largon mangësitë.

04 - Ebul-Atahijah ka thënë: “Hyra tek udhëheqësi i besimtarëve Harun [er-Rashid], kur ai më pa, tha: “Ebul-Atahijah?” Unë thashë: “Ebul-Atahijah”. Ai tha: “Poeti?” Unë i thashë: “Poeti?”. Ai tha: “Më qorto me disa poezi të shkurtëra. “Atëherë unë lexova:

Kurrë mos u ndjejë i sigurt me vdekjen

Edhe nëse do të mbrohesh me roje

Ti duhet ta dish se shigjetat e vdekjes hidhen kundër

Çdo njëri i cili e mbron veten me armatim dhe mburoja

A po e shpreson shpëtimin pa ecur rrugës së tij?

Anija nuk lundronë në tokë

Haruni ra pa vetëdije.”

05 - I mençuri nuk e harron atë çfarë e pret atë. Sa umete i ka shfarosur vdekja? Sa shumë qytete i ka lënë shkret? Sa shumë gra i ka lënë veja? Sa shumë fëmijë i ka lënë jetimë? Sa shumë vëllezërit i ka lënë të vetëm?

06 - I mençuri nuk lejon që të mashtrohet nga një gjendje të cilës po i afrohet fundi sikurse e kemi përmendur. Ai nuk mbështetet në një jetë që përfundon në mënyrën e përmendur. Ai nuk e harron gjendjen që në mënyrë të pashmangshme e pret atë. Vdekja është një gjuetar të cilës personi i ambientuar nuk i shpëton dhe refugjati nuk mund të ik prej saj.

07 - Ibn-us-Simak ka thënë: “Një peshkatar nga popujt e lashtë doli për peshkim. Pasi kishte hedhur rrjetën në det dhe pastaj e tërhoqi atë, ai gjeti një kafkë të njeriut në të. Ai shikoi në të, filloi të qajë dhe tha: “Ti ishe i fuqishëm, por nuk u le në fuqinë tënde. Ti ke qenë i pasur, por nuk u le në pasurinë tënde. Ti ke qenë i varfër, por nuk u le në varfërinë tënde. Ti ke qenë bujar, por nuk u le në bujarinë tënde. Ti ke qenë i ashpër, por nuk u le në ashpërsinë tënde. Ti ke qenë i ditur, por nuk u le në dijeninë tënde. “Ai përsëriti fjalët e tij dhe qau.”

08 - Abdul-Mun'im er-Rajjahi ka thënë: “Malik bin Dinar u zhduk një ditë. Kur ai u kthye, ata e pyetën se ku ai kishte qenë. Ai tha: “Në el-Ubullah.” Ata e pyetën për gjën më të bukurë që ai pa. Ai tha: “Një grua që rrinte në këmbë dhe lutej.” Ata e pyetën për gjënë më të çuditshme që ai pa. Ai tha: “Një Kala në Bahrein. Mbi derën e saj shkruante:

Unë dëshirova një jetë sikurse jeta e më të lumturve

Dhe kam jetuar në mënyrë magjepse dhe i lumtur

Betohem në Zotin e njerëzve që nuk zgjati shumë kohë

Para se të largohesha nga miqtë dhe të dashurit

09 - Salih el-Murri ka thënë: “Një ditë shumë të nxehtë hyra tek varrezat, ku pashë se si varret ishin të qeta. Ato ishin sikurse të ishin njerëz të heshtur. Thashë: “I pa të meta është Allahu! Kush do të sjellë së bashku shpirtat tuaj dhe trupat pasi ata kanë qenë të ndarë? Kush do t’u ringjallë pas një kohe të gjatë në kalbje? “Atëherë një zë u dëgjua nga një varr: “ O Salih!

تَخْرُجُونَ أَنْتُمْ إِذَا الْأَرْضِ مِّنْ دَعْوَةِ دَعَاكُمْ إِذَا تُمَّ بِأَمْرِهِ وَالْأَرْضُ السَّمَاءُ تَقُومُ أَنْ آيَاتِهِ وَمِنْ

***“Nga argumentet e Tij është që me fuqinë e Tij bëri të qëndrojë (pa shtyllë) qielli e Toka, mandej kur t’ju thërret juve me një të thirrme prej tokës, ju menjëherë dilni.” 30:25***

***Betohem në Allahun se rashë pa ndjenja.”***

10 - Ne kemi përmendur vetëm disa, përndryshe ka jashtëzakonisht transmetime të shumta në këtë libër. Unë shpresoj se kjo është e mjaftueshme për ata që dëshirojnë të udhëtojnë në rrugën e të mençurve, vetëm nëse ai mediton në lidhje me të dhe vepron sipas saj.

**Hamdi dhe lavdërimi i Allahut qoftë mbi profetin e fundit Muhamedin familjen e tij të pastër. Hamdi dhe lavdërimi i takon Allahut, Zotit të krijesave.**